

# ARBËR SELMANI

Udhëtim nëpër kohë,  
rrefime plot nostalgji.  
Njerëz, objekte, mishërim.  
Katërbëdhjetë tekste  
që me anë të fotografive i  
vijjnë të freskëta lexuesit.  
Trashëgimi, art, kulturë,  
letërsi, muzikë, mbi të  
gjitha... jetë.



NË 14 TREGIME  
KULTURORE



European  
Union  
Kosovo

PRISHTINË 2019





# KOSOVA

## NË 14 TREGIME KULTURORE

“Kosova në 14 tregime kulturore” është një përmbledhje e teksteve gazetareske shkruar nga Arbër Selmani, nga muaji mars 2019 deri në gusht 2019.

Tekstet janë realizuar në gjuhën shqipe dhe angleze, në këtë libër do t'i gjeni vetëm ato në gjuhën shqipe. Libri u realizua si pjesë e projektit/grantit “Kontribut në forcimin e gazetarisë së pavarur, hulumtuese dhe të dobishme për publikun, si dhe në lirinë e shprehjes në Kosovë”, projekt i mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe implementuar nga BIRN – Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese dhe AGK – Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës.

Si një prej përfituesve të grantit, gazetari Arbër Selmani ka depërtuar në tregime të ndryshme kulturore, prej Anton Çettës e deri te Hamami i Prizrenit, prej Istref Begollit e deri te Muzeu Etnologjik në Prishtinë. Këto katërbëdhjetë tregime dhe rrëfime përmbajnë njerëz të fateve të ndryshme, që shënuan dhe ende shënojnë kulturën dhe artin shqiptar. Ata janë pak, për të përfshirë të gjithë do të duheshin libra të tërë, që nuk do të pushojnë së shkruari.



# PËRMBAJTJA

7

Anton  
Çetta



Ali  
Podrimja

87

21

Muzeu  
Etnologjik



Istref  
Begolli

95

31

Dilaver  
Kryeziu



Nezafete  
Shala  
dhe  
Melodia  
e Vjetër

105

41

Pranvera  
Badivuku




Hamami  
i Prizrenit

113

51

Armend  
Rexhepagiqi



Shaqir  
Hoti

123

63

Çejzi



Mirko  
Gashi

133

75

Anton  
Pashku



Fitnete  
Tuda

139





*“Duhet të jemi trima të urtë. Kombi shqiptar kurrë nuk ka qenë më unik, pas këtij bashkimi kombëtar nuk ka fuqi që mund ta gjunjëzojë këtë popull”*

---

Anton Çetta

## AGATA DHE DONIKA ÇETTA, VAJZAT E TATES DHE ARKIVËS SË GJALLË TË FOLKLORIT SHQIPTAR

Një arkivë e gjallë e folklorit shqiptar, i cili me dashurinë më të madhe e transmetonte këtë folklor në formë të përrallave, çdo natë para gjumit. Donika Çetta kësisoj e përshkruan babain e saj, Anton Çettën.

Ne të gjithë e njohim një Anton Çetta prej librave, prej faljes së gjaqeve, prej dorështrëngimeve, prej rezonimit të mirësisë në fytyrën e tij, prej historive që prindërit tanë na kanë treguar për këtë burrë, prej fotografive bardh e zi dhe me ngjyra, prej momenteve kur familjet gjejnë paqe<sup>1</sup>. Të tjerët e kanë takuar rastësisht, disa në ëndrra, të tjerë në fushën e pajtimit.

Donika e njeh më mirë se ne, më ndryshe se ne, më mishërueshëm se ne këtë emër historik.

“Fëmijëria dhe vendlindja janë dashuritë që lëshojnë rrënjët më të thella në njeriun. Për këtë arsye ajo gjithnjë gjatë gjithë udhës që bën njeriu, e thërret në prehrin e vet” – thoshte babi. Ndërsa për mua, të rritesha krahas tij, fëmijëria ime ngjasonte në fytyrën e mëngjesit dhe shpirtin e përrallës” tregon Donika Çetta, vajza e Anton Çettës.

“Shpesh i kujtoj edhe ditët e kaluara me babin në liqenin e Batllavës meqë atje kishim një vikend-shtëpizë. Babi e kishte hobi peshkimin ndërsa unë isha ndihmësjë e tij pa të cilën nuk kishte fat në peshkim, më thoshte. Në të aguar, në mëngjesin e hershëm bëheshim gati për të shkuar në peshkim. Në avullin që lëshonte liqeni derisa i afroheshim vendit tonë të preferuar të peshkimit, rrezet e para të agimit binin në fytyrat tona dhe na jepnin ngrohtësi dhe

<sup>1</sup><https://www.nytimes.com/1990/04/07/world/pristina-journal-albanians-new-way-feuds-without-blood.html>

shpresë. Pasi vendosnim shkopinjtë e peshkimit fillonin këshillat dhe bisedat e këndshme babë e bijë që dinin të zgjasnin por ndonjëhere ndërpriteshin nga të dridhurat e tërheqja e shkopit që nënkuptonte se peshku kishte rënë në grep. Shpesh na bashkoheshin edhe fëmijët e fshatit dhe të tjerë, meqë s'kishte njeri që s'lakmonte që së paku një orë të jetës të ishte përkrah babit dhe të bisedonte me të” tregon Donika.

Është e vështirë ta ndërpresësh tregimin e Donikës, meqë ky tregim të merr me vete me të njëjtën mirësi që Anton Çetta edhe sot e reflekton ndër shqiptarët kudo.

Akademik, profesor, mbledhës i folklorit, patriot i njerëzishëm, dikur edhe deputet, Anton Çetta – i lindur në Gjakovë në vitin 1920, jetoi ditët e tij të fundit në vitin 1995 në Prishtinë.

Anton Çetta ka qenë edhe një baba shembull sipas të bijës së tij.

“Unë si fëmiju i parë i familjes isha shumë e lidhur me babin por kisha një përgjegjësi

më të madhe dhe pritej shumë nga unë. Unë duhej të isha fëmiju model, me të gjitha epitetet më të mira që mund t'i ketë dikush edhe pse ai nuk na imponoi kurrë asgjë. Mundohesha që të marr sa më shumë nga ai, sa herë që kishte pak kohë unë i rrija në prehër dhe nuk i ndahesha meqë isha edhe pak çapkëne dhe kureshtarë dhe doja të fitoja përgjigjet e mia, por ai nuk mërzoj me pyetjet e mia të pafundme dhe me durimin më të madh mi shpjegonte ato. Duke u rritur unë, me mua rriteshin edhe pikëpyetjet për situatat e ndryshme të krijuara që na i servonte jeta por unë e kisha përgjigjen për të gjitha meqë baba na pat thënë: “Çkado që të bëni në jetë ose përpara ndonjë vendimi të rëndësishëm, vetëm mendoni – A do t'a kisha bërë sikur ta kisha babin këtu” Kjo thënie më përcolli gjatë gjithë jetës dhe më shërbeu si udhërrëfyes në çdo hap të jetës dhe në çdo vendim të rëndësishëm të saj” na shpjegon Donika, kur duhet të kujtojë raportin e saj me Anton Çettën e të gjithë shqiptarëve, të vetmin Anton Çettë të jetës së saj.





*Fotografi nga albumi familjar i familjes Çetta*




“Desha t'u lija brezave që do të vinin artin,  
mençurinë dhe kulturën e popullit tonë të  
lashtë”

**ANTON ÇETTA**

---





**Libri i parë nga Anton Çetta,  
mes të tjerave edhe humanist,  
botohet në vitin 1953.**

Mprehtësia e tij letrare vazhdon të rrjedhë me tekste të ndyshme, shumica prej tyre edhe për nevojat e shkollës shqipe dhe një katalizator për edukimin e gjeneratave të tëra shqiptare.

Rreth 20 libra me përmbledhje folklori dhe traditë gojore nga të gjitha trevat, janë bagazhi modest por jo i kompletuar i Anton Çettës. Shembull, “Prozë popullore nga Drenica” përmban plot folklor e traditë mbledhur prej Çettës.

“Njani shkoi me u rruë tu ni berber. Berberi e kish pase zakon m' u livdue shume. Kur e rruëjti myshterine, filloi me i thane:

*-Balla boll mire t'kam rruë, valla boll mire t'kam rruë. Myshteria edhe i nej gati e i tha:*

*– Valla edhe une boll mire t'kam nejt”*

\_\_\_\_\_ ■ ■ ■

---

## **Agata Çetta, vajza tjetër e Anton Çettës, nuk përmbahet kur flet për madhësinë e këtij njeriu.**

---

“Fëmijëria ime ka qenë e thjeshtë, mu sikur virtyti të cilin Tata ka tentuar gjithmonë të na e mësonte, thjeshtësia. Megjithatë, mes shkollës, lojërave dhe obligimeve tjera që unë kisha si fëmijë, kujtoj shumë qartë përrallat që ai na tregonte në “Odën e oxhakut”, vendin e tij dhe tonë të preferuar e të rregulluar me elemente dhe stoli tradicionale, ku Tata edhe kalonte shumicën e kohës duke punuar. Në netët kur na zinte gjumi nën zhurmën e makinës së shkrimit, unë nuk e kuptoja rëndësinë e madhe të punës së tij, por këtë gjë e kam kuptuar me kohë dhe kjo gjë më ka ndihmuar shumë në krijimin e personalitetit tim, shprehisë së punës dhe përkushtimit ndaj gjërave të rëndësishme në jetë” tregon Agata, e cila e quan Tata – plakun e urtë Anton.

“Gjithmonë unë dhe motra e kemi thirrë Tate. Më kujtohet që në vegjëli shoqëria më pyeste pse e thirri Tate e jo Babë, dhe iu pata thënë që edhe Tata e ka thirrë njëjtë gjyshin, kështu që e kemi trashëguar”.

“Kur ka lindë motra ime e madhe, Tata ia ka ngjitur emrin Donika, dihet sipas bashkëshortes së Skënderbeut. Kur kanë ardhë për vizitë të afërmit në shtëpi, tezja e Tatës e ka pyetur: “Anton, si ia ngjite vajzës emrin?”, Tata i thotë Donika. Po si Anton nuk ia ngjite në emër të nanës? Tata përgjigjet: Kur të lindë e dyta ia ngjes. Dhe menjehere tezja reagon, jo të dytin fëmijë e dojmë djalë. Tata vetëm qeshë. Ky është tregimi i emrit tim” tregon Agata.

---

■ ■ ■



Fotografia: Lala Meredith Vula

### **Të rrijmë pak te Anton Çetta.**

Rreth viteve 1945-46 ai punoi në Gjinnazin e Prizrenit, duke qenë edhe anëtar i Shoqërisë Kulturore-Artistike “Agimi”, më vonë edhe kryetar i saj. Në Serbi shkon për tu regjistruar në Degën e Gjuhës Frënge. Atje emërohet asistent në Seminarin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, që funksiononte në kuadër të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Beogradit. Në këtë detyrë punoi dhjetë vjet. Dy-tre vjet më vonë (1952-1953) së bashku me shefin e atëhershëm të Seminarit Shqiptar

Vojislav Dançetoviç dhe me Kadri Halimin, etnograf, përgatiti në tri vëllime këngët më të njohura popullore të mbledhura në Kosovë dhe në Dukagjin. Meqenëse në ato vëllime kishte botuar edhe këngë popullore për Spiro Kapedanin e Ramë Bllacën, pushteti serb iu kërcënua Antonit me burgosje, e kjo e shtyri ta braktisë Beogradin dhe të kthehet në Prishtinë, në vitin 1961, kohë kjo kur edhe në Prishtinë u hap Fakulteti Filozofik. Në këtë fakultet ai emërohet mësimdhënës i gjuhës dhe

letërsisë shqipe, ku ligjëron lëndën e letërsisë së vjetër.<sup>2</sup>

Dom Lush Gjergji, në një intervistë të tijën, e quan Çettën kirurg shpirtëror të shqiptarëve.

“Antoni ishte njeri i provanisë së Zotit. Ai me hulumtimet që i bëri rreth thesarit popullit, rreth frazeologjisë, rreth kulturës dhe qytetërimit, 20 vjet, ishte një lloj përgatitjeje për veprën e tij hyjnore, sepse

kudo që shkonim me bacën Anton, kishte njerëz që ai i njihte. Madje ishte legjendare kur shkonim para tridhjetë, katërdhjetë vjetëve, kam qenë në këtë shtëpi dhe më kujtohet atë natë kur kemi biseduar për kulturën, për traditën, për popullin shqiptar, dhe ka lindur një fëmijë. Madje i kujtohej edhe emri i njeriut tri-katërdhjetëvjeçar, dhe ai thoshte: baca Anton ai jam unë. Prandaj krijonte një atmosferë unike. Para Anton Çettës ka qenë shumë e vështirë të thuash jo”.<sup>3</sup>

■ ■ ■

*“Duhet të jemi trima të urtë. Kombi shqiptar kurrë nuk ka qenë më unik, pas këtij bashkimi kombëtar nuk ka fuqi që mund ta gjunjëzojë këtë popull”*

**Anton Çetta**

Donika tregon se ishte privilegj që ajo dhe motra e saj patën një baba të tillë, por gjithashtu ishte edhe një barrë mbi supet e tyre, barrë që rëndohej në periudha të ndryshme të zhvillimit të tyre.

Si të vogla, motrat ishin 'vajzat e profesorit', ndërsa si adoleshente nënkuptonte edhe një kufizim të dëshirave të kohës, siç shprehet Donika.

“Pavarësisht asaj ne nuk u fshehëm nën hijen babit por u përballëm me sfidat dhe hallet e ndryshme. Kështu mësuam që të

jemi më stoike dhe më të guximshme dhe mos të jenë problemi i parë hallet tona, por të na karakterizojë durimi, urtësia, qëndresa dhe guximi” vazhdon Donika.

Njëjtë si Donika, edhe Agata thotë se ka qenë barrë e mirë fakti që familjarët e Antonit gjithmonë kanë tentuar të gjejnë rrugën e drejtë të jetës.

“Më shumë se barrë e mirë, kjo për ne ka qenë kënaqësi. Mirënjohja për veprat e tij dhe respekti të cillin ai e ka gëzuar dhe e

<sup>2</sup><https://www.radiokosovaelire.com/anton-cetta-1920-1995-mbledhes-folklorit-profesor-letersise-dhe-veprimtar-dalluar-ceshtjes-kombetare/>

<sup>3</sup><http://www.drita.info/2018/08/09/don-lush-gjergji-anton-cetta-ishte-kirurg-shpirtoror-i-shqiptarëve/>



gëzton akoma ndër njerëz dhe fakti që ne ballafaqohemi pothuajse çdo ditë me njerëz tek të cilët Tata ka pasë ndikim në çfarëdo forme, neve na bënë shumë krenare dhe na ndihmon ta mbajmë dhe ta përcjellim tutje këtë përgjegjësi edhe te fëmijët tanë” shprehet Agata, sot një artiste e cila jo shumë kohë më parë hapi një ekspozitë në Mynih me 13 grafika të teknikës akuatintë dhe 11 pjata nga argjila në kombinim me filigran, që është një ndër artizanatet më të dalluara shqiptare.

Agata, pra, ka qenë edhe emri i nënës së Anton Çettës. Lazër Çetta ka qenë babai i Antonit. Ky i fundit ka qenë i dekoruar nga Presidenti Francez me medaljen “Officier

d'Académie” e akorduar në vitin 1928. Poashtu në vitin 1934 dekorohet për herë të dytë nga shteti francez me medaljen “Kalorës i Legjionit të Nderit (Chevalier de la Légion d'Honneur)”.

**Nga kjo familje vjen edhe Beniamin Çetta. Beniamin Çetta u lind në Tiranë në marsin e vitit 1937. I ati, Lazër Çetta pati mundësi të merrte kulturë dhe arsim perëndimor dhe u bë profesor i gjuhës frënge në një gjimnaz në Tiranë si dhe drejtor i drejtorisë së të drejtave të studimit në Ministrinë e Arsimit. Djali i madh i familjes, Antoni përfundoi Liceun e Korçës, ndërsa Beniamini do të studionte për Mjekësi.<sup>4</sup>**

<sup>4</sup><https://www.kultplus.com/libri/babai-i-anton-cettes-burri-i-forte-i-dekoruar-nga-franca/>



---

## Donika e Agata edhe sot i kthehen shkrimeve të Anton Çettës, duke reflektuar mbi intelektin e tij.

---

“Sa herë që lexoj shkrimet e babit kthehem në retrospektivë dhe udhëtoj me të në botën e tij paqësore, të bukur, të pasur, të qeshur me plot dashuri dhe urtësi. Shpesh në ato shkrime e gjej edhe përditshmërinë tonë duke gjetur përgjigjet për sot dhe për nesër. Po e veçoj një tregim që edhe pse i shkruar shumë vite më parë aq bukur e përshkruan situatën tonë momentale në vend:

*Kishte qenë një djalë që i kishin bërë magji dhe që shndërruar në gjarpër. Po ishte djalë i një babai të mirë. Kur hyri në moshën e pjekurisë i tha babait: “Baba, martomë”. Po si të martoj, more bir? Babai i shkretë, për të mos ia prishur qefin dhe mendoi se do të ishte një formalitet vajti dhe iu kërkoi vajzën, siç është zakon tek ne, një miku në katund. “Po ta kërkoi vajzën, në emër të zotit”, i tha. Po si ta jap për djalin gjarpër? – i tha ky. Vajza, që ndodhej prapa derës e dëgjonte dhe i tha babait që ta jepte, sepse kërkesa ishte në emër të zotit. Dhe, kështu babai ia dha. Kur do të shkonte kjo vajza nuse u këshillua me një grua plakë të mençur “Si të sillem me këtë gjarpër?”, e pyeti plakën e mençur. “Bijë e nënës, i tha kjo, vishi 7 këmisha. Kur të hysh në dhomë dhe të urdhëroi gjarpri “Hiqe këmishën” ti, do t’i thuash “Hiqe një lëkurë”. Dhe, kështu vazhdo “hiq një këmishë, e hiq një lëkurë”, deri sa të zhvishen shtatë këmishat e shtatë lëkurat. Kur i zhveshën këto, pastaj, dolën dy krijesa të mrekullueshme. Djali u lirua nga magjia, ndërsa vajza u bë një nuse shumë e bukur*



Fotografi nga albumi familjar i familjes Çetta



“Kështu njerëzit tanë duhet të zhvishen një herë e përgjithmonë nga mllefet ndërsa partitë shqiptare duhet të lirohen nga mëritë në mes vete. Nëse nuk çlirohemi nga këto brenga dhe antagonizma, nga këto të këqija, në rast se do të vazhdojmë me intriga ndaj njëri –tjetrit, procesi i zhvillimit të vendit tonë do të jetë shumë i ngadaltë” tregon Donika Çetta.

“Kohëve të fundit, pasi që isha pjesëmarrëse në përgatitjen e kompletit të veprave të Tatës, më është dhënë mundësia më shumë të lexoj rreth veprimtarisë së tij nga të tjerët por gjithashtu edhe krijimtarinë e tij. Jam ndjerë shumë mirë, por njëkohësisht me një barrë të madhe. Gjatë përgatitjes e kemi përfshirë edhe arkivin familjar, me material shumë të pasur për popullin, që do të kenë rastin t'i lexojnë kur të botohet” na thotë Agata.

Agata mban mend kujtime me antropologun Anton Çetta, njeriun merit

*Anton Çetta dhe Ibrahim Rugova*



edhe për themelimin e Institutit Albanologjik, deri në moshën 10 vjeçare.

Prej kur ka nisur aksioni për pajtimin e gjaqeve, në vitin 1990, Tata i Agatas ka qenë i tëri i përkushtuar në këtë proces. “Kalonim pak kohë bashkë. Gjatë javës shume rrallë shiheshim. Nga ajo moshë, pjesën më të madhe të kohës, për neve është përkujdesë mama. Përveç nesh, edhe për shtëpi e për njerëzit që kishin nevojë e vinin te ne. Tash kur i kujtoj fjalët e tij, i kam edhe më të qarta mesazhet që m'i ka dhënë. Ka shumë por njëra më është ngulitë: Kur Gjyshi e ka përcjellë Taten për në Liceun e Korçës, institucioni më i rëndësishëm edukativ i asaj kohe, i ka thënë: “Anton, çkado që bën, çfarëdo vendimi që merr, mendo, a do t'Veproje njëjtë po ta kishe Tatën afër. Këtë këshillë Tata e ka përcjellë edhe te unë dhe motra” tregon Agata, që veç e përsëritë Donikën në këtë pikë.

*Anton Çetta dhe Zekeria Caka*



*“Kultura e popullit nuk është si një tempull antik grek që mbështetet në shtatë – tetë shtylla, por kala e ngritur nga mija gurë, ku kujtoj se edhe unë kam vënë gurë, sado të vogël”*

## Anton Çetta

Herë te vajzat e tij e herë te Anton Çetta, është aspak e lehtë të shkruash për këtë figurë e cila mundësoi pajtimin e rreth 1200 gjaqeve e 600 plagosjeve, mospajtimeve mes shqiptarëve, problemeve kryesisht me gjakmarrje mes familjeve që ishin ngujuar për vite. Profesor Antoni së bashku me Esad Mekulin, Mark Krasniqin, Hivzi Sulejmanin, Idriz Ajetin, Kadri Halimin, Skender Rizajn e disa të tjerë përbënin brezin e parë, brezin e artë të intelektualëve shqiptarë të Kosovës të cilët e bartën barrën më të rëndë për ta arsimuar, edukuar, emancipuar popullin e Kosovës, duke u bërë kështu edhe bartës të zhvillimeve të jetës kulturore, artistike e shkencore të Kosovës.<sup>5</sup>

“Mua gjithmonë tek miqtë më prezentonte si sugaresha e tij, dhe kur shëtisnim ma vendoste dorën mbi supe. Kur e takonim dikë, iu thoshte: Sugaresha ime më ndihmon të eci, se mbështetem në të. Unë fluturoja nga gëzimi. Gjithmonë nëpërmjet ndonjë tregimi apo ilustrimi na jepte këshilla” tregon Agata.

Donikës i pëlqen sidomos përmbledhja “Në prehër të gjyshes”, kur duhet të përzgjedhë diçka nga krijimtaria e Anton Çettës. Në këtë vepër përfshihen vjersha apo poemtha të frymëzuara nga krijimtaria jonë popullore. Përmes tyre arrihet efekti edukativ, sepse u rekomandohet fëmijëve rruga e drejtë, forcimi i virtyteve më të larta e më të mira dhe luftimi i veseve të këqija. “Këto vjersha në formë të gojëdhënave, legjendave e përrallave gjithmonë më kanë bartur në botën imagjinative e magjepsëse e këtë efekt e ka edhe me fëmijët e mi, kur ju lexoj para gjumit. Fëmijët janë krijesat më të dashura dhe na kënaqin me atë sinqeritet, naivitet dhe pafajësinë e tyre. Çdonjëri prej nesh do të dëshironte të fitonte simpatinë e tyre me ndonjë vjershë, tregim apo prozë didaktike e kështu të kontribuonte sadopak edhe në edukimin e tyre etik, estetik e kulturor, e mendoj që babi e ka arritur mjaft mirë këtë sidomos me veprën e tij “Në prehër të gjyshes” e cila është lexuar brez pas brezi” vazhdon Donika.

“Thuhet se në momentet më të vështira popujt e mëdhenj nxjerrin nga gjiri i vet

<sup>5</sup><http://illyriapress.com/profesor-anton-cetta-plaku-i-urte-i-kombit-tone/>

bijtë dhe bijat më të mira për të udhëhequr drejt lirisë dhe shpëtimit. Kjo i ndodhi dhe popullit shqiptar vite më parë nën udhëheqjen e babit, studentëve dhe miqve të tij kur filloi pajtimi kombëtar shqiptar. Shtrirja dhe jehona e këtij pajtimi gjithkombëtar tregoi si kurrë më parë se pushtuesi nuk do të mund të ushqej në gjakun e shqiptarëve përmes nxitjes së hakmarrjes dhe mërive vëllavrasëse. Ishte koha kur, ashtu sipas traditës së të parëve tanë të lashtë populli shqiptar Kosovën e ktheu në një kuvend të besës, trimërisë dhe mençurisë. Ky popull i përvuajtur duke shtrirë dorën e pajtimit filloi shërimin shpirtëror kombëtar duke shtruar kështu rrugën dhe duke parapërgatitur këtë rini dhe këtë popull për të shkruar faqet më të ndritura të historisë tonë dhe për ta hapur udhën e çlirimit dhe shtetndërtimit të Kosovës” përfundon Donika.

*Do ta përfundojmë me Anton Çettën, njeriun i cili ka nevojë të citohet në libra, të flitet për të në rrugë, të ketë shtatore e bust për të, të ketë kujtime të shkruara, të ketë përkujtimore e të ketë ceremoni që na e sjellin në kujtesë atë. Gjeneratat e reja duhet ta lexojnë, gjeneratat e vjetra duhet të reflektojnë, librat e historisë e antropologjisë duhet ta marrin si shembull në secilin kapitull. Shkrimtarët duhet të inspirohen prej tij, studiuesit duhet ta vazhdojnë rrugën me të njejtin zell studimor të Çettës. Vajzat e tij, megjithatë, do të mbesin gjithmonë vajzat e Anton Çettës, njeriut me zemër të madhe e të mirë.*





## Muzeu Etnologjik

*Në Prishtinën pa lum, e gjeni lehtësisht Muzeun Etnologjik. Përmendur në libra, në rrëfenja e histori të ndryshme, Muzeu Etnologjik është vendi të cilin duhet ta vizitoni gjatë qëndrimit në kryeqytetin e Kosovës. Kushdo që vjen në këtë Muze, gjen kulturë, arkeologji, gjeografi, eksponate, vjetërsi që nuk bëhet asnjëherë e vjetër, retrospektivë e cila për fatin tonë është dokumentuar nga të gjallët e të vdekurit.*

## MUZEU ETNOLOGJIK, RRËFIMI PREJ EMINIT TË VOGËL E DERI TE ETNOKULTURA SHQIPTARE

Është një ndër komplekset më të vjetra në Prishtinë, ndërsa legjenda thotë se i pari i familjes aty ka qenë Emini. Emini, me shtat të vogël e trup thatanik, prej familjarëve dhe të tjerëve është quajtur me pjesën ledhatauese 'gjik gjik gjik', bash shkaku i trupit të shkurtër. Emini u bë Emin Gjiku, dhe kështu tërë kompleksit i mbeti ky emër.

Historinë e tregon Avni Emingjiku, i cili si 7 vjeçar në vitin 1959 u largua nga ky kompleks.

Ky kompleks sot është pjesë e Qendrës Historike të Prishtinës, dikur e quajtur Çarshia, në të cilën është investuar pak në krahasim me rëndësinë e trashëgimisë kulturore e shpirtërore që kjo pjesë bartë në vete.

Nuk ka shenja se si të arrish deri atje, njëjtë siç shpesh gjen vetura që parkohen edhe jashtë kompleksit në parkingun e dedikuar për Muze, një mentalitet që nuk i ka hije shqiptarëve plot traditë. Traditë dhe kulturë është edhe Muzeu Etnologjik në Prishtinë, apo ndryshe i quajtur edhe Kompleksi Emin Gjiku.

Bekim Xhemili, pjesë e stafit të Muzeut, shndritë kur duhet të tregojë për Muzeun, i cili është pjesë e Muzeut të Kosovës por u pavarësua me objekt në vitin 2006. Saktësisht, Muzeu i cili sot gjendet i pari në listën e TripAdvisor në mesin e atraksioneve turistike në Kosovë dhe është i binjakëzuar me Cambridge Folk Museum – Muzeun e Folklorit në Kembrixh të Anglisë, u hap me 11 shtator 2006.



“Kur e kemi bo intervistën me Avniun, na ka tregu për këtë kompleks dhe për vazhdimësinë e historisë familjare. Tregimi shkon deri në tri gjenerata, e kjo nuk mjafton për të ditur më shumë për historinë e kompleksit të vjetër 300 vjet. Gjyshi i Avniut, Hajrullahu – (hafëz) e ka ditë Kuranin përmendësh dhe ka pasur dy djem, Hetemin e Rexhepin (babai i Avniut), njëri berber e tjetri këpucëtar”.

“Kjo familje, në fillimin e viteve 40-të ka qenë një prej familjeve më të pasura në Prishtinë, dhe ka pasur në pronësi edhe prona tjera. Më pas familja e humbi primatin e familjes së pasur e të fuqishme ndërsa rreth viteve 1957-59 familja vendosë ta shesë kompleksin dhe shpërngulet për në Turqi. Që nga ajo kohë kompleksi është pronë e Muzeut të Kosovës. Thuhet se kontratën e ka nënshkruar vetë Fadil Hoxha, meqë ishte pronë me interes shtetëror plot 21 ari” tregon tutje Bekimi.

I kthehemi më pas kësaj historie, për të kaluar pak në njerëzit dhe copëzat e tregimeve që i dhanë oksigjen e frymë jete Muzeut i cili sot vizitohet prej 15-20 mijë vizitorëve në vit, me rreth 80 % të tyre turistë.



*David Mbyrne Photography*



*Elizabeth Gowling*

---

## Ndryshe përjetohet çdo emocion kur je brenda Muzeut

---

Në librin e tyre me titull "Kosovo – the Bradt Travel Guide" – një lloj guide rreth vendeve të cilat një turist duhet t'i vizitojë gjatë qëndrimit në Kosovë, autorët Verena Knaus dhe Gail Warrander e përmendin patjetër edhe Kompleksin Emin Gjiku. "Lejojani vetes së paku një orë për të shëtitur nëpër këtë kompleks ku vërehet ndikimi otoman" shkruajnë autorët në këtë libër.<sup>1</sup>

Nuk është më pak i veçantë tregimi i Elizabeth Gowing. E ardhur në Kosovë para disa vitesh si turiste, Gowing ende jeton në Kosovë, e mahnitur sidomos me Muzeun Etnologjik të Kosovës.

Sa për ta bërë edhe më pikante dashurinë e saj për Kosovën, ditëlindja e Elizabeth është me 28 nëntor – ditën kur shqiptarët gjithandej e festojnë shtetin shqiptar dhe flamurin me shqiponjë.

"Kur e kuptova këtë rastësi të bukur vendosa që me 28 nëntor 2006 ta festoj ditëlindjen në mënyrë më të madhe se zakonisht. Kam kërkuar leje me e shfrytëzua hapësirën e Muzeut Etnologjik për një ndejë. Ka qenë një natë shumë e ftohtë

dhe me mjegull, por kemi vendosur qirinjtë pranë shtegut që çon kah dyert e mëdha të Muzeut e deri te dhoma e zjarrit, ku kemi shërbye verë të nxehtë, dhe gjithçka ka qenë si përrallë" tregon Elizabeth. Ajo ka punuar si vullnetare për dy vite në Muze në aspektin e promovimit të tij dhe poashtu edhe si mësuese e gjuhës angleze. Elizabeth, ndër ato gratë e veçanta që nuk punon në asnjë projekt nëse nuk lë një copëz shpirti brenda, e përmendë Muzeun Etnologjik në katër libra të saj.

Një prej këtyre librave është edhe "Travels in Blood and Honey: Becoming a Beekeeper in Kosovo."<sup>2</sup>

"Muzeu Etnologjik është vendi im i preferuar në Prishtinë. Ndoshta jam personi i parë ndonjëherë që këtë pjesë të bukur e ka shfrytëzuar për festime ditëlindjesh (me përjashtim të familjes që ka jetuar aty)....Po filloja të ndjeja se unë përkas këtu diku, në këtë pjesë të Evropës. Tash edhe po e ndjeja lidhjen e veçantë përtej Prishtinës" shkruan në këtë libër Elizabeth.<sup>3</sup>

Ç'të bësh që Muzeu i tillë nuk ka as faqe personale/website online, në një kohë moderne, por megjithatë nuk e sheh këtë si problem. Kushdo që vjen në këtë Muze,

---

<sup>1</sup><https://www.amazon.com/Kosovo-2nd-Bradt-Travel-Guide/dp/1841623318>

<sup>2</sup>[http://www.elizabethgowing.com/pb/wp\\_f504d6c9/wp\\_f504d6c9.html](http://www.elizabethgowing.com/pb/wp_f504d6c9/wp_f504d6c9.html)

mund të gjejë histori, kulturë, arkeologji, gjeografi, eksponate, vjetërsi që nuk bëhet asnjëherë e vjetër, retrospektivë e cila për fatin tonë është dokumentuar nga të gjallët e të vdekurit.

Bashkim Tejeci – filigranist nga Prizreni, tregon se Muzeu Etnologjik si i tillë është vlerë e shtetit dhe duhet ruajtur e besa besa brenda tij edhe duhet investuar. Bashkimi në rreth katër raste ka demonstruar zejen e filigranit – bashkë edhe me ekipin e tij, për vizitorët por edhe për ata që duan ta shohin filigranin duke marrë formën si foshnja e posalindur,

brenda një objekti që është vatër meditimi edhe kur ka plot zhurmë, njerëz, histori edhe në ajër e sipërfaqe.

“Unë kam demonstruar disa herë në Muzeun Etnologjik, por edhe kam qenë në vizitë studimore në Kembrixh kur Muzeu Etnologjik është binjakëzuar me Muzeun në Kembrixh. Kemi shkëmbyer traditat dhe kulturat tona, duke i treguar anglezëve atje për traditat tona kombëtare dhe për filigranin si një karakteristikë e veçantë” tregon Tejeci, i cili vepron e jeton në Prizren.

---

## **Një muze i njohur ndërkombëtarisht, përzierja e disiplinave dhe historia që nuk bën të stagnojë**

Muzeu etnologjik ose etnografik e nënkupton objektin në të cilin janë të konservuara dhe të ekspozuara artefaktet që dëshmojnë për trashëgiminë kulturore të një etnie a komuniteti. Ekzistenca e një muzeu të tillë sot është praktikë në shumë qytete të Evropës, ku nëpërmjet muzeve etnografikë u rikujtohen banorëve veçoritë dhe mënyrën e jetesës së paraardhësve, siç edhe i njoftojnë vizitorët e huaj me tiparet dhe mënyrën tradicionale të jetesës në atë qytet. Përzgjedhja e artefakteve dhe eksponateve të veçanta identifikuese për banorët dhe jetën e tyre në një kohë të kaluar, të cilat janë të konservuara dhe të

tubuara në një vend duke arritur ta improvizojnë të kaluarën si tërësi brenda një hapësire të vogël siç mund të jetë një shtëpi tradicionale, është një njoftim shumë lehtësues dhe konkret për të huajt që të marrin informacionin për qytetin, kulturën dhe banorët e tij në të kaluarën. Pra muzeu etnografik si tillë, ka dy role: kujtues e përkujtues për banorët vendas si edhe informues e turistik për vizitorët e huaj.

Kështu na tregon Arbnora Dushi, folkloriste në Institutin Albanologjik në Prishtinë.



Bekimi, pjesë e Muzeut, na tregon tutje se si është i zhvilluar momentalisht Muzeu Etnologjik, në zemër të Prishtinës dhe i qashtëm për të gjithë ata që duan të kalojnë pak kohë duke u zhytur në etnologji, antropologji, mënyrë jetese të shqiptarëve ndër shekuj, ekspozate, qypa e çardaka.

Kompleksi dikur ka qenë Muze i Natyrës, me kopësht zoologjik, me arusha e me ujçer e kafshë të tjera.

**Deri në vitin 2001, mbi 1 mijë ekspozate të sektorit të natyrës i kanë lënë vendin renovimit të të dyja objekteve, që ekspozita pasuese të jetë në formën ideale për t'iu prezantuar vizitorëve.**

Ndërtesa kryesore ku gjendet ekspozita kryesore, ka gjashtë dhoma, dy korridore e dy çardaka. Ndërtesa përballë saj ka qenë e njohur si shtëpia e miqve – e mysafirëve, e ndërtuar kuptueshëm në stilin e ndërtesave osmane.

Shtëpia e miqve, të cilën e gjeni nëse futeni në Kompleks dhe shkoni deri në fund në anën e majtë, ka tri dhoma: dhoma e zjarrit është e para, aty ku edhe është përgatitur dhe është ngrënë ushqimi, aty ku sinijat e tepsijat janë prej bakri dhe janë përdorur dukshëm asokohe

vetëm prej familjeve më të pasura dhe me një status më të lartë shoqëror. Janë dy hyrje, njëra për familjen dhe tjetra për mysafirët. Maxhja është shfrytëzuar për përgatitjen e ushqimit dhe pijeve.

Jashtë, në hyrjen tjetër me shkallë, është çardaku, afër pjesës në formën e verandës apo terracës. Brenda objektit, dhoma e grave dhe fëmijëve është shfrytëzuar kur gratë janë kujdesur për fëmijët e tyre. Dera e cila ndanë dhomën e fëmijëve – grave dhe dhomën e mysafirëve (oda e burrave) është punuar me lesh të lëkurës së dhisë, kjo për të ruajtur akustikën dhe larguar zhurmën si dhe për ta mbajtur ngrohtë shtëpinë gjatë dimrit, freskinë gjatë verës.

Dyert e vogla kanë qenë të tilla për shenjë respekti, sepse je përkulur për të dalë prej tyre dhe ke qenë i përkulur kur je futur në dhomën tjetër.

Kur u rrit numri i anëtarëve të kësaj familjeje e cila jetoi aty në shekullin 18, lindi nevoja edhe për objektin tjetër, në këtë rast objektin kryesor dhe ahriin që gjendet në anën e djathtë në hyrje të Kompleksit.

Duke numëruar të gjitha objektet, janë rreth 12 dhoma që ekspozojnë histori, rreth 1400 ekspozate që presin shpirtat kurioz për vizitë.

“Prania e këtij tipi muzeu edhe në Prishtinë, siç është Muzeu Etnologjik, i jep një vullë identifikuese qytetit tonë, duke e bërë të paharrueshëm për vizitorët. Të paharrueshëm qytetin, jo Muzeun, sepse për një të huaj që e viziton Prishtinën dhe

largohet, Muzeu mbetet kujtimi i tij për Prishtinën. Besoj e kuptoni sa është i rëndësishëm ky muze për trashëgiminë kulturore të Prishtinës në veçanti, dhe të Kosovës në përgjithësi” vazhdon Arbnora Dushi.



Me gjithë fjalët e mira për Muzeun Etnologjik, nevojën për ndryshime brenda tij bashkë me ritjen e përgjegjësisë duke qenë vendi më i vizituar në Prishtinë në fushën e trashëgimisë kulturore, e tregon Dushi.

“Aty ku na shohin të tjerët pse të mos mundohemi të dukemi më së miri që mundemi? E ne mundemi. Një organizim për grumbullimin dhe blerjen e ekspozateve, të cilat fatmirësisht mund të gjenden tek familjet apo artizanët në Prishtinë e në Kosovë do t'i jepte më shumë ngjyra dhe shpirt Muzeut, por edhe do ta bënte më joshës dhe më reprezentativ para vizitorëve. Unë besoj shumë që ka edhe njerëz të vullnetit të mirë që do të ishin të gatshëm edhe të falnin ekspozate, por kjo punë kërkon një organizim dhe përkushtim serioz për pasurimin e Muzeut me ekspozate, të cilat do të shërbenin për pasurimin e tij me artefakte” përfundon Dushi.

“Dua që në këtë Muze të ketë më shumë risi e freski. Duhet të bëjmë çmos që të ekspozojmë gjërat e vjetra, të hulumtojmë edhe se si në treva të ndryshme punimet e vjetra të bakrit shiten si hekurishte, duhet më shumë ekspozate dhe të mos jenë gjithmonë të njëjtat aty, duhet të sjellim qypa të rinj, valuta. Në Kembrixh, prej kurgjofit krijonin diçka, ndërsa këtu i kemi vlerat por po punohet pak” tregon tutje Bashkimi – filigranist.

Bashkim Tejeci flet edhe për filigranin, për të cilin thotë se si zeje duhet ruajtur e duhet përkrahur edhe institucionalisht, meqë sipas tij pala serbe po e bën të pamundurën ta bëjë të sajën por edhe ta zhdukë një pjesë të mirë të traditës e kulturës shqipe.

Duhet të kujtojmë këtu se sipas shënimeve, Koleksioni Arkeologjik dhe Etnologjik i Kosovës (676 ekspozate arkeologjike dhe 571 ekspozate etnologjike) vazhdon të mbahet në Serbi.<sup>3</sup>

<sup>3</sup><https://www.kultplus.com/trashegimia/disa-pjese-te-veshjeve-popullore-qe-jane-pjese-e-trashegimise-se-luajtshme-te-muzeut-te-kosoves-foto/>

## E gjithë bota zbarkon herët e vonë në Muzeun Etnologjik në Prishtinën simpatike

Te Muzeu Etnologjik nëpër vite është mbledhur histori. Pazarë i Grave ose pazarë i plaçkave dikur ishte traditë në qytete të ndryshme të Kosovës. Mbahej të martave, herë në hapësirat e garazheve të sotme të RTK-së e herë në brendi të lagjes në të djathtë të pikërisht Muzeut Etnologjik, e herë në hyrje të sokakut.<sup>4</sup>

Bekimi nga Muzeu Etnologjik vazhdon të na tregojë tutje se si zhvillohet jeta brenda këtij Muzeu. Vizitorët vijnë nga të gjitha anët, prej Tajvanit e deri në Japoni, prej Kinës e deri në Malajzi, prej Signaporit e deri në Indonezi.

“Një pjesë e njerëzve që vijnë këtu, pos interesimit për etnokulturën e popullit të Kosovës në të kaluarën dhe sot, i kanë dy pyetje shtesë: cilat janë marrëdhëniet mes Kosovës e Serbisë, dhe a dëshirojnë kosovarët bashkimin me Shqipërinë. Ne që funksionojmë si Kustos – persona profesionistë të cilët specializohen në fushë të caktuar – në këtë rast në etnologji, dhe mund të bëjnë studimin e interpretimin e ekspozateve por edhe punën e ciceronit, dhe stafi që tani punon

këtu me fuqinë më të madhe që gjithçka të dalë mirë, e shpjegojmë Muzeun edhe duke u bazuar në shtetin prej nga vijnë vizitorët” tregon Bekimi.

“Ne këtu flasim prej arkeologjisë deri te historia, gjeografia, popullata, mënyra e jetesës, pra jemi guidë më gjithëpërfshirëse. Prej këtu ne i shpjegojmë qytetet tjera, sado që kjo është e vështirë. Madje jemi një prej muzeve të vetme në rajon që funksionon me guidën e tillë, dhe jo me audio-guidë. Me ekspozitën tonë udhëtojmë bashkë me vizitorët duke folur për Evropën, Azinë, Afrikë, për lidhjen e kulturave, për diversitetin” vazhdon Bekimi.

Ndërtesa kryesore, ekspozita ku tregohet jeta, lindja, vdekja, kultura shpirtërore në tërësi, me rreth 60% të ekspozateve brenda tij, momentalisht është në renovim e sipër, edhe pse viti 2018 e ka gjetur këtë ndërtesë jo-funksionale dhe punimet kanë ndaluar. E po në këtë ndërtesë flitet për Kosovën, rajonin, Ballkanin, gjatë periudhave të kaluara.

“Ka qenë e nevojshme të fillonte renovimi shkaku i fasadave, dritareve, drunjët dhe trajt është dashur të ndërroheshin sepse ka filluar kalbja edhe nuk ka qenë as vend i sigurt për turistët që vinin. Këto janë

<sup>4</sup><https://www.kultplus.com/trashegimia/pazari-grave-te-martat-dhe-ardhja-e-janjevalive-foto/>

objekte që dëmtohen me kohën por duhet ruajtur” shton Bekim Xhemili.

Bekimi është etnolog dhe pjesë e Muzeut, krahas edhe Ilir Sopjanit, Erodita Qorkadiu – Haxhiut, Fatos Bimbashit dhe Anduena Balaj – Thaçit.

Elizabeth Gowing thotë se ky Muze, pa marrë parasysh zhagjitjet e mëdha, investimet e vogla dhe mbarëvajtjen e tij, e ka vlerën e vet dhe rëndësinë jetike.

“Mundesh me mësu aty për domethënien e gjërave dhe për kulturat që pasqyrohet në të. Shembull, me e pa dhomën e mysafirëve në shtëpinë e vjetër, me qasje nga rruga, me pa vegëza ku varet arma (për shkak që mysafirët mbesin nën mbrojtjen e zotit të shpisë), dera e vogël ku mysafirët duhet me e ulë kokën për me hy brenda ose mangalli ku zoti i shtëpisë e ndezë cigaren... Mundesh me mësu shumë ma shumë për mikpritjen tradicionale dhe rolet e njerëzve prej këtyre gjërave dhe vizitës në Muze sesa nga një libër” thotë Gowing.

Gjatë verës, Muzeu bëhet edhe më i bukur. Oborri jashtë reflekton gjelbrim. E meqë Prishtinës i mungojnë hapësirat e gjelbërta në qendër të qytetit, është kënaqësi për secilin e secilën që ta vizitojë

Muzeun dhe të ulet nën arrë e të pushojë. Tregojnë se në këtë oborr njerëzit vijnë të shkruajnë poezi, të pikturojnë, të bëjnë ushtrime yoga e të meditojnë, në çdo stinë e mundësi, në këtë pjesë të qytetit ku zogjtë janë jehona e vetme kumbuese që e kap veshi.

**Shumë ngjarje nëpër vite kanë ndodhur në këtë Muze, të cilat veç sa ia kanë shtuar rëndësinë dhe dashurinë e publikut. Ngjarje të ndryshme artistike e kulturore mbahen edhe sot.**

Këngëtarja Elina Duni, shembull, në vitin 2016-të pati një mbrëmje muzikore në Muzeun Etnologjik në kuadër të KAEF. Po këtu u mbajtën edhe “Java e Artizanateve”, “Rrëfimtari popullor”, një shfaqje e regjisorit Bekim Lumi, “Gatimet tradicionale” apo edhe “Konkursi për fotografi të muzeut”.

Arbnora Dushi e kujton edhe një ngjarje tjetër. Instituti Albanologjik në bashkëpunim me Komisionin Ndërkombëtar të Baladës me qendër në Aberdeen të Skocisë, patën organizuar në vitin 2015 Konferencën e 45'të të Baladës. Ishin diku rreth tridhjetë pjesëmarrës nga të gjitha vendet e botës dhe për katër ditë u zhvilluan seanca akademike në sallën e Institutit. Komisioni Ndërkombëtar i

baladës, të cilët organizonin konferenca të këtilla për çdo vit në vende të ndryshme të botës, e kishin praktikë në kuadër të aktivitetit social të organizonin një mbrëmje të quajtur “Nata e baladave”, ku secili pjesëmarrës i konferencës i këndonte baladat e kulturës së vet.

“Atë vit, ne që ishim vendi nikoqir, për “Natën e baladave” vendosëm të zhvendosemi nga Instituti në Muzeun Etnologjik, ku përpos baladave të njëri tjetrit, studiuesit e huaj bashkë edhe me studiuesit shqiptarë që morën pjesë në atë konferencë, patën rastin të vizitojnë Muzeun, të relaksohen në oborrin e

rregulluar të tij si dhe – më e bukura e asaj mbrëmjeje, të shijojnë ushqimet tona tradicionale, ku dy zonja nikoqire nga Muzeu që mbanin veshje kombëtare, për mysafirët i përgatitën aty pitet e flijat me saç, duke performuar kështu mikpritjen shqiptare krahas gastronomisë me recetat tradicionale” kujton Dushi.

Më mirë se çdo material a dorëshkrim tjetër, një vizitë në Muzeun Etnologjik do ta shuaj kureshtjen e secilit, një mënyrë tjetër për ta mbajtur gjallë njohurinë për traditën dhe kulturën e popullit dhe të parëve tanë.







## Dilaver Kryeziu

*Një burrë i veçantë i cili ndër dekada ka vallëzuar, ka mësuar edhe të tjerët të vallëzojnë. Koreografi Dilaver Kryeziu është personifikimi i durimit, finesës dhe lëvizjes së trupit. Shpirt i rebeluar por një biografi e mbushur me suksese, më pak dështime. Dilaver Kryeziut nuk ka tregim në jetë që nuk i lidhet me vallen, me koreografinë, me bukurinë e veshjeve kombëtare, me trevat shqiptare.*

# 03

## DILAVER KRYEZIU: NJË JETË DUKE VALLËZUAR

---

**Në vitin 1980, ai u shpall valltari më i mirë në Jugosllavi, dhe këtë epitet e morri në mes të Beogradit.**

Emrin e Dilaver Kryeziut do ta mësonte jo vetëm Beogradi kulturor i asaj kohe. Të gjitha krahinat ku ka depërtuar këmba e shqiptarit do të njoftoheshin me karizmën dhe profesionalizmin e Kryeziut. Një prej koreografëve më të mirë shqiptarë dhe një burrë i cili ka nxjerrë gjenerata të ndryshme valltarësh në të katër anët e shqiptarisë, Dilaver Kryeziu sot është koreografi i parë shqiptar me Akademi të përfunduar.

Nuk është e befashme që Kryeziu, nga një valltar sot është një profesor dhe një koreografi i rafinuar. Prejardhja e tij prej Karadakut të Anamoravës flet vetë, por flet pak për jetën e këtij njeriu.

Në këtë rrëfim, 61 vjeçari tregon se si nisi jeta e tij prej një valltari, se si nuk përfundoi në fushën e ekonomisë por aty ku trupi tronditë tokën me trokitjet që i bën dërrasave, skenës, dhe vetes.

“Vallëzimin e kam dhunti të Zotit, prej lindjes”, tregon Kryeziu.

“Në klasën e pestë, për afërsisht kur isha 12 vjeçar, më kërkuan të hyja të vallëzoja për msitni – msiti është grupi që vjen për ta kërkuar dorën e vajzës kur ndodhë fejesa a martesë. Asokohe është dashtë me qenë goxha në nivel për me u futë në këto oda përpara msitit. Vallëzoja dhe pas një pushimi, më kërkuan për së dyti të futesha të vallëzoja mes burrave. Ndoshta këtu nisi të ushqehet brenda meje ndjenja e valles” tregon Kryeziu.

Ai do të vazhdonte të merrej me vallëzim, duke iu përshtatur valëve të jetës të cilat shpesh e gjuanin prej një këndi në tjetrin kënd. Vallëzimi nuk do ta lëshonte prej dorës këtë burrë që duket i rreptë dhe strikt me nxënësit e tij. Por ai zgjodhi t'i rrinte besnik valleve, folklorit.

“Vazhdova rrugëtimin për në Prishtinë ku u futa në Gjimnazin “Xhevdet Doda”, gjithmonë si një valltar i mirë, duke u kthyer në vendlindje dhe rreth saj kudo ku më thërrisnin të vallëzoja, shpesh bashkë edhe me tupanxhinjtë meqë ata nuk shkonin pa mua. E kemi edhe Dilaverin me vete, thonin shumë prej tyre” tregon Kryeziu.

Kryeziu përfundon Gjimnazin në Prishtinë, në vitin 1977, ndoshta edhe pa e ditur se i është rrekur një ëndrrë e cila kishte bërë pakt me fatin e tij, për një sukses të madh në vitet që pasonin.

Si maturant ai ishte tanimë pjesë e Ansambilit 'Ramiz Sadiku' – Ansambli i Studentëve të Universitetit të Prishtinës. Në tryezë, derisa bisedojmë, jo pak herë ai e përmend një dhe vetëm një emër: Panajot Kanaçi. Bëhesh kurioz menjëherë ta kuptosh se çfarë vendi zë ky njeri tek personaliteti i profesorit Dilaver.

“Kur e mbarova gjimnazin me shumë sukses, u regjistrova në Fakultetin Ekonomik. Qysh në afatin e parë e fitova kushtin, sepse i kalova gjashtë provimet e qershorit dhe po mendoja se po ecja mirë në këtë fushë. Në atë periudhë në Prishtinë vjen Panajot Kanaçi – i njohur ndryshe edhe si babai i koreografisë shqiptare. Unë atëherë isha pjesë e Ansambilit të Studentëve, udhëhequr prej Xhemajli Berishës, dhe Panajoti po kërkonte valltarë për pjesën 'Halili dhe Hajria', i duheshin valltarët popullorë. Ai asokohe shkoi në Ansamblin e Këngëve dhe Valleve 'Shota' për audicion, por nuk e gjeti askënd të përshtatshëm. Kur vjen tek ne, menjëherë më sheh mua dhe thotë – Ky është ai, valltari burimor që më nevojitet. Takohem me të dhe i tregoj se jam student, por ai më thotë se e ardhmja ime është në koreografi, duhej të shkollohesha në këtë fushë, edhepse asokohe vetëm Tirana dhe Moska kishin shkollë për koreografi. Me Tiranën e dini se si ishin kushtet atëherë, ata vinin por për neve ishte vështirë të shkonim atje” vazhdon rrëfimin Dilaver Kryeziu.

Kësisoj, djali i ri i cili do të kthehej në profesor dhe krijues vallesh, largohet nga Fakulteti Ekonomik, i përvishet valles. Jeta i rezervon tash diçka tjetër.



Misioni prej ushtari nuk e lejon të largohet për në Sofje, atje ku pranohet në Akademi, në Fakultetin e Kulturave Folklorike. Sofja shkon dëm, Dilaveri duhet të përfundojë shërbimin ushtarak.

Kthehet nga ushtria dhe punon më pas si referent për kulturë në Qendrën e Studentëve në Prishtinë.

“Kam qenë gjithmonë pak problematik në jetë. Disa situata gjithmonë më kanë gjetë me probleme. Këtu bëj disa probleme me një serb, dhe më largojnë. E ka thënë Faik Konica – shqiptari t’i falë të gjitha, pos suksesit. Këtu, shkaku i një skandali, më largojnë dhe më pas futem në recepcion, në konviktin e femrave. Kanë qenë dy vite fantastike të cilat nuk i harroj” tregon Kryeziu.

Shpirt rebeli, Kryeziu ecën tutje.

Shkon në Zagreb i ftuar prej Ivan Ivančan – etnolog e koreograf i njohur në Kroaci, dhe atje qëndron për nëntë muaj nën këshillat e Ivan an por edhe duke marrë oferta për tu futur thellë në botën e koreografisë.

Në vitin 1987, Dilaver Kryeziu e udhëheqë trupën e Kosovës në Lojërat Universitare në Zagreb.

Kosova do të ishte e vetmja trupë vallëtarësh që merr mirënjohje, me Dilaver Kryeziun në fron. Dhe këtu, Kryeziu thotë se u bind që e ardhmja e tij nuk ishte me numra, as me llogaritje, por me lëvizje trupi dhe hulumtim folklori përkthyer më pas në koreografi, valle, muzikë e rroba kombëtare.

Do t’i kthehemi prapë karrierës së Kryeziut, derisa ai e shpalosë tregimin e tij në tavolinë.



Ai sot ka tre fëmijë, prej të cilëve dy i ndoqën hapat e tij, duke qenë vetë valltarë. Kujtimi dhe Rrezja për vite me radhë kanë qenë valltarë. Për Rrezën, Kryeziu thotë se është valltare e pazëvendësueshme, paçka se ajo sot është nënë dhe një profesoreshë në Akademinë e Muzikës, dhe jo një valltare si dikur.

“Dila sot është shoku më i mirë të cilin një vajzë mund ta ketë. Është dashuria ime e parë. Sa i përket vallëzimit, ai nuk ka ndikuar tek unë sepse më e pakta që ai donte ishte të imponohej. Për mua, dëshira për valle lindi e buroi nga brenda” tregon Rreze Kryeziu, vajza e profesorit.

Ajo thotë se sot nuk do të donte të bëhej vetë koreografe, pasi është keqkuptuar shumë të qenit koreograf, dhe është një pjesë e vështirë.



Ose duhet ta posedosh burimin e pashtershëm krijues brenda vetes, ose nuk do të jesh kurrë një koreograf i kompletuar.

“Duhet të jesh krenar dhe faleminderit që ke krijuar tre fëmijë- tre njerëz të mirë” është porosia që Rrezja ka për Dilaver Kryeziun, babain e saj.

---

## Vallëzimi nëpër botë

---

Dilaver Kryeziut nuk ka tregim në jetë që nuk i lidhet me vallen, me koreografinë, me bukurinë e veshjeve kombëtare, me trevat shqiptare të cilat për fat të mirë të Kryeziut janë të pasura me folklor e me trashëgimi. Kryeziu, me sy i ka shijuar këto treva, me vesh ka marrë gojëdhënat e tyre dhe si një rrobaqepës i shkëlqyer ka qëndisur valle e melodi që sot kërcen nga rreth 800 të rinj e të reja, studentë poashtu, me të cilët Kryeziu punon në pesë ansamble nëpër Kosovë dhe jashtë saj.

Kthehemi tek vitet 90-të, atëherë kur situata do të ndryshonte, për Kryeziun njëjtë sikur edhe për çdo shqiptar që krijonte a nuk krijonte.



Krijimi u bë më i vështirë. Edhe jeta, e mbijetesa. Për Dilën, siç e quajnë shumica, vështirësia ishte fjalë që nuk ekzistonte.

Në vitin 1988, me dy valle që i krijoi, ai merr pjesë në Festivalin e Daruvarit – Takimet e Majit në Kroaci. Vallja me motive Prespane u shpall më e mira në festival, kërcyer prej Ansambllit të Studentëve. Valles i printe asokohe Sylejman Shala. Me po këtë Ansambël ai shëtitë Evropën, shkon në Sicili e Kalabri e Francë e në shtete të tjera, për të sjellë emocionin më të fuqishëm shqiptar para syve të botës.

**Jo pak herë publiku do të qante prej kërcimit dhe prej emocioneve që sjellin vallet dhe valltarët e dalë prej dorës së Kryeziut.**



Në vitin 2002 në Turqi, gjegjësisht në Silivri, një turmë e shqiptarëve do të qante duke parë valltarët nga Kosova të performonin në festivalin ku ata dolën të parët, me pjesëmarrjen e tyre të parë.

Kur nisi tensioni me regjimin, festës së muzikës do t'i ulej zëri, por asnjëherë nuk do t'i mbytej shpirti. Jo aty ku ishte Dilaver Kryeziu.

**“Në vitet 1990-91 na shpërndanë të gjithëve. Ansamblin e Studentëve e transferova në Dodonë, dhe me ndihmën e Teatrit Dodona por edhe të Rektoratit vazhdova punën. Në një kohë kur turma e madhe e familjeve nga Kosova po e lëshonin vendin shkaku i kohës që po vinte, unë me 250 studentë e nxënës ishim në Dodonë duke ushtruar, çdo vikend, me profesionalizëm deri në maksimum dhe me vullnet prej të gjithëve. Githçka, çdo punë dhe çdo hap frymonte më shqip se kurrë” tregon Kryeziu.**

Me largimin e Xhemajli Berishës nga Ansambli i Studentëve, ai bashkohet me Fahri Beqirin të cilin e pati mentor në punën e tij.

“Fahri Beqiri ka qenë alfa dhe omega, krahu im i djathtë në punë, i cili e krijoi muzikën e

shumë valleve që i zhvilluam më vonë dhe me të cilat patëm sukses gjithandej” tregon Kryeziu.

Nuk ka më pak fjalë e lavdata për Kryeziun edhe vetë Fahri Beqiri, të cilin e takova në një prej kafeneve të Prishtinës. Më 1 shtator 1967 atë e emërojnë 'drejtor të dhunshëm' në Ansamblin Shota. Diplomohet për kompozim në Beograd, ndërsa më pas bashkëpunon me Kryeziun.

“Prej asgjësë krijonim diçka të bukur. Dhe gjërat sajoheshin mirë sepse unë, Dilaveri dhe Xhemajli Berisha u bëmë bashkë dhe e kishim atë kremin, kompotin e më të mirëve në tokat shqiptare asokohe në Jugosllavi. Dilaveri është një djalë që e don punën e tij, por edhe e din mirë. Një punëtor i pashembullt për të mirë i cili edhe sot nuk përton të punojë me fëmijët, të rinjtë, studentët por edhe me profesionistët” tregon Fahri Beqiri, një bashkëpunëtor në mbledhjen e folklorit por edhe në lindjen e valleve e melodive të reja të cilat valltarët e Dilaver Kryeziut i shpërndanë gjithandej.

“Bashkë, kemi pasur vullnetin të merremi me begatinë e folklorit shqiptar dhe jam i lumtur që kemi lënë shumëçka të bukur në vallet dhe meloditë tona” tregon Beqiri.

## Vallja që s'ndalet

Dilaveri e vazhdon jetën e tij, krijon familje, krijon miqësi të reja dhe bashkëpunime. Djali i ri që futej mes msitnisë tani do të kthehej në një burrë që me mëngët përveshur, nisë ato që valltarët e tij i quajnë 'ushtrimet-nxemje' dhe drejt e në mësimin e koreografive të reja.

Sot numërohen 18 koreografi që mbajnë vulën e Kryeziut. Pos Fahri Beqirit, edhe Valton Beqiri, Ben Topalli, Halil Krajka e të tjerë kompozitorë e kanë ndihmuar Kryeziun në këtë udhëtim.

Janë jashtëzakonisht të mishëruara dhe të përjetuara, kur kërcëhen Vallja e Librazhdit, apo Suita Kosovare, apo Vallja me Motive të Karadakut. Nuk sheh meshkuj e femra më të bukur e të formuar se ata që i kërcëjnë këto valle, që duken si piktura që i ka pikturuar me dorën e tij profesori Dilaver. Profesori e ka përfunduar monografinë e pesë valleve të Karadakut ndërsa para pak muajsh e ka përfunduar edhe vallen me motive nga Elbasani.

Ngushtohet të flasë për valltarët e tij të preferuar ndër vite, meqë mijëra e mijëra kanë kaluar nëpër këshillat dhe mësimin e ligjërimitin e tij.

“Arbana Maxharraj, Gazmend Blakaj, Brikena Blakaj, Advije Xhemajli, Albana Duli... ka edhe plot e plot emra që ndoshta tash nuk më kujtohen por me të cilët kam punuar ndër vite dhe kemi kaluar kohë të mirë” tregon Kryeziu.

Me Ansamblin e Studentëve të Universitetit të Prishtinës, kanë qenë rreth 20 çifte, primabalerina e primabalerinë të cilët Kryeziu i nxorri si pasaportën e tij artistike para botës.

Brikena Blakaj është njëra prej tyre. Ajo ka nisur të vallëzojë në moshën 9 vjeçare, ndërsa shpejtë u bë edhe soliste në vallen me motive nga suita dhe vallen me motive nga Tropoja. Ajo shquhej për shpejtësi dhe teknikë në vallëzim, dhe me sharmin e elegancën që e posedon, Brikena u bë muza e Kryeziut.

“Në një kohë kam qenë edhe asistente e Dilaverit dhe i kam përgatitur e ushtruar edhe grupmoshat më të reja. Ky transformim ka qenë gradual dhe duke fituar përvojë në vallëzim, e kam shijuar më pas edhe skenën. Dilaveri si koreograf ka pasur shumë disiplinë. Kur kemi pasë ushtrime apo performancë, gjithnjë ka pasur rregull në maksimum. Ka ditur ti identifikojë edhe personalitetet e secilit gjatë punës në grup. Ka pasur raste kur edhe notat në shkollë i ka kontrollu, mos po

ngecim në mësimë” tregon Brikena. Ajo ka qenë valltare aktive për rreth 16-të vite të jetës së saj.

**Kryeziu, koreografi i njohur i shqiptarëve, për një kohë punoi edhe si drejtor gjeneral në Ansamblin e Këngëve dhe Valleve 'Shota'.**

Në po këtë kohë, 'Shota' zuri vendin e tretë në një festival të madh të ansambleve në Seul të Koresë së Jugut.

“Aty kam pasur shumë sukses dhe kam dhënë shumë kontribut. Edhe sot më kërkojnë, sepse unë ndihmova edhe me infrastrukturë. Kam aplikuar prapë, vetëm që ata ta dijnë se unë nuk jam ai që ata mendojnë dhe proklamojnë. E gjithë energjia ime sot megjithatë shkon tek 'Zëri i Kosovës' – ansambël nga Fushë Kosova, dhe mendoj se ata janë momentalisht një ndër ansamblet më të mira në trojet shqiptare” tregon Kryeziu.

“Dikush thotë, çka është teoria e koreografisë – është shkolla më e mirë për me vazhdu punën. Dhe unë kësisoj po vazhdoj edhe sot” tregon Kryeziu.

Tregimi i Dilaver Kryeziut më mirë mund të shihet e dëgjohet me vallet e tij, sesa me shkrime. Profesori është i mirë me fjalët, por për shumëzim disa herë është më i mirë me muzikën dhe lëvizjet që arrin ti nxjerrë nga mendja e tij dhe t'i vendosë në këmbët e të tjerëve.







KOSOVA

NË 14 TREGIME  
KULTURORE



*Duke qenë një prej kompozitoreve të para në Kosovë, duhet falënderuar mendjen e Pranvera Badivukut për disa melodi që sot muzika shqiptare i mban me krenari në sirtarin e saj të pasur. Pranvera Badivuku, nëna e Sihanës dhe Zanës dhe bashkëshortja e violinistit Hysen Badivuku, 'ngacmohet' shpesh prej historisë, meqë ajo nuk bën të përjashtohet prej historikut të muzikës shqiptare. Rrëfimi i saj është i mishëruar e i dhimbshëm.*

**Pranvera  
Badivuku**





## **GRUAJA E OKARINAVE PRANVERA BADIVUKU, NËNA SHEMBULLORE DHE ZONJA E MUZIKËS SË PËRJETSHME**

**I ka kaluar 74 dimra e vera, gjithmonë kreative dhe një shoqe besnike e notave muzikore.**

**Si shkrimtari i guximshëm apo ndërtimtari i sfiduar prej lartësive, Pranvera Badivuku, prej Shkupit drejt Pejës e më pas Prishtinës, ka dekada që prej mendjes nxjerrë notat e partiturave.**

Duke qenë një prej kompozitoreve të para në Kosovë, duhet falënderuar mendjen e Badivukut për disa melodi që sot muzika shqiptare i mban me krenari në sirtarin e saj të pasur. Pranvera Badivuku, nëna e Sihanës dhe Zanës dhe bashkëshortja e violinistit Hysen Badivuku 'ngacmohet' shpesh prej historisë, meqë ajo nuk bën të përjashtohet prej historikut të muzikës shqiptare.

E takojmë Pranverën kësisoj, edhe tregimin e saj që edhepse i gjatë, dëgjohet me ëndje. Është ajo 'fajtorja' që sot ne e kemi këngën "E kujtoj atë takim" në repertorin e muzikës shqipe, njëjtë sikur edhe këngën "Eja eja e bardha verë". Pedagoge, mësuese, prej institucioneve si "Elena Gjika" dhe "Emin Duraku" në Prishtinë e deri te Saraji i Shkupit, Pranvera Badivuku është një tregim pranvere, mbushur me pak stuhi dimri por me shumë aroma verore, me rreth 150 kompozime por edhe të tjera që presin të realizohen.

Një këngë e shkruar për Nexhmije Pagarushën ka marrë fillimin e saj, së shpejti gati që ne ta shijojmë, me notat e Pranverës. Edhe ky është një tregim mes mini-tregimeve që na i shpalosë Badivuku.

Nuk e lëmë për më vonë faktin se Pranvera Badivuku, me kompozimet e saj i ka fituar pesë Okarina të Arta – çmimin kryesor të publikut në festivalin Akordet e Kosovës, i cili sot nuk ekziston dhe për gjeneratat e vjetra ka rrezik të kthehet në temë të panjohur e fushë të padiskutuar.

Pranvera këtë sukses e arriti më shumë pak teknologji, e jo me teknologjinë e një kompozitori të këtij shekulli e këtij moderniteti.

E lindur në Pejë, Pranvera dhe familja e saj asokohe konsideroheshin si familje armiqësore. Ajo rritet me axhallarët e saj, me këtë pjesë të familjes, meqë babain do ta takonte shumë më vonë, tek në fejesë. Muzikalitetit të saj i mungonte babai. Ajo u rrit pa baba por u inspirua që të nisë angazhimin e saj me muzikë qysh e vogël.

“Unë jam rritë pa baba. Për faktin se babai im ishte në burg në Shqipëri, familjen tonë e konsideronin si familje armiqësore. Axha im përfundoi Inxhinierinë e Urave në Zagreb, pra ishte me shkollë por prapë nuk gjente vend pune. E zëvendësoi një mesues në Pejë për një vit por prapë nuk gjeti punë. Në Shkup e gjeti punën. Atë vit unë e përfundova shkollën fillore dhe dëshira ime ishte që të regjistrohesha në shkollën e muzikës. Kësisoj shkova me axhën në Shkup, dhe e dhashë provimin pranues.

Bile më kujtohet që në fillim kam qëndruar te familja e Liliana Qavollit, aty kam fjetur, e më pas të nesërmen kur doli lista e studentëve të pranuar, e nisa jetën në vend tjetër” tregon Pranvera.

Nuk i shkoi asnjëherë mendja që nuk do të pranohej në shkollën e muzikës. Mendim i rrezikshëm për një vajzë e cila ishte në një rrugë të pacaktuar, me fatin mbret të rastësisë.

“Isha e bindur që do të pranohesha në shkollë atje. Shkolla ishte në maqedonisht, ishte paralele përgatimore, pra ishte një vit për tu përgatitur dhe më pas klasa e parë e shkollës së mesme të muzikës. Kisha pak njohuri për muzikën sepse në klasën e tetë nuk kishim fare muzikë. Muzika gjithherë është parë si diçka e tepërt. Gjuhën e mësova më pas, axha më ndihmonte edhe me leximin e takteve – pjesëve ritmike, dhe kësisoj shpejt u bëra një prej studenteve më të dalluara” tregon tutje Pranvera.



Fotografi e vjetër familjare

## **Por skenari i jetës merr tjetër kahje.**

Në vitin 1963, një tërmet i fuqishëm me magnitudë 6.1 godet Shkupin. Personalitete të ndryshme, mes tyre edhe Hrushçovi prej Rusisë, vinin në Shkup ta vizitonin qytetin dhe të shihnin tmerrret pas tërmetit. Kjo ishte kohë e përshtatshme për të arrestuar njerëz të profileve të ndryshme, herë-herë fshehtazi. Mes tyre, arrestuan edhe axhën e Pranverës.

“E morrën dhe e izoluan, edhe pse më vonë e morra vesh se ishte burgim. Unë vazhdova, kërkova punë dhe e gjeta atë, në Saraj të Shkupit. Në shkollën 'Liria' nuk gjeta punë sepse shkaku i tërmetit nuk lejohej as hyrje e as dalje e as ndërrim i stafit aktual, prandaj shkova në Saraj ku kam kaluar vitet e para të punësimit tim, dhe kam kujtime e mbresa të thella prej asaj kohe. Stafi atje ka qenë shumë mikpritës, fëmijët vinin prej fshatrave rreth Sarajit dhe ka qenë një periudhë e mirë e jetës sime” thotë Pranvera e muzikës shqiptare.

**Kur punonte në radio,  
ajo u angazhua edhe me muzikën  
për fëmijë edhe me muzikën  
popullore. Gjithmonë e ka dashur  
sidomos muzikën për fëmijë  
dhe ardhjen e kësaj muzike në jetë,  
njëjtë si një fëmijë i posalindur.**

“Atëherë e kemi pasë në planprogram sa kangë me i realizu çdo muaj. Nisën festivalet në Gjakovë, ku i dërgova disa melodi për fëmijë. Po në këtë kohë edhe u dhash pas qëndisjes, kisha merak, i kisha disa revista italiane me modele të bukura, i blejsha çdo muaj dhe punova punëdore për vajzat, mbulesa kryesisht” tregon Badivuku.

**Prej vitit 1979, ajo angazhohet goxha  
shumë në muzikë. Me ftesën e Severin  
Kajtazit – redaktor i produksionit  
muzikor, ajo kalon në Radio. Radioja ka  
qenë pjesë e programeve dhe redaksive  
foljore, por aty ka qenë edhe  
produksioni – sot ku është Televizioni  
KTV- Kohavision. Në kuadër të këtij  
produksioni kanë ekzistuar orkestra  
popullore, orkestra popullore turke dhe  
orkestrat simfonike krahas edhe korit  
profesional dhe korit të fëmijëve.**

“Në redaksinë e muzikës për fëmijë kam qenë edhe unë, dhe është dashur që t'i plotësojmë nevojat e televizionit dhe radios, kur kishin programe për fëmijë. I bënim 10 këngë çdo muaj. Është zgjedhë kanga, ka konkuru autori që e ka shkruajt kangën, është kontrolluar teksti, ka qenë edhe një poet që i ka korrigjuar tekstet asokohe, ndërsa kur vendosej melodia shkonte për orkestrim. Këtu, vinte partitura e shkrueme për instrumente, që secila orkestër ta kishte partin e vet, bëheshin ushtrime dhe inicizime, dhe pas matricës vinte këngëtari, zëri, bashkimi i bukur në fund. Unë ushtroja me këngëtarët në ndërkohë, ndërsa e pata formuar edhe një kor të fëmijëve me të cilët këndonim nëpër festivale”, tregon Pranvera.

**Këngët për fëmijë gjithmonë i kanë pëlqyer.**

Të parat këngë për fëmijë i ka krijuar në shkollë të mesme, njërën edhe me tekst nga Anton Çetta. Më pas ndër vite, bashkëpunoi me Vehbi Kikajn, Agim Devën, Rifat Kukajn, Dibran Demakun dhe emra të tjerë që krijuan edhe për fëmijë.

“Shpresoj që edhe sot ka shkrimtarë për fëmijë, sepse nuk po i përcjelli shumë” thotë ajo.



---

Taksisti, një natë para se ta shkruaj këtë tekst, dëgjon në veturën e tij një këngë me këto vargje, 'Plasa tuj të lutë, qaj moj vashë qaj e mos pusho..(.). pa të marrë se la'. Diskutojmë kush e këndon, Haki Misini apo Gazmend Pallaska apo...dikush tjetër. "Kjo është muzika ma e mirë, muzika e lehtë qytetare. Haki Misinin unë e kam pëlqy shumë, por dihet qysh e pati fundin. Akordet e Kosovës asokohe i kemi pasë t'mira shumë" thotë taksisti, edhe unë rastësisht i them – "E njeh Pranvera Badivukun?"

"E njoh, ose ka këndu ose ka bo kangë, s'jom i sigurtë. Po si emër e di mirë bile...(.).Luan Hajra masanej m'kujtohet, edhe Esat Bicurri, ky ka vdekë. Të gjithë vdesim një ditë!" e vazhdon taksisti dhe unë buzëqesh.

### **Pranvera e mban mend pasionin për muzikën prej kur nisi ta kuptonte veten dhe realitetin rreth saj.**

Megjithatë, do të ishte viti 1973 që do t'ia sillte Pranverës suksesin e parë si kompozitore, si nënën e notave që iu mishëruan zërit të Esat Bicurrit. Bicurri, artist i madh shqiptar, këndoi në Akordet e Kosovës këngën "Eja eja e bardha verë" – me notat e thurura prej Badivukut.

"Ishte një këngë e bukur e melosit popullor dhe një bashkëpunim i mrekullueshëm me Esat Bicurrin. U përsërit sukcesi, prapë me Esatin por tash me këngën e njohur "E kujtoj atë takim" tregon Pranvera.

"Sot këtë këngë e këndojnë Aurela Gaçe, Yllka Kuqi, Adelina Thaqi, dikur e kënduan edhe Tonin Tërshana e Eduard Jubani. Është këngë të cilën e kanë kënduar të gjithë" tregon me krenari Pranvera.

Pak para këtyre sukseseve, ajo martohet me violinistin Hysen Badivuku dhe më pas lindin dy vajzat, Sihana dhe Zana.

"Bashkëshorti im ka qenë violinist në Orkestrën Popullore dhe Simfonike të Radio Televizionit Shqiptar. Njohja me të ka ndodhur në Shkup, atje ku edhe organizoheshin koncerte të ndryshme në shkollë, atje jemi njohur. Më pas ai erdhi në Kosovë, si bursist i Radio Prishtinës dhe nisi punën në orkestër. Unë krijimet e mia të para prej Shkupit i dërgoja në RTP dhe për këngën time të parë të pranuar më lajmëroi Hyseni. Kështu vazhdoi lidhja jonë, unë nga Peja e ai nga Vushtrria, që më pas do të kurorëzohej në martesë dhe në lindjen e vajzave" vazhdon Pranvera. Në Akordet e Kosovës të vitit 1983 ajo merr dy shpërblime – njërin për këngën "20 vjet të

festivalit” dhe tjetrin çmim për këngën “Je kujtimi më i vetëm” kënduar nga Sebahate Bërlajolli. Në vitin 1984 ajo merr Okarinën e Pestë, me këngë për fëmijë.

**Do të vinin vitet e 90-ta, kur edhe Pranverës do t'i pamundësohej të punonte në kushtet më të mira dhe ta shprehte talentin e saj në formën më të kompletuar.**

“Kur erdhën vitet e 90-ta, unë kam qenë 45 vjeçare, pra kam qenë në moshën kur njeriu është i pjekur dhe mundet me japë ma shumë, në vullin e krijimtarisë dhe punës. Këto vite për të gjithë ishin të vështira, njerëzit mbetën pa punë. Burri im u angazhua gjithandej si muzicent, për mbijetesë. Në Hotel Grand, në katin e 13-të asokohe mbaheshin koncerte me muzikë të lehtë dhe evergreen, ku ai muzikonte me kolegët e tij. Më vonë nisi të udhëtonte për në Tetovë e Shkup. Unë isha në njëfarë mbyllje, sepse nuk kishim vullnet me kriju dhe prisnim të ndërrohej situata, e cila zgjati shumë”.

“Ne provuam që në vitin 1995 ta rikthenim festivalin Akordet e Kosovës, duke i ripërtërirë mbrëmjet e festivalit në disa qytete të Kosovës. U mlodhën redaktorët dhe planifikuam gjithçka, u nisëm për në Mitrovicë ku dështuam sepse shkuam në

një sallë ku luante një ekip i serbëve aty, basket në sallë, dhe bënin zhurmë me qëllim që ne të largoheshim. Dhe u larguam, por ditën tjetër na u mundësua mbajtja e natës për fëmijë. Në Prizren poashtu e mbajtëm një koncert, por në Prishtinë nuk na lejuan asnjëherë ta mbanim. Më kujtohet që provat asokohe i majshim në banesën time, me fëmijët, ndërsa incizimet në shtëpinë e redaktorit të programit muzikor asokohe, Musa Tolaj, të cilin edhe e vranë gjatë luftës. Ishte një orvatje të cilën nuk e përfunduam me sukses” tregon Pranvera.





Pranvera Badivuku nuk njuh pleqëri. Sytë e rrudhat po, por jo edhe inspirimi për të krijuar muzikë. Sipas saj, bota ka ende nevojë për muzikë të re, dhe notat nuk janë harxhuar.

Kohëve të fundit, ajo ka bashkëpunuar me të ndjerin Hivzi Krasniqi. Është e lënduar që ai vdiq vetëm javë më parë. Flisnin bashkë për një këngë për grupin Sofra Pejane, 'që nuk paska qenë kismet'.

“E kam dashur një këngë për Sofrën Pejane dhe thashë me vete – vetëm Hivziu atë tekst mundet me e bo. E gjeta numrin e tij dhe po flisnim në Viber, i tregova titullin – se zakonisht ia caktoja titullin dhe ai krijonte, dhe nuk shkoi gjysmë ore e ai nisi ta shkruante tekstin në Viber, për Sofrën Pejane. I shpejtë si gjithmonë. E pyeta pas pak ditësh nëse Ramadan Krasniqi ishte pjesë e këtij grupi, dhe ai ma ktheu – Kur të duash shkojmë në Pejë dhe e mbledhim krejt grupin. Por nuk paska qenë kismet” thotë Pranvera.

**Peja shtron sofrën plot bereqet  
Sofrën pejane si e ka adet  
çka të don shpirti në sofër e ke  
Ejani në Pejë, këndon me ne**

*(Tekst i shkruar nga Hivzi Krasniqi, i botuar këtu me leje nga Pranvera Badivuku)*

Derisa presim ta dëgjojmë këtë poezi të shndërruar në melodi kënge, Pranvera ka një tjetër peng njomak. Dedikuar Nexhmije Pagarushës, Bilbilit të Këngës Shqipe, ajo i ka kompozuar një këngë tekstit të Ramazan Çekës, me zërin e Selami Kolonjës.

## LAURESHA KOSOVARE

**Buzqesh mali, lulzon fusha  
Mrizojnë delet n'hije t'bjeshkës  
Me za t'bukur Pagarusha  
Ja merr kangës së bareshës**

**Ti për kangën je mbretresh'  
Je simbol i kang's shqiptare  
Zani jot si laresh'  
Mrekullia kosovare**

*(Marrë nga Ramazan Çeka – Facebook)*

“Nexhmija e ka ditëlindjen në fillim të majit, nëse nuk gaboj, dhe i kërkova Selami Kolonjës që të orkestrohet e realizohet kënga deri atëherë, që t'ia bëjmë një dhuratë Nexhmijës, pasi kënga është shkruar enkas për të. Unë jam takuar me tekstshkruerin kur erdhi në Prishtinë, dhe ky tekst menjëherë ma dha idenë që të shkruaj dicka, të kompozoi diçka” më tregon Pranvera derisa e këndon pak melodinë e menduar si qëndisjen finale krahas tekstit.

Njëjtë, një këngë për Pejën që do ta këndonte Sebahate Bërlajolli, por edhe asaj nuk i erdhi radha, kismet.

Mes këngëve tjera që Pranvera Badivuku i ka kompozuar nëpër vite janë edhe 'Kur ta fal' një tufë gërshete' interpretuar nga Nexhmije Pagarusha e Ismet Bogujevci në Akordet e vitit 1981, 'Vel ylberi i dashurisë' interpretuar nga Emine Hasimi në Akordet e vitit 1986, 'Për ty vuaj për ty këndoj' nga Nexhmije Pagarusha, 'Kujtimi rinor' nga Hermina Lekaj, dhe plot këngë tjera.

“Tash jam në pension, jam më e lirë në pikëpamje të angazhimeve. Megjithatë ende krijoj, madje u fali këngë njerëzve, po ua dhuroj e ata duhet të shpenzojnë për t'i orkestruar ato. Pas tërë këtyre viteve në punë pedagogjike, si redaktore e producente e muzikës për fëmijë në RTP, po pushoj” tregon Pranvera, grua që në çdo fjalë rezonon dashuri për muzikën dhe çdo ditë prej fytyrës së saj tregon për një grua me jetë të lumtur dhe përmbushje afër muzikës.





*Fotografi nga albumi familjar i Pranvera Badivukut*






*“Gjithçka në jetën time është rreth muzikës. Muzika ka frymëzim, ka zanat, ka prekje të Zotit, ka ndjeshmëri, talent, por edhe profesionalizëm. Nuk duhet pritur momenti i prekjes së Zotit, se ashtu mbesim me 2 këngë në vjet. Duhet kërkuar shumë prej vetes – vetëm me punë dhe punë” më thotë Armendi, derisa pijmë kafe dhe ai reflekton në retrospektivë karrierën e tij, që e lakmojnë shumë.*

**Armend Rexhepagiqi**

...



## 05 ARMEND REXHEPAGIQI: MUZIKA KA FRYMËZIM, KA ZANAT, KA PREKJE TË ZOTIT, KA NDJESHMËRI

Armend Rexhepagiqi edhe sot çuditet me efektin që kanë pasur këngët e tij tek njerëzit. Pa marrë parasysh nëse është këngë të cilën e këndon ai, apo këngë ku ai është në rolin e kompozitorit, Armendi nuk preferon t'i dëgjojë këto këngë pas lansimit të tyre. Nëse është në restorant, ose largohet ose mbulon veshtë që mos t'i dëgjojë krijimet e tij, sepse merret shumë me to, thotë se qindra herë i dëgjon ato prej krijimit e deri sa publikohen. Pastaj nuk i duron më, i shijon jashtëzakonisht pak dhe vetëm në raste të veçanta. I duhet të kalojë kohë e gjatë, vite e vite që përsëri të jetë në gjendje ti dëgjojë qetë.

Armend Rexhepagiqi, zëri i fuqishëm i të cilit ka sjellë në jetë tekste të mrekullueshme dhe melodi profesionale muzikore, është sot një djalë i thjeshtë të cilit i kujtohet se si dikur një videoklip nuk u realizua shkaku i sulmeve terroriste të 11 shtatorit në Amerikë, apo se si një këngë e fuqishme nga ai nuk morri asnjë pikë nga juria në një festival në Shqipëri.

Nuk dëshiron vetëkënaqësi dhe kërkon perfeksion, e këto bëhen arsye që puna e tij të zgjasë më shumë se rëndomtë. Nuk dëshiron as të bëhet prepotent e mendjemadh, është gjithmonë i hapur për gjërat e reja. Së shpejti do të rikthehet por nuk zbulon shumë prej kësaj tabloje. Nëpër vite zëri i tij ka munguar por jo edhe krijimet e tij. Shumë herë ka thënë jo, prandaj edhe thotë se një pjesë e mirë e

pozicionit që sot ai e gëzon i atribuohet faktit se ka ditur të refuzojë, për ta mbrojtur veten dhe estetikën të cilën e ka ndërtuar me vite e vite.

### **Armend Rexhepagiqi është një botë e cila duhet hulumtuar pak e nga pak, hap pas hapi.**

■ ■ ■

“Babai, profesor i pedagogjisë dhe filozofisë, të cilin e humbëm para dhjetë vjetësh, ka qenë edhe poet. Ka shkruar disa permbledhje me poezi. Aida ime, para dhjetë vitesh e ka shkruar një tekst për këngëtare Tuna, me titull 'Testamenti', ndërsa babai im 2-3 vite më vonë e kishte botuar permbledhjen e fundit me poezi me po këtë titull. Është interesant ky zingjiri artistik. Mama, arsimtare e matematikës në pension. Këta dy prindër, më të mirët në botë për mua kuptohet, ishin intelektualë që nuk kanë insistuar tek fëmijët e tyre të merren me profesione elitare të kohës së tyre” tregon Armendi.

Armendi ka studiuar në Fakultetin e Mjekësisë, dhe përderisa asokohe një pjesë e mirë e prindërve shqiptarë dëshironin që fëmija i tyre të anazhohej me këtë fushë, babai i Armendit, Jashar Rexhepagiqi, e njihte të birin dhe e përqafoi talentin e madh të Armendit.

“Babi im më thoshte – ti je për muzikë, regjistroje Akademinë. Kjo është pak paradoksale për atë kohë, por kam përshtypjen se e ka njohur djalin e vet. Ashtu edhe doli, muzika u bë dashuria më e madhe. Më kujtohet që mamës i thosha para se të filloja klasën e parë të shkolles fillore që nuk du me hy në orën e muzikës, nuk më pëlqente, isha i turpshëm. Pianon e parë ma kanë blerë prindërit, nuk ishte shpenzim i vogël, vitin e parë të shkollës së muzikës u regjistrova në violinë por isha dështim i plotë, nuk e duroja tingullin e violinës në duart e mia të paditura. Në piano e solfexho isha i mirë, por klasika nuk më ka tërhequr shumë. Si nxënës shumë i mirë në shkollë, prej prindërve e kam pasur përkrahjen të bëj çkado që dëshiroj në kohën time të lirë” vazhdon Armendi.





**E pamundur të mos e ngacmosh intelektin e Armendit e të mos përmendësh hitet e tij më të mëdha ndër vite. Ata që dëgjojnë këngët “Harrova”, ose “Shkel” apo edhe “Dashurinë ku e kam” dhe “Edhe një herë” nuk e programojnë shpesh në mendjen e tyre faktin se secila këngë është krijuar para më shumë se dhjetë vitesh, disa edhe para njëzetë e pesë vitesh.**

“Për këngën 'Harrova' gjithmonë jam çuditur se si ka arritur ta gjejë rrugën e vet, sepse nuk ka videoklip, as nuk është kënduar në ndonjë festival apo manifestim që tërheqë vëmendje, ndoshta ekziston në ndonjë videokasetë nga koha e errët e mungesës së mediave tona dhe lirisë në përgjithësi. Kudo që dal e shetis, nuk ka vend që dikush nuk ma këndon refrenin. Flas për “Harrova” të para 25 vitesh, kur e këndova vetëm e jo për versionin e ri me Tunën time brilante. Për këngën “Nuk banon këtu dashuria” shembull, më kujtohet që donim t'i bënim një videoklip por ditën e planifikuar për xhirim ndodhën sulmet e 11 shtatorit në Amerikë dhe kuptohet xhirimi u anulua, dhe nuk u bë asnjëherë më” shpalosë Armendi. “E kam njëfarë fati apo fatkeqësie që këngët e mia po mbesin të gjalla për

shumë e shumë vjet. Më pëlqen faktikisht kjo, që njerëzit i zbulojnë këngët e mia pas shumë vitesh dhe ato disi rikthehen vet”.

Tekst idiotik Armendi e quan tekstin e këngës së tij të parë. Thotë se është i dobët në shkruarjen e teksteve dhe qeshet kur njerëzit mendojnë se këngët të cilat ai i këndon, janë të shkruara nga ai. “Të gjitha tekstet e këngëve të mia janë të Aidës. Unë jam për muzikë, jo për vargje. Unë shkruaj në mënyrë përshkruese, infantilo-imbecile, në kuptimin 'Ftohtë është, po bjen shi, po fryn era...'. Skandaloze. Fati i madh që e kam Aidën dhe mjeshtërinë e saj pranë meje. Në muzikë vetëm tek ne zhvlerësohet teksti...në disa raste është më shumë se 50 përqindëshi i këngës. Teksti është edhe përshkrues i mirë i muzikës, përcjellës i ndjenjës, rumbullakësim i personalitetit të këngëtarit dhe strukturës së kompozimit” tregon Armend Rexhepagiqi në këtë bashkëbisedim dhembshurisht të sinqertë.

“Gjithçka në jetën time është rreth muzikës. Muzika ka frymëzim, ka zanat, ka prekje të Zotit, ka ndjeshmëri, talent, por edhe profesionalizëm. Nuk duhet prituri momenti i prekjes së Zotit, se ashtu mbesim me 2 këngë në vjet. Duhet kërkuar shumë prej vetes – vetëm me

punë dhe punë” më thotë Armendi, derisa pijmë kafe dhe ai reflekton në retrospektivë karrierën e tij, që e lakmojnë shumë.



“I kam të gjitha këngët e mia, për një kohë të gjatë kam qenë i kujdesshëm për dallim nga krejt kjo shoqëri e jona, e cila nuk është e tillë. Ne flasim për trashëgimi dhe mendojmë që ajo është vetëm folklori, tradita dhe zakonet. Trashëgimi është edhe ajo e artit modern, e pop kulturës, për të cilën nuk kemi fare kujdes. I kam edhe versionet origjinale në CD me këngët e mia. I kam video xhirimet e ruajtuna, me përjashtim të disa emisioneve që me Aidën i kemi realizuar në KTV apo edhe në RTK. Më kujtohet që me ciklin “Air Condition” në RTK – emision që transmetohej të dielave, kam realizuar 52 këngë të reja për fëmijë të cilat asnjëherë më nuk janë transmetu. Sa gjynah për tërë këta fëmijë të sodit. Ndoshta një ditë e bëj kanalin tim në Youtube dhe i marr të drejtat për të gjitha postimet” tregon Armendi.



Është e dhimbshme që ata të cilët duan t'i dëgjojnë këngët e Armendit, nuk e kanë një adresë të caktuar dhe të vetme.

“Nuk kam iluzion që numri i njerëzve që dëgjojnë këngët e mia është i madh. Me këngët e mia, këngët për të tjerët, këngët për fëmijë, do të ishte një arkivë e bukur edhe për prindërit të cilët duan t'ua prezantojnë fëmijëve të tyre këtë lloj të muzikës” tregon Armendi.

Nëse ka diçka që Armendi e bën me vështirësi është të bisedojë për të kaluarën. Këtë e bën vetëm pasi unë insisto.

Familja Rexhepagiqi por edhe Armendi vetë nuk janë kursyer nga jeta me sfida të ndryshme dhe me kapituj të cilët nuk i kanë shijuar Armendit dhe shpirtit të tij artistik.

“Gjithmonë është e vështirë kur pëson goditje dhe humbje, sëmundje, vdekje të afërmve. Të ngritesh dhe të vazhdosh me ecë përpara kur ke sfida të rënda jetësore është e domosdoshme por jo e lehtë. Thyerjet emotive na lëndojnë krejtve, por secili e gjen një rrugë, dhe këtu po flas edhe për lëndime e zhgënjime profesionale, apo bllokada krijuese. Jeta në Kosovë në përgjithësi të detyron të bësh kompromise. Mua dhe Aidën na ka shpëtuar fakti që kemi qenë të shkathtë në

lëmi të ndryshme dhe kjo ka krijuar një stabilitet ekonomik që mos të bëjmë kompromise, gjithmonë duke u përpjekur të mos përfundojmë si karikatura të vetvetes. Artist është ai që krijon art dhe kreativitetin e ka të parin, jo argëtimin ndaj publikut. E dua kombinimin mes komerciales dhe artistikes, por nuk dëshiroj vetëm argëtim” tregon Armend Rexhepagiqi, një prej këngëtarëve më të mirë shqiptarë, në mos zëri më i mirë mashkullor që shqiptarët e kanë njohur e dëgjuar në më shumë se tri dekada.

“Vetëkënaqësia dhe momenti kur nuk kërkon shumë prej vetes janë autogol. Kur i shoh të njëjtit njerëz që pretendojnë se krijojnë, tërë ditën nëpër lokale, pyetem se kur kanë kohë ata të krijojnë? Pos talentit dhe inteligjencës, puna është super e rëndësishme. Aq shumë këngë i bëj dhe i hedh në 'recycle bin' për mos t'i publikuar kurrë, në procesin e krijimit të një kënge të mirë, deri sa nuk arrij tek rezultati që më kënaqë. Ka edhe raste kur koha e krijimit të një kënge është e barabartë me kohëzgjatjen e saj – Këngën “U shërova” që e këndon Hana Cakuli e kam kompozuar për tre minuta e gjysmë, ndërsa këngën “Fustani i bardhë” që e këndon Jehona Sopi për rreth 1 muaj, çdo ditë, duke e kërkuar e përpunuar me qindra orë punë. Nuk e them dot cila është

më e mirë si këngë! Rregull nuk ka por pa punë, pa u ulë me kërkim prej vetes më shumë, pa mbetë me dy këmbë në tokë, pa i thënë vetes që mundet edhe më mirë, vetëkënaqësia e shkatërron përparimin e një krijuesi” tregon Armendi.

“Kujt do t’ia shpreh pikëllimin tim”, “Rruga e fundit”, “Kur dashuria vdes”, “Betohem me këngë”, “Çka do të ndodhë me ne”, “Dude dudie”, “Kalle kalle”, “A edhe ti je pjesë e qytetit tim”, “Qëndresa”, “Dikur”, “Ajo”, “Kam kojshiken”, “Si vërshimë e vetëtimë”, “Nashtë”, “I vetmuar sonte”, “Qaforja”, “Dugi”....Lista vazhdon, e këngëve të cilat Armendi i ka sjellë në jetë nëpër vite. Sa fëmija sot është rritur me këto melodi. Plot e kujtojnë videoklipin e “Dashurinë ku e kam” afër sallës 1 tetori në kryeqytet. Të tjerët e kujtojnë Armendin dhe Violetën, grupin ‘Vivien’ me hitet e tyre si “Romantika” apo “Anijet e fundosura”. Plot këngë janë realizuar edhe në bashkëpunim me Aida Barakun, bashkëudhëtaren e jetës së Armendit.

Gjatë tërë takimit tonë, kur Armendi flet për të, thotë “Aida ime”, mëngjesin më të bukur dhe fladin më të hyjnisëm të ditëve të Armendit.

■ ■ ■



“Me Aidën grindjet më të mëdha janë rreth këngëve, gjithmonë kemi qenë shumë kritik ndaj njëri tjetrit, shume kërkues. Është përparësi por edhe minus kur me partneren e jetës je edhe bashkëpunëtor i parë. Çdo problem i punës bartet edhe në jetë private. Unë jam peshore në horoskop, një” artist në qiell”, ndërsa ajo është binjak – me dy këmbë në tokë. E kam të domosdoshëm atë shikimin e ftohtë dhe racional të saj ndaj këngëve. Aida është më inteligjente, më efikase, më profesioniste se unë. Ajo më pret gjithmonë mua ta krijoj këngën, dhe me qindra herë këngën e krijojmë bashkë. Unë gati se kurrë nuk duhet ta pres atë për tekste, gjithmonë kreative duke mos e përsëritur veten asnjëherë” rrëfen Armendi.

Në Kosovë më pas do të ndodhte lufta, dhe në një formë a tjetrën do ta godiste edhe Armendin.

“Unë nuk kam qenë i edukuar si disa familje shqiptare, me atë kulturën e dashurisë ekskluzive vetëm për popullin tim shqiptar. Kam qenë i edukuar me idenë që të gjithë njerëzit janë të barabartë, pra në një atmosfere globale. Me atë çka ndodhi u ndjeva tepër i zhgënjyer- dhe më vonë u bëra më patriot se patriotat që prej fillimit janë edukuar veç me Mic Sokolin dhe me Festivalin e RTSH-

së. Lufta që ndodhi ma ka rritur nacionalizmin e domosdoshëm shqiptar, atë të mençurin dhe konstruktivin, nacionalizmin e matur” më tregon Armendi derisa bisedojmë si dy shokë që njihen prej vitesh, e të cilët po takohen mrekullisht për herë të parë në një dyluftim të syve dhe rrugëtimeve.

Përndryshe, çka bën tjetër Armendi, në kohën e lirë, kur nuk i kushtohet muzikës?

“Mbrëmjeve, Netflix. Ajo çka të gjithë i çuditë është fakti se më pëlqejnë librat e vetë-ndihmës, ata që janë të punuar mirë dhe jo kjo beletristika idiote, të gjithë më thonë ç’të duhen ato ty, ti je mirë. Ja që më intrigojnë. Paulo Coelho shembull, ia kam lexuar gati tërë veprimtarinë. Lexoj shumë intervista me regjisorë të ndryshëm, sepse mendoj se kompozitori është një lloj regjisor i cili e mban balancin mes tërë ekipit. Shoku im dhe kolegu Yll Limani, multi i talentuar, kantautor që do të shpërthejë, mua dhe Aidës na lexon ndonjëherë poezi të bukura botërore por edhe poezi që i ka shkruar vet. Diskuton me Aidën rreth vargjeve, unë në heshtje i dëgjoj dhe turpërohem sa mbrapa kam mbetur me poezi. Filmin shqip nuk e njoh, kjo njëjtë është minusi im. Humorin shqip nuk dua ta njoh, nuk më pëlqen, nuk e ndjej, nuk qesh, jam komplet ndryshe nga

ai mentalitet. Jam rritur me humorin anglez i cili dallon shumë nga ky i yni” tregon Armendi.

\*\*\*

Armendi shenjën e tij e ka lënë edhe nëpër festivale, nëpër vite.

**Kënga “Ti nuk më meriton” e cila i solli Shqipërisë së viteve 90-të një teatër në skenën e Pallatit të Kongreseve, e kënduar nga Aida dhe Armendi, nuk morri asnjë pikë asokohe nga juritë e Festivalit të njohur të TVSH-së.**

“Ka qenë e vetmja këngë e edicionit e ndërprerë me dy duartrokitje të publikut gjatë interpretimit të parë. Nuk po përmend emra, më kujtohet se si anëtari i jurisë nga Tirana erdhi dhe na e shprehi adhurimin për këngën, por pas gjysmë ore në votim nuk na dha asnjë pikë. Ishte një lëndim i pa shpjeguar, aty pashë hipokrizinë live. Kaluan vitet. Kënga edhe sot e kësaj dite dëgjohet dhe sa herë jam në Tiranë ma këndojnë kudo. Në TVSH morra pjesë edhe me “Betohem me këngë” por pata probleme me zërin gjatë festivalit, nuk dola shumë mirë, e rikompozova këngën në skenë sepse më mungonin pesë nota më të larta, kuptohet ishte prezantim i zbehtë. Edhe mos ta harroj “Kalle Kalle”, paraqitjen tjetër në

këtë festival- viti 1992-Shqipëria e lënduar dhe e plagosur, unë si jashtëtokësor i shokuar” qeshet Armendi.

**Në dy raste të tjera, Armendi erdhi si kompozitor i këngëve. Teuta Kurti, Rrona Nishliu dhe Vesa Luma kënduan këngën “Flakareshë” në vitin 2005 dhe u shpërblyen, ndërsa Rovena Dilo këndoi “Rrëfimi”, këngë këto që mbajnë vulën e Armendit dhe Aidës brenda festivalit në fjalë. Me këtë të dytën poashtu pati zhgënjime, meqë ishte ndër favoritet por pos që nuk morri trajtimin e duhur, nuk u fut as në finale.**

“Festivali i TVSH-së është biletë e mirë për Eurovizion. Përndryshe, disa herë kam refuzuar të paraqitem në skenën e festivalit si mysafir kur më kanë ftuar. Jam shumë kurioz cila është formula e këtij viti për Eurosong? Po matem shumë, të konkurrojmë apo jo këtë vit?” vazhdon Armendi.

Dikur, me “Mami mami” Armendi provoi fatin e tij për Eurosong, kur shqiptarët e dinin pak se çfarë ishte Festivali Evropian i Eurosongut dhe kjo vite para se Shqipëria të debutonte.

“Në prova patëm dalë të dytët, në finale të gjashtit. Festivali u mbajt në Zarë, me një organizem të përkryer të zgjedhjes së këngës së Jugosllavisë për Eurosong.



Kam qenë shumë i mirë në këndimin live, ka qenë kujtim i mirë dhe plasman i mire. Ajo çka mbeti si vlerë për mua dhe Aidën ishte organizimi fenomenal i festivalit, atë shkollë të organizimit e kemi aplikuar pastaj me vite nëpër të gjitha produksionet tona televizive” tregon Armend Rexhepagiqi.

**Këngët e tij të fundit të realizuara për vete janë “Qaforja” dhe “Kur dashuria vdes”, e pak para tyre edhe hiti absolut “Shkel”. Me këngën “Kur dashuria vdes” Armendi triumfoi në festivalin ‘Kënga Magjike’ në Shqipëri në vitin 2006, dhe prej asaj kohe Armendi nuk ka publikuar këngë personale.**

“Kur fitova në festival, dhurata ishte një udhëtim për në Turqi dhe një videoklip i këngës fituese i paguar prej produksionit. Klipin kurrë nuk e bëra e as në pushime nuk deshta të shkoj, edhe pse pata mundësi. Paraqitja skenike në atë edicion të festivalit ishte maksimumi i mundshëm për atë moment, ishte prezantim skenik me të cilin mu duk arrita kulmin tim. Nuk deshta video, tregimi i asaj kënge kishte përfunduar në atë skenë” thotë Armendi.

“Kur Rona Nishliu ta këndon këngën, nuk ke pse këndon vet. E ka botën, ndjenjën e

saj. Mos të flas për Tunën, këtë gardën e këngëtareve si Hana Cakuli, Teuta Kurti, Vesa Luma.. janë më të mira se unë si interprete”, thotë pa shaka Armendi, sado që unë nuk e besoj këtë arsyetim të pauzimit të tij dhe sikur çdo fans i Armendit, nuk e pranoj.

Në fund, e pyes se kur do ta kemi një koncert të madh të Armendit. Gjeneratat e ndryshme që e duan Armendin e meritojnë një përmbledhje të këngëve të Armendit, të kënduara prej gojës së tij.

“Kam pasë ftesë prej Komunës së Prishtinës. E kam ende. Jemi duke biseduar, ndoshta vitin tjetër. Nëse e bëj, e dua një koncert të madh dhe të veçantë, është borxh ndaj njerëzve që kanë një adhurim prekës ndaj këngëve të mia. Tërë jetën kam pasë një estetikë në muzikë, në tekste, në veshje, në videoklipe, në festivale e koncerte të mia solistike dhe mendoj që në koncert do të duhej me e përmbledhë tërë këtë krijimtari. Nëse e bëj koncertin, do të këndoje edhe këngët që bëra për të tjerët, me mysafirë e me këngë të re” tregon Armendi.

Armendi së shpejti do të kthehet me një këngë, e poashtu edhe me një duet.

“Kënga nuk do të jetë ajo që pritet nga unë, por duhet të pëlqehet, Publiku edhe do të befasohet, patjetër, sepse nuk po vij ashtu si presin të gjithë”.

Nëse Armend Rexhepagiqi i kthehet skenës shqiptare të muzikës, në çfarëdo forme, kjo nënkupton se ka shpresë për të mirëfilltën dhe të mishëruarën. Shqiptarëve do t’u kthehej në vesh një vokal i trajtuar dhe qëndisur mjeshtërisht.





**NË 14 TREGIME  
KULTURORE**



Publikuar me leje nga Doruntina Ukimeri

Për plot njerëz, martesë është po aq e rëndësishme sa çejzi i nuses. Dy familje, së paku, angazhohen që çejzi i nuses gjatë dasmës të jetë më i përsosuri, i pasur me çdo element që e kërkon tradita e zakoni. Martesa shqiptare do të ishte ndryshe po të shkatërrohej çejzi. Ceremonia e cila zgjatë disa ditë e kërkon një ekspozitë të tillë. Tregimi për çejzin vështirë se mund të rrumbullakësohet, por është i veçantë dhe kompleks.

## Çejzi

# 06

## ÇEJZI, EKSPOZITA E GRUAS SHQIPTARE PARA SE TA VAZHDOJË JETËN TE BURRI

**Ndër shqiptarë, kur një vajzë është martuar, ka ndërtuar edhe çejzin e saj. Një formë e ekspozitës të cilën duhej ta shihnin të gjithë, çejzi (paja e nuses) ka përmbajtur shumëçka prej rrobave e objekteve të ndryshme.**

Emërtimi “Çejz” në kulturën shqiptare ka hyrë dhe mbetur nga sundimi osman (turqisht: çeyiz) ndërkohë që paja apo prika e nuses është traditë që ka ekzistuar gjithmonë. Sepse gruaja tek shqiptarët është dashur të shkonte tek burri duke krijuar çejzin, me vath, me shamija të kokës, me gërshtë, me sapun e gjerdan, me kësulë e këmishë e xhamadane prej

kadifeje. Këto dhe shumë më shumë, kanë paraqitur dhe paraqesin edhe sot një formë transferimi të pasurisë prindërore, dhuratave apo parave, me qëllim martesën e një vajze.

Sipas traditës, çejzi është një grumbullim i pasurisë të cilën sipas këtij rituali gjithnjë e bart një grua kur lidhë kurorë me një burrë. Në anën tjetër, kjo praktikë është karakterizuar me një proces të ndërlikuar të punëdores si dhe është shfaqur përmes një estetike të veçantë e cila si e tillë ngërthen në vete vlera të trashëgimisë kulturore.

---

## “Unë jom shyhretlike, e du çejzin tem, fëmijës tem nesër ma e knaqt jom me ja bo krejt çejzin”

---

“Unë, kur jom martu para 9 vitesh, kom pasë 2 dhoma me çejz, njëra e imja dhe tjetra me gjanat që i kanë pru familja e burrit. Ka qenë një dhomë me tesha, me ari, me fustana, me dallame. U kon tamon çejz për me dalë prej shpisë, se qashtu osht dasht me dalë prej shpisë vajza, me çejz, qysh e ka lon Zoti, njëfarë emocioni që diqysh vajza është shku me tona gjanat”.

Bekrija është e re në moshë, fanatike e çejzit. Rrëfimin e saj e tregon derisa unë e vizitoj edhe dyqanin e saj, aty ku ajo është 'nuse për së dyti', duke shitur rroba për nusëri. Ajo thotë se çejzi sot nuk e gëzon ndoshta fatin dhe emocionin e dikurshëm por është traditë dhe lehtësisht nuk shkëputet prej këtij populli.

“Nëse për një ditë a dy nuk përdoret, kthehet prapë. Kur je shyhretli, i respekton traditat tona dhe çejzin. Osht njëfarë kënaqësie për mu edhe sot me punu në çejz, edhe me e mirëmbajtë. Unë vet 40 tentene i kom punu për dasmaxhinjtë që kanë ardhë, e motra i ka shpërnda me tabak, që me u ditë që i ka sjellë nusja edhe janë punim dore. Shpirti m'knaget edhe kur e mendoj çejzin tem, edhe kur e përdori.

Unë tre jeleka i kom që i ndërroj për raste të ndryshme, e fëmijës tem nesër ma e knaqt jom me ja bo krejt çejzin, edhe nëse veç nuk i pëlqen” tregon Bekrija.

Në dyqanin e saj, ka interesim edhe sot për produkte që e kompletojnë çejzin e nuses. Dallamat, shembull, kushtojnë prej 400 euro e tutje. Ajo vetë i ka pasur të tillat në çejzin e saj.



## A është sot i njëjti interesim për çejzin sikur më parë?

Periodha derisa përgatitet çejzi, e cila njihet në kulturën popullore edhe si periodha 'nër unaz', përshkohet prej normave të larta morale. Gruaja i ekspozohet ndalesave të lëvizjes: ajo nuk shoqërohet shumë me shoqet e saj, nuk shëtitë nëpër lagje, nuk duhet të shihet në oborrin e saj (sidomos prej atij që do të jetë së shpejti bashkëshorti i saj dhe bashkëudhëtari i jetës) dhe as duke e punuar fushën. Si shenjë të jashtme e betimit, ajo e mban një shami a shallë në kokë.

Në regjionin e Hasit, vajza mbante një shallë të bardhë derisa në Malësi të Madhe, një xhubletë me oja. Koha më e madhe e vajzës do të kalonte duke i qepur e thurur gjësendet e çejzit të saj. Në gjum, vajza do të ëndërronte për jetën që po e priste, plot mëlmesa bashkëshortësie.

E sapo të përfundojë çejzi, dy familjet – ajo e vajzës dhe djali diskutojnë dhe familja e djalit shkon tek familja e vajzës për ta 'këput hesapin' dhe për ta 'marrë penin'.<sup>1</sup>

I bukur dhe plot traditë si veprim.

Megjithatë, me kalimin e kohës, paja e nuses do të mund ta ketë humbur vëmendjen. Kohët moderne sikur kanë sjellë gjenerata të cilat e kanë problem të adaptohen me këtë pjesë të institucionit të martesës, shpesh duke mos e llogaritur aspektin e traditës dhe ruajtjes së një rituali i cili, i shpejtë, humb nga sytë gjatë martesës por rikthehet në përdorim gjatë jetës së gruas pas martesës.

“Ka edhe sot interesim, ka shumë gra të reja të flakta për me bo çejzin e mirë, me jeleka e dallame e me tentene, edhe me këmisha ma serioze. Unë kam kujdes, se një katror me bo me e gabu, krejt tentenja prishet. Hala edhe sot kur dikush fejohej a martohet njerëzia çojnë tentene, ja maron një tentene dikujt- thojmë na” tregon Bekrija.

Rrobaqepësja dhe shitësja në LETA d.p.z në Prishtinë e cila nuk dëshiron të tregojë emrin e saj, thotë se interesimi është shumë më i vogël se më përpara, megjithatë kjo lidhet me faktin se perceptimi në përgjithësi për paketën komplete të çejzit ka ndryshuar.

“Nuk po përdoret sot çejzi edhe paja si ma përpara, nuk po praktikohet shumë. Të jashtit që vijnë kanë qef ma shumë se këta tanët. Unë normal kur ka kërkesa e boj çejzin komplet, e punoj vet edhe bile me

<sup>1</sup>[http://chwb.org/kosovo/wp-content/uploads/sites/3/2014/07/Publication\\_2006\\_3.pdf](http://chwb.org/kosovo/wp-content/uploads/sites/3/2014/07/Publication_2006_3.pdf)



shumë kënaqësi. Tentetet i kanë qef ma shumë, për tavolina, por ka dikush që blen postava e elemente tjera” tregon shitësja, e cila thotë se kërkesat çdoherë e më shumë po shkojnë drejt rënies.

Tentenet për çejz në këtë dyqan, të gatshme, kushtojnë prej 20 euro e deri në 60 euro, varet prej madhësisë.

“Ma përpara, tentenet shembull janë vendosë në tavolina që kanë qenë të këqija, e tentenja e ka zbukuru. Sot krejt po blejnë tavolina të bukura edhe tentenja as që vjen në konsideratë” tregon kjo shitëse,

dukshëm edhe vet një fanatike e çejzit dhe ruajtjes së kësaj tradite.

**Sociologe dhe profesoreshë, Nita Luci ka treguar në një diskutim në kryeqytet mbi çejzin se ai është trajtuar si një lloj i së bukurës por jo si një lloj aset i që ka mundur të transformojë pozicionin shoqëror ose ekonomik të grave.**

**“Ajo se çka është komunikuar nëpërmjet çejzit varet edhe nga gjenerata dhe përkatësia socio-ekonomike. Është çështje e kapitalit ekonomik, simbolik dhe kulturor, njëkohësisht qasje për kërkim të pushtetit”.**



## Ta mbash gjallë çejzin me anë të filigranit të letrës e me anë të projekteve artistike

Dhe si i tillë, çejzi ndër shqiptarë vazhdon të frymojë. Nuk duket se është as në frymët e fundit sepse me iniciativa të ndryshme, paja e nuses do të jetë e pranishme edhe te nuset e ardhshme shqiptare, por edhe tek sytë e atyre që çejzin e shohin ose si shtypje që ka ardhur prej patriarkatit ose si një art në vete, një bukuri artistike që nuk meriton zhdukjen.

Sali Shoshi nga Cultural Heritage Without Borders (Trashëgimia Kulturore Pa Kufinj) –CHWB, na tregon se kjo organizatë ka ndihmuar disa herë në hulumtimin dhe dokumentimin e traditave të çejzit si një



pjesë e trashëgimisë shpirtërore të shqiptarëve dhe popujve tjerë të Ballkanit.

Në vitin 2005, CHWB është marrë me organizimin e dasmës tradicionale me të gjitha aspektet e organizimit, përfshirë edhe çejzin. Dasma është organizuar në bashkëpunim me komunitetet lokale të Isniqit dhe Drenocit.

“Gjithashtu, një tjetër kontribut i CHWB-së është mbështetja e zejtarisë – punime dore. CHWB ka ndihmuar në themelimin dhe konsolidimin e rrjetit të grave artizanale të OJQ JETA në Deçan. Bëhen 15 vjet që ky rrjet është funksional dhe një prej aktiviteteve të tyre është puna artizanale, përfshirë përgaditja e çejzit. Kuptohet që sot çejzi është transformuar dhe ka të bëjë me tepër në ruajtjen e traditës së saj në nevojën utilitare” tregon Sali Shoshi.



Doruntina Ukimeri, vajzë e re nga Kosova, pikërisht me ndihmën e programit Heritage Space në CHWB, ka marrë përsipër një mision të rëndësishëm: përkthimin e çejzit nga një traditë shqiptare në një projekt që mund të gjenerojë të holla dhe të jetë ekonomik.

Prej vitit 2012-të, ajo punon si artiste me teknikën e filigranit të letrës, ku krijon mes tjerash edhe punime me motive nga komponentet e çejzit. Ajo vetë nuk është martuar me çejz, por thotë se si e vogël ka parë shumë çejze dhe është mahnitur se sa shumë punëdore dhe sa shumë mund e vullnet është shpenzuar që në fund, gjithçka të duket bukur.

“Fillimisht, kom dashtë me e ripru qilimin e gjyshes time të cilin ajo e ka prurë në çejzin e saj. Filigrani i letrës kërkon shumë kohë,

dhe unë e punoj me letër të hollë në shirita 5-milimetërsh. Në projektin tonë, me qëllim që këto punime të shiten, unë po i bëj në formate të vogla: pra në vend të një gobleni unë po e punoj një lule të goblenit, në vend të tentenes vetëm një pjesë të saj” tregon Doruntina.

**Para pak muajsh ajo e hapi në Prishtinë ekspozitën e saj me këto punime. Së shpejti, ajo do të nisë që ti shesë këto punime në internet, dhe më pas edhe në dyqane.**

“Te Kanuni i Skënderbeut është e përcaktume çka duhet me pasë një çejz, sepse gjithmonë ka qenë ndër shqiptarë një traditë e lidhur shumë me mënyrën e jetesës së njerëzve. Femrat është dashur të përfshijnë në çejz pizhama, qarshafa,



jeleka, opinga, ka pasur edhe gjësende më intime dhe janë përgatitë edhe gjëra për vdekjen, për ceremonitë mortore, e madje edhe pjesë të veshjeve të brendshme për gratë” tregon Doruntina, e cila edhe e ka hulumtuar çejzin ndër shqiptarë, një pjesë pak e dokumentuar.

Në vitin 2016, në Malësi u hap një ekspozitë që kryefjalë e pati çejzin. Në Muzeun Etnografik të Malësisë, në Lekaj, në gusht të vitit 2016 u hap ekspozita 'Paja e Nuses'. Ekspozita asokohe u vizitua shumë pak, derisa pronari i Muzeut, Shtjefën Ivezaj, ishte zhgënjyer me numrin e vogël të vizitorëve.

Aty ishin të ekspozuara veshje nusërie dhe mjete të tjera të cilat sipas zakonit, i siguronte familja e nuses, si pasuri të cilën nusja do ta merrte me vete tek burri. Në këtë ekspozitë kishte edhe punime që datonin nga viti 1966 dhe ekspozoheshin për herë të parë.

Dhe një herë e një kohë, në pajën e një vajze ishte një piano. Kjo vajzë ishte vajza e poetit Naim Frashëri, e cila diku rreth vitit 1890, solli si pjesë të çejzit një piano, një histori kjo që ka mbetur e shkruar në historinë e Frashërlinjëve plot kulturë e intelekt.

## Çejzi e paja, pjesë e Kanuneve shqiptare ndër vite

Në të kaluarën, çejzi ishte pjesë e pamunguar e mozaikut të dasmës kur vajzat e reja përgatiteshin për martesë. Qilima, çarçafë, mbulesa dekoruese e elemente tjera duhej të përmbante arka e çejzit. Edhe sot, figurativisht çejzi i nuses përmban kryesisht elemente të njëjta: goblen, jelek, qilim, vath filigrani, tentene, mindil, çorape me maja të kuqe, opinga, qafore filigrani dhe jastëkët.

Në kulturën shqiptare, paja e nuses është e përcaktuar edhe me Kanun, libër ky i cili dikur përfaqësonte përmbledhjen e normave dhe dokeve shqiptare me karakter juridiko-social. Kanuni i Skënderbeut, në kreun e katërt e shtjellon fejesën dhe martesën ku ndër të tjera përcaktohet edhe veshja apo paja.

Në artikullin e IX-të të kreut të katërt shpjegohet Sheji.

“Sheji është unaza, shamija e të hollat që shtëpia e dhëndrit i çon shtëpisë së vajzës për të xanë bijën e tyre për djalin e vet. Të hollat e shejit nuk shtihen në pajën e vajzës, por i shkojnë shtëpisë së saj”.<sup>2</sup>

Në artikullin e XI-të përcaktohet në detaje paja mesatare e nuses së krishtere si dhe paja mesatare e nuses muhamedane.

**Sipas Kanunit të Skënderbeut, paja mesatare e nuses së krishtere përmban, mes tjerash, edhe 15-20 palë këmishë e mbathje, 8 xhamadanë kadife - 4 të kuq e 4 të zi, 8 përparëse (bohçe), 15 palë çorapa të gjatë leshi posë darive, 2 vargj (zinxhir) priçi prej 5 fillesh, 4 palë opinga gjedhi, 6 unaza, 1 groshar: Varg sermi me pare t'imta (grosh e gjysëm korone), 1 palë vath sermi, 1 krahën, duvakun: herë me shqipe të zeza dykrenare në mes të fushës së kuqe e here me kryq ari në mes të fushës së kuqe. Krushqit kur shkojnë me e marrë nusen i dërgojnë prej anës së dhandrrit 1 palë opinga.**

Paja mesatare e nuses muhamedane përmban, mes tjerash, 15-20 këmisha e mbathje, 15 jelek e mejtana (anteriora kumbashi me ngjyra), 6 shamija të mëndafshita, 10-15 përparëse (bohçe) të kuqe me vija, 2-3 prej tyre janë të zeza, 15-20 palë çorapa të gjatë leshi, 1 gjerdan, 1 ibrik, 1 legen, 1 gjym. Krushqit kur shkojnë me e marrë nusen i dërgojnë prej anës së dhandrrit opinga, krahën, gërshanë, sapun, duvak dhe gjybel.

<sup>2</sup>Kanuni i Skanderbegut, Botim i Arqipeshkvisë së Shkodrës, Shkodër 1993; Kreu IV, artikulli IX, fq.29

Kanuni i Lekë Dukagjinit gjithashtu e përcakton shejin por jo edhe pajën në detaje. Në nyjin e nëntëmbëdhjetë të këtij kanuni përcaktohet çmimi që jepet për gra dhe vajza.

'Çmimi, qi nepej për varza e gra, tash e 50 vjetë e andej, perbahej prej 50, 100, 200 mijë 400 groshësh; Çmimi i kanus së vonë përbahet prej 1500 groshve, aq sa ban gjaku l grues'.<sup>3</sup>

Çejzi është traditë që sot praktikohet në mbarë botën. Në adetet boshnjake, çejzi poashtu zë vendin e tij në hierarkinë e ditës. Në dhomën e nuses ekspozohet çejzi, derisa ajo pret të largohet me kalin e shalës që është i dekoruar me dy çevre në kokë.<sup>4</sup>

Çejzin shqiptar, për ta sjellë në formën e tij perfekte, shpesh kanë ndihmuar edhe nënat e nuseve. Janë punuar qylyma, dyshekët, sexhadet, jastëkët, e më pas janë punuar edhe këmisha me pëlhura, pullovera, xhempera. Janë punuar dikur edhe hyramat, që më vonë nisën të quheshin çarshafa.

Në zonat më të thella të Shqipërisë, që në momentin që lindte vajza nëna kujdesej që çdo gjë t'ia ruante vajzës për pajë, për çejz. Për nënat shqiptare ka qenë gjithmonë krenari që gjërat më të bukura t'i ruanin për

çejzin e vajzës, sepse një çejz i madh, i bujshëm dhe i qëndisur sa më mirë tregonte edhe pozicionim në shoqëri. Me grep punohej çdo detaj, prej peshqirëve deri te mbulesat.

Edhe në të dhënat më të vjetra dhe dokumentet më të lashta, siç është Kodi i Hamurabit në Babiloninë e lashtë, paja është përshkruar si një zakon tashmë ekzistues. Në Babiloni vajzat normalisht nuk trashëgonin asgjë nga pasuria e babait të tyre. Në vend të kësaj, me martesë, ato merrnin një prikë nga prindërit e tyre e cila kishte për qëllim të ofronte siguri jetësore për nusen.

Në Greqinë antike, praktikë e zakonshme ishte të jepej një çmim për nusen.

Në dasmën tradicionale serbe, çejzi është pjesë e rëndësishme, megjithëse dikur ishte më e fortë se sot. Krushqit serbë në shumicën e rasteve janë të dekoruar me peshqirë, me lule dhe rozmarinë. Zbukurohen edhe veturat, njëjtë sikur dikur qerret e kuajve apo çejzat.<sup>5</sup>

Në Azerbajxhan, çejzit i thonë pikërisht çejz. Në shoqëritë si ajo e Taxhikistanit, e Marokos (ku çejzi quhet shura, shawar, sssdaq ose amerwas – varësisht prej regjionit) e Bosnjës (çejzi titullohet oprema),

<sup>3</sup>[https://gruppostudentescoalbanesemilosao.files.wordpress.com/2014/12/kanuni\\_i\\_leke\\_dukagjinit.pdf](https://gruppostudentescoalbanesemilosao.files.wordpress.com/2014/12/kanuni_i_leke_dukagjinit.pdf)

<sup>4</sup>[https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806ae5ca&fbclid=IwAR2OGlopE2o\\_mO3xhNPSaD0Dxi\\_iUz2uJrqODfNOoQCC6VwRMJW1W7g94dI](https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806ae5ca&fbclid=IwAR2OGlopE2o_mO3xhNPSaD0Dxi_iUz2uJrqODfNOoQCC6VwRMJW1W7g94dI)

<sup>5</sup>[https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806ae5ca&fbclid=IwAR2OGlopE2o\\_mO3xhNPSaD0Dxi\\_iUz2uJrqODfNOoQCC6VwRMJW1W7g94dI](https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806ae5ca&fbclid=IwAR2OGlopE2o_mO3xhNPSaD0Dxi_iUz2uJrqODfNOoQCC6VwRMJW1W7g94dI)

apo edhe në Pakistan, çejzi ka rëndësinë e vet të pamohueshme dhe është pjesë që ruhet me xhelozë dhe praktikohet në dasmat e vendit. Në Nepal, për shkak të dhunës që lidhet me çejzin, ai është ndaluar me ligj.

“Më vjen mirë që po flitet për çejzin në këtë shoqëri sepse kom mendu që është një temë më e mbyllur. Sot, vajza moderne nuk ka nevojë për ndihmën as të familjes së saj as të familjes së burrit për të blerë diçka, ajo blen vetë çkado që dëshiron. Megjithatë, gjithmonë ka qenë si një

ekspozitë e vajzës dhe ka gjeneruar edhe të holla, një aspekt që mua më pëlqen tej mase” tregon Doruntina Ukimeri.

**“Vjehrra dhe kunatat janë të knaqne kur unë hala i përdori senet e çejzit. I përdori për Bajrama, për kanagjeqe, për fejesa, dimijat e jelekun. Përndryshe është mirë se e sheh vjehrra e kunatat që unë u shpenzova por edhe po i përdori këto gjana. Çejzi e ka hijeshinë e vet dhe kush është qejfli e respekton dhe e praktikon çejzin” tregon Bekrija.**









*Antoni i cili nuk pati kurrë pasaportë. Antoni i cili e gjuajti larg fjalën e tij. Antoni i cili udhëtoi shumë me fjalë, e më pak me këmbë. Antoni i cili e dashuroi marrëzisht Paulinën. Lulja dhe Paulini, fëmijët e Antonit, rrëfejnë si asnjëherë më parë për kujtimin ndaj njeriut që e kishin baba, e populli shqiptar e kishte e vazhdon ta ketë si një prej shkrimtarëve më të preferuar.*

Anton Pashku



## LULJA DHE PAULINI RRËFEJNË KUJTIMET ME BABAIN E TYRE, SHKRIMTARIN ANTON PASHKU

**Çdo kujtim që lidhet me babain e tyre, Lulja dhe Paulini e sjellin në mënyrën më letrare, të edukuar prej kësaj figure prindërore.**

Lulja e ka këtë emër sepse gjyshja e saj, nëna e nënës, e ka pasur këtë emër, ndërsa Paulini mban emrin Paulin – gati njëjtë sikur nëna e tij – Paulina.

Lulja, sot një juriste dhe Paulini një prokuror, janë fëmijët e Anton Pashkut dhe Paulinë Pashkut.

Dy njerëz tek të cilët vërehet i njëjti nur sikur i Anton Pashkut – një prej shkrimtarëve më të mirë që ka njohur e vazhdon ta njohë e ta zbulojë sot gjuha shqipe. Se sa i pazbuluar e shpesh i ashiqarshëm ka qenë Anton Pashku,

fëmijët e tij ulen në tryezë me mua dhe tregojnë kujtimet më të mira, të cilat padyshim i lënë në harresën e momentit të tjera çaste të një dite normale jetësore që fillon me një shkrimtar dhe përfundon me po të njëjtin.



Foto e vjetër, Paulin Pashku

“Si fëmijë, e kam pasë gjithmonë në qef kitarën. Pata fillu me mbledhë pare, me kursy, për me e ble këtë kitarë që e pashë. Unë i tregova babës që po kursej për me ble një kitarë dhe si duket se ai ka shku dhe e ka kqyrë sa kushton kitara. Më vonë ai vjen edhe më thotë se po i vyn disa pare borxh – më tha që mi kthen. Shkova i morra unë paratë që i kisha kursy edhe më tha – kadale se duhet një marrëveshje që unë me ti kthy paret, që ti me qenë ma e sigurtë. Kjo ka qenë edhe kontrata e parë në jeten teme, ai e shkruajti në letër: Anton Pashku – po i marr prej vajzës teme kaq pare dhe i kthej në filan datë. Mas 2-3 ditësh edhe mi ktheu paret aq sa mi kish marrë – si shenjë falenderimi që e kom ndihmu mi dha edhe të tjera dhuratë, e ato mjaftonin për me e ble unë kitarën. Atë pasdite shkum dhe e murrëm kitarën e bardhë e cila hala ekziston por osht e damtume, nuk funksionon”.

Lule Pashku, vajza e Anton Pashkut, kërcen prej tregimi në tregim sikur nuk gjen prehje kur flet për Antonin. Ajo e kujton babain e saj si njeri shumë të dashur, i cili ka zgjedhur të tilla mënyra për të depërtuar në diapazonin e fildishtë e simpatik të fëmijëve të tij. Një baba stimulues, në një stil të tillë që ndoshta nuk ka qenë gjithmonë direkt, por edukativ, me mënyra zbavitëse dhe interesante për të marrë mirëkuptimin e fëmijëve.

Lulja është më e vogël se Paulini. Paulini këtë gusht i mbushi 48 vjeç. Ndoshta një ose dy vite para se ai të lindte, çifti pati një fëmijë i cili vdiq në lindje. Ai do të ishte Gëzimi. Mjekët i thanë Paulinës se ajo nuk do të mund të bënte fëmijë sepse ekzistonte rreziku se do të vdiste. Gruaja e bukur e cila do të punonte si kontabiliste në Bashkësinë Kulturore Arsimore të Krahinës në Prishtinë ishte plot vetëbesim se ishte mirë e shëndetshëm për të pasur fëmijë, sado që Antoni i kishte premtuar dashuri edhe nëse nuk do të kishin asnjë fëmijë.

Në shenjë dashurie dhe mirënjohje ndaj insistimit të saj, Antoni e pagëzon djalin e parë me emrin e saj, Paulin.

“Si duket ky fëmijë ka qenë i lëndum, ashtu si duket qëllimisht e kanë bo mjekët, dhe për me e shpërta veten i thojnë prindërve që nana s'mundet me lindë. Baba pajtohet dhe thotë se do të vazhdojnë dashurinë. Mama insiston sepse e ka ditë që osht mirë, dhe më pas lindi Paulini, edhe pse atëherë kishin mendu që ka rrezik që nana me vdekë e fëmiju pshton” tregon Lulja. Ai që do të vazhdonte të duronte valët e jetës në heshtjen e librave të tij e dorëshkrimeve fletafleta, do të mbetej shkrimtari ynë – Anton Pashku.

**N'çast ndjeu një plogshiti të madhe që ia përshkoi tan trupin. Çdo gjë i dukej e çuditshme, madje edhe vetvetja. Kurr nuk e kishte tradhtue fuqija si kësaj radhe. Një lodhje e madhe e kaploi, tue fillue prej qepallave të syve e deri te gishtat e dorës, që i dridhesin bashkë me gotën. Ndjeu nevojën me u çue dhe me ikë prej atij vendi, por mendimi se kur t'eci do të duket qesharak, e pengoi, krenaria e tij nuk e la. Ajo e bani me u ulë edhe një herë në karrike. Ndezi një cigare dhe filloi me shikue i lodhun fjalat e tymit.  
(ANTON PASHKU)**

Anton Pashku, djali i Tonë Pashkut dhe nipi i Pashkë Bytyçit, vjen në jetë në Grazhdanik afër Prizrenit. Tërë jetën, siç tregon sot djali i tij Paulini, ai nuk ka pasur lidhje emocionale me Grazhdanikun. Ky vend asokohe ka qenë i vetmi afër Prizrenit ku ka pasur një mami, dhe kur ka ardhë koha e lindjes, aty ka lindur shkrimtari. Antoni e ka përmendur më së paku këtë pjesë, meqë rrënjët e tij ishin tjera.

Familja e Antonit ka qenë nga Bujani, Malësia e Gjakovës, nga fshati Bytyç. Kah fundi i shekullit 19 familja kanë kalu në pjesën e Hasit në Zym. Kështu së paku e kujton Paulini, i cili mund ti numërojë deri në 14 breza të familjes me emrat që

përsëriten: Ndreka ka qenë i pari, më pas Preka, Gjoni, Pjetri, Nikolla, Antoni.

Shkrimtari i lindur në vitin 1937, i cili më vonë do të ishte dora pas “Sinkopa”, “Oh”, “Gof”, “Lutjet e mbrëmjes”, “Kulla”, shpesh ka pasur probleme me emrin e tij.

“Gjyshi kish pas shku kur kanë dashtë me pagëzu Antonin tek Zoja Ndihmëtare në Prizren. Aty prift ka qenë njëfarë Don Rroku, i cili kur e ka pa emrin Anton ka thënë se ky fëmijë duhet me u pagëzu me emrin Ndue – që është versioni i emrit Anton në shqip. Mas shtatë ditëve Antonin baba i vet e ka regjistru në Komunë me emrin që e ka dashtë vet – Anton. Në Prizren thojnë se ka ndodhë njëherë një vërshim shumë i madh, dhe për pjesën katolike regjistrimet kanë qenë në Kishën Katolike. Aty shumë njerëzve u janë paraqitë edhe emra të dyfishtë. Mamës, e cila në dokumente ka qenë Paulinë, prifti e ka regjistru si Palinë” tregon Lule Pashku.

**Ata që nuk e kanë lexuar Anton Pashkun, kanë gabuar. Dora e këtij njeriu ka shkruar edhe tregimet 'Në stuhi' apo 'Klihma', botuar në vitin 1957. Me tregime ai vazhdon gjatë tërë jetës, shpesh të përmbledhura e shpesh të shpërndara.**

Antoni përfundoi shkollimin e mesëm – Gjimnazin real në Prishtinë. Gjithë kohën punoi në Rilindje, njëherë gazetar, mandej redaktor i rubrikës së kulturës e në njëzet vjetët e fundit punoi redaktor në Shtëpinë Botuese Rilindja.

### **Fëmija i parë është gjithmonë gëzim, edhe shpesh lazdrim.**

“Unë e kom pasë një përshtypje që si fëmijë, prindërit kanë kqyrë me çdo kusht edhe me m`lazdru, ndoshta për atë edhe s`jom lazdru. Andërr nëse kom pa diçka, baba ka shku dhe e ka gjetë. Gjithmonë i kom dashtë anijet, marinarët, kapelat, me ja përmendë –çka kisha pasë qef me pas një kapuç të marinarëve, ai veç e ka pru menjëherë” tregon Paulini.

**“Mama më ka tregu, thoshte kur vijsha në shpi, vijsha në të njëjtën kohë me Antonin, dhe kur i kqyrshim masditeve senet që i kemi ble dhurata, i kena ble të njëjtat lodra për Paulinin” e vazhdon rrëfimin motra e Paulinit, Lulja.**

Paulini, i cili vdekjen e të dy prindërve e ka përjetuar rëndë dhe larg Kosovës, kujton se fotografitë e tij me babën Anton janë gjithmonë kështu: Antoni e mban në qafë Paulinin, një mani e bukur e fotografive dikur, kur pindërit luanin me fëmijët dhe fotografoheshin në këto çaste lumturie.

Paulini është e treta gjeneratë me të vetmin djalë në familje. Ai është i vetmi djalë, Anton Pashku ka qenë i vetmi djalë dhe gjyshi i Paulinit, Toni bukëpjekës por i flaktë pas librave, i vetmi djalë në familje. “Mas vdekjes së gjyshes Lule, mas lindjes së motrës time Lules, nana osht smu. Unë e mbaj në mend këtë periudhë, baba ka qenë shumë i shqetësuar dhe kanë qenë momente kur e ka tregu anën e keqe të tij. Në një anë ka punu, në anën tjetër nana në Beograd, kjo ka qenë periudha e parë dhe e vetmja kur babën e kam pa të mrrolun edhe tu e ngritë zanin. Kuptohet që me kalimin e viteve i kom kuptu gjanat ma mirë, atëherë osht dasht me qenë 4-5 vjeçar” tregon Paulini.

Anton Pashku dhe Teki Denizishi



“Jam hasjan. Nuk kam lindur në Has, mirëpo të gjithë, babai, nëna, kushërinjtë, i gjithë farefisi vjen prej atje. Jemi nga Karashëngjergji, një fshat i rrethit të Prizrenit. Aty është i varrosur Shtjefën Gjeçovi. Epo unë s'e përjetova fare Karashëngjergjin. Kam lindur në Grazhdanik, fshat trekatër kilometra larg qytetit të Prizrenit, në drejtim të Nashecit. Interesante është se sot vështirë do të më njihnin atje. Gati kurrë se vizitova Grazhdanikun, pas lindjes. Bile dyshoj se do të më lejojnë të varrosem atje, kur të vdes...?!”

Sidoqoftë, sipas dokumentit kishtar jam lindur më 1 janar 1937-shit, kurse sipas atij zyrtar-më 3 janar 1937. Mbiemrin Pashku e kam prej gjyshit. Ai quhej Pashk. Përndryshe familja ime u takon Bytyçëve (fis i Thaçit), që banonim përtej Pashtrikut, përmbi Gjakovë. Edhe sot, ai vend quhet Bytyç-Bujani dhe fshatrat përreth.... Ato janë brenda rajonit të Bytyçit. Me të ardhur në Karashëngjergj, të parët e mi themeluan fshatin e vet-të Bytyçëve. Ndërrimi i mbiemrave filloi pas 45-it. Ku ta di pse, ishte dekret zyrtar...I bërë nëpër zyrat e pasluftës.”





“Antoni ka qenë shumë i lidhur me mamën, e ka pasë shoqe, se njëherë kanë pasë shoqni e më pas janë martu. Në Prizren kanë qenë së bashku në shkollë, ndërsa baba ka ardhë shumë ma herët në Prishtinë, rreth 15 vjet para familjes së mamës. Baba osht shoqnu edhe me dajën tem, e ka pasë shok. Nana e ka pasë mbiemrin e vajzërisë Mita. Kanë tregu që kur osht smu nana edhe ka shku në Beograd, baba kish pas vujt shumë, ka vujt derisa osht kthy nana shnosh në shpi. Fatin e keq e patën që prapë u smujtën kur isha në klasën e tetë, prapë në spital në të njëjtën kohë. Fati i mirë që u kthyn prapë shëndetshëm, dhe shpëtuan. Ka qenë kënaqësi me i pa bashkë, masditet i kanë kalu bashkë, kanë folë tema të ndryshme” tregon Lulja, por biseda asnjëherë nuk është e njëtrajtshme meqë të dyve u ngacmohet thellësia e kujtimeve dhe dëshirojnë t'i ndajnë ato edhe me mua.

“Në mramje, ka luft shah me mu. Prej Antonit kam fitu tri pasione: shahun, Gërmimë dhe detin. Kemi shku në Gërmimë e në Badovc, dilshim veç unë e baba. Shëtishim, më çojke nëpër rrugica të cilat si duket i ka njoftë mirë. Ka qenë notar i mirë” e vazhdon kujtimin Paulini.

**Anton Pashku nuk ka qenë një prind tradicional i kohës. E ka kërkuar mendimin e të tjerëve, ka respektuar mendimet ndryshe, aspak imponues. Është rritur në një familje tradicionale, 6-7 muajsh ishte kur shkoi të jetonte në Prizren. Baba i tij sakrifikoi shumë, njëjtë edhe gjyshi.**

“Baba kështu ma ka përshkru gjyshin e tij: ai nuk ka qenë i shkollum, ka qenë autodidakt, ka pasë dëshirë me lexu. Baba m'ka tregu që gjyshi i tij i ka pru libra prej Shqipnisë edhe pse nuk ka ditë nashta as me lexu. Ai osht gëzu shumë kur i ka lindë ky nip, dhe prej këtij njeriu e këtij gëzimi ka ndrru mbiemri i familjes në Pashku, e kjo ka ndodhë mas 45-tës. Ky njeri, qysh tregonte baba, ka pru një deng libra që vetë s'dijke me i lexu, i rujke librat e i mbledhke” tregon Paulini. Për Pashkun, thotë se ku ka shkuar ka blerë libra. Pashku ka qenë edhe në çetën e Bajram Currit.

Për etjen intelektuale të Antonit, Paulini thotë se me vetëdije kjo ka ndodhur ndoshta krejt shkaku i gjyshit, Pashkë Bytyçit. Falë tij Antoni e krijoi personalitetin e tij, aspak të kopjuar.

Anton Pashku, shkrimtari i shqiptarëve, do të shoqërohej me shumë njerëz

intelektualë të kohës. Mes tyre, Antoni zgjodhi Ali Podrimën, ndërsa gruaja e Antonit zgjodhi shoqe të mirë Fitoren – gruan e Aliut.

“Shkrimtarin Ali Podrimja unë e kam kumar, ai mi ka pre flokët i pari. Me Lumin, djalin e tij, kemi pasë shumë shoqëri. Lumin e maj n`men si shokun e parë të fëmijërisë, si moshatarë jemi kon, pasi Dreni e Donika kanë qenë më të mëdhenj. Jom kon i prekun kur ka ndërru jetë, në atë kohë rrallë ka ndodhë që ndonjë fëmijë me ndërru jetë. Baba me axhën Ali kanë nejtë shumë, njëjtë edhe mama me tezen Fitore. Atëherë ka ekzistuar një kllapë e njerëzve kësajsoj. Jemi shoqnu edhe me familjen e Azem Shkrelit dhe të tjerëve që kanë jetu në lagjen Ulpiana e cila atë kohë ka qenë e banuar me shumë intelektualë të kohës” tregojnë herë Paulini e herë Lulja, duke plotësuar hapësirën e fjalëve

*Në fotografi, Lule Pashku*



mes tyre që dukshëm çon drejt të njëjtit destinacion – kryefjalës Anton Pashku.

**Shkrimtari e ka ditur frëngjishten, serbo-kroatishten dhe e ka kuptuar turqishten. I ka ndihmuar njerëzit në gjithçka, ka dashur t'i ngritë njerëzit më lart.**

Anton Pashku nuk është pajisur asnjëherë me pasaportë jugosllave. Nuk ka udhëtuar shumë, tregojnë Paulini dhe Lulja. Si fëmijë, Paulini e kujton udhëtimin e Antonit në Grac të Austrisë gjatë Luftës së Dytë Botërore, me dajën e nanës i cili ka qenë tregtar i kohës.



Antoni ka punuar si gazetar në faqet e kulturës në Rilindje, prandaj ka udhëtuar në tërë hapësirën e ish Jugosllavisë, prej panairëve të librit e deri te festivali i filmit në Pula të Kroacisë. Nuk është ekspozuar shumë, gjithmonë një njeri modest, gjithmonë i kujdesshëm, familjar.

“Unë e pata gjetë një dokument ku autoritetet e kohës lypshin sqarim se a është Antoni i Kosovës apo i Serbisë, por ai nënshtetësinë nuk e ka marrë asnjëherë. E ka shfrytëzuar kaosin politik që mos me shku kurrë me u regjistru, por dokumentet kryesore i ka pasë në Kishë e jo në Komunë” tregojnë Lulja e Paulin Pashku, fëmijët e shkrimtarit Anton Pashku. Paulini tregon se kur ai vendosi të bëhej prokuror, Antoni e kishte përkrahur, me një këshillë pas vetes.

“Nëse e ki për shoqni, rri ma mirë aty ku je. Këtë e tha sepse atëherë jon bo zgjedhjet në baza shoqnore. Ai nisi me u bo kureshtar, e unë i thashë se shokët po dojn me nejtë në medicinë. Dy vitet e para të shkollës së mesme i kom kry në shkollën e medicinës, më pas në shkollën e ekonomisë, ishte sistemi i shumarit” tregon Paulini.

ANTON PASHKU

OH



RILINDJA



**Dy fëmijët e Antonit tregojnë se shkrintari ka qenë njeri i besimit, njeri që nuk ka ditur keq, burrë i dashur me të cilin Lulja ka shëtitur vikendeve. Antoni ka qenë një dëgjues i mirë edhe për një vajzë e djalë të vogël me imagjinatë të çuditshme. Paulinës, gruas, Antoni ia ka mbajtur pallton, ia ka hapur derën, të ka ndihmuar me e shprazë pijen, ka qenë plot respekt, tregojnë fëmijët.**



“E ka pasur patriotizmin e vërtetë, ka qenë atdhedashës, ka punuar për vendin dhe krejt jetën e vet e ka sakrifikuar për ideal. Nuk mund të mbetet në heshtje një njeri kaq i madh. Ai nuk ka kqyrë me e materializuar punën e tij, bajagi i shplum në atë kohë, osht ditë çka ka dashtë me thonë dhe kundër kujt ka shkru” tregon Lulja, kur unë e pyes për ndjenjën që sot e ka për Antonin.

“I kujtoj çdo ditë. Kur zgjohna në mëngjes më mungojnë prindërit, babai ka qenë familjar dhe kur ka punu nuk ka pas qef me dalë shumë. Baba ka qenë i shpisë, ka kalu kohë me neve ma shumë se me tjerët. I gjejsha në mëngjes mamën e babën tuj pi kafe, ndërsa në drekë e darkë i kujtoj me biseda. Antoni e ka pasë darkën në ora 7, shumë vonë s'ka pas qef me hangër” tregon Lulja.

Anton Pashku ndërron jetë me 31 tetor 1995. Varroset me 1 nëntor, datë kjo që në katolicizëm nënkupton Ditën e Gjithëshenjtit – Festa e të gjithë shpirtave. Shpirti dhe trupi i tij sot pushojnë në Karashëngjergj – në fshatin e gjyshit në Prizren. Shkrimtari ka qenë i diagnostifikuar me stadin e parë të kancerit por ka vekur nga një sulm akut në tru.

Paulini, i pari gëzim i trembur i çiftit Anton Pashku dhe Paulinë Pashku, do të ishte larg gjatë kësaj vdekjeje të Antonit. “Kam qenë deserter i luftës në Kroaci. E kom përjetu vështirë si 24 vjeçar, kur ka ndërru jetë baba”. Familja jeton për shumë kohë në Prishtinë, së pari në Ulpianë e më pas që nga viti 1977 në Dardani. Në Dardani, tri herë thyhet banesa e familjes, dhe epiqendra – siç thotë Paulini, janë pjesa e librave të Antonit dhe dokumentet personale. Antoni, tregojnë se ka shkruar më shumë natën, në qetësi. Ai gjithashtu shfrytëzonte kohën kur familja gjendej me pushime në Kamenovë, atje ku Rilindja e ndërmarrjet tjera kishin disa villa të cilat shfrytëzoheshin nga punëtorët e tyre për pushime.

Në fund Paulinin dhe Lulen i pyes nëse do të botojnë diçka tjetër, dorëshkrimet e lëna të Antonit të pabotuara kurrë.



### Paulini e ka zbuluar një roman të pabotuar.

Është “Tri hije në Bruksel” me të cilin Anton Pashku do të merrte pjesë në një konkurs në vitin 1994. Shkaku i një eksperience të tmerrshme me një njeri që keqpërdori të drejtat e autorit, Lulja e Paulini nuk flasin shumë kur rastis kjo temë.

Edhe Lulja edhe Paulini shkruajnë por kanë hezitim t'i ndajnë shkrimet e tyre me të tjerët. Një Anton është brenda të dyve, te Lulja më shumë në formë të ditarit që ajo e shkruan vetë ndërsa tek Paulini në formën e një lexuesi të letërsisë ushtarake.



*Fotografi nga albumi familjar*

KOSOVA

NË 14 TREGIME  
KULTURORE



*“Ti mëso të duash vogëlush.  
Ti mëso të ecësh me këmbët e tua mbi të keqen mbi  
të mirën, mendo me kokën tënde kurrë mos pështyj  
në dashuri, as në pleh;  
Mallkim i fisit.*

*Shkolla jote antike; të dish të çelësh derën e shtëpisë  
Në çdo kohë,  
Të dish të thuash fjalën kur duhet thënë.  
Urrejtja është më e rëndë se vrasja”.*

---

**Ali Podrimja**





## DONIKA PODRIMJA:

BABAI IM, PERSONI I HARESHËM  
DHE TREGIMTARI I LINDUR

### **Është e mahnitshme kur Donika Podrimja i kujton momentet me babain e saj, shkrimtarin Ali Podrimja.**

“Se ka qenë një person i cili poezinë e tregimin i ka pasur pjesë të jetës së përditshme, e dëshmon edhe tregimi se si është takuar me nënën tonë Fitorën. Ne deri sa jemi rritur kemi menduar se ai e ka shpëtuar nënën tonë nga peshkaqeni, në Pulë të Kroacisë, ku ata për herë të parë janë takuar. Dashurinë e tyre e ka përshkruar gjithmonë si diçka në mes hyjnores dhe magjepjes, dhe është kënaqur shumë me reagimet tona kur e tregonte këtë dhe storie të tjera të cilat më vonë kemi kuptuar që ishin imagjinatë romantike e babait tonë”.

Kështu e fillon rrëfimin e saj Donika, vajza e shkrimtarit Ali Podrimja. Shkrimtari, një fëmijë jetim, dashurinë prindërore e cila i mungoi më pas e ktheu në fuqi për familjarët e tij. Kujdesi i tij ndaj fëmijëve ka qenë i madh, tregon Donika, meqë ai e ka shfrytëzuar çdo rast për të shprehur dashurinë si prind.

“Babai im ka qenë një person i hareshëm dhe një tregimtar i lindur, si dhe shumë mendjehapur prej se e kam mbajtur ndër mend. Mua dhe tre vëllezërit na ka trajtuar me një dashuri të madhe dhe na ka ngulitur ndjenjën e barazisë në mes gjinive, e cila nuk ka qenë vetëm në raport me neve fëmijëve por edhe me nënën, si dhe nipin e mbesat” tregon Donika. Donika, sot vet një nënë dhe një grua që e di mirë rëndësinë e të pasurit fëmijë, tregon se e kujton shkrimtarin çdo ditë.

“E kam një engjull mbrojtës që çdoherë është afër meje. Ai si prind ka qenë afër meje në momentet më të vështira, dhe tani kur kam ndonjë vështirësi, unë mendoj në të, dhe kjo më jep siguri dhe guxim për të ecur përpara. Shpesh mendoj se sa më lehtë do të ishte, po të ishte ai me ne” tregon Donika.

Ali Podrimja lindi më 1942 në Gjakovë ndërsa që nga viti 1961 ka botuar prozë e poezi të ndryshme. Në vitin 1982 me përmbledhjen “Lum Lumi” zuri vendin e merituar në letërsinë shqipe, për të qëndruar aty deri në ditët e fundit, kur ndërroi jetë në vitin 2012-të. Për të vazhduar edhe sot. Nuk ka sot shqiptar që e do fjalën e bukur dhe që nuk e njeh Ali Podrimën.



*Nga albumi familjar*

## LUM LUMI

*A thua është dita jote e fundit në spital do t'i biem deri në fund a thua edhe kësaj dite të lodhur në orën e familjes.*

*Nuk të kam sharë as nuk të kam rënë kurrë vetëm të kam thënë; Ai në hapsirë atje larg jam Unë. Në jetë, në art vrasësit më të mëdhenj janë frikacakët. Mjeshteria e tyre; gjuajtja në gabime, dhelpëria.*

*Ti mëso të duash vogëlush.  
Ti mëso të ecësh me këmbët e tua mbi të keqen mbi të mirën, mendo me kokën tënde kurrë mos pështyj në dashuri, as në pleh;  
Mallkim i fisit.  
Shkolla jote antike; të dish të çelësh derën e shtëpisë  
Në çdo kohë,  
Të dish të thuash fjalën kur duhet thënë.  
Urrejtja është më e rëndë se vrasja.*

*Me ditë me shikon nga krevati i vjetër; spitali tepër i vogël për dhimbjet e tua për shtatë plagët e tua për ditët, për netët e tua plot klithje.*

*spitali tepër i vogël  
i vogël tepër spitali  
nën te Danubi i thellë e i kaltër.  
A thua tërë jetën do të na vijë era jod sëmundje, murtajë  
do pështyjmë gjak e vrer,  
a thua tërë jetën t'i dezinfektojmë plaçkat, ëndrrat, fjalët.*

*A thua edhe këtë ditë do ta kalojmë në spital.  
Të shikoj; në syrin tënd flaka, etja, qielli,  
Në syrin tënd asnjë dredhi, asnjë mlllef pastërta e syrit tënd më ka përpirë të tërin.  
Në fund të syrit tënd  
hap fatin tim të kobshëm.  
Ai nuk jam Unë  
Ai nuk je Ti  
Kush jam, kush je?  
Syri yt mbyllet, dhe frëngjia në Kullë.  
Poezia më e bukur ende s'është shkruar  
as do të shkruhet  
përderisa zhytësit ende jetojnë  
Vogëlushi im, thellësia mashtron, vetëm largon nga e vërteta  
dhe çdo fund është tragjik.  
Po ç'ka aty poshtë në materie  
Miu i Bardhë, antimateria.*

*Do të vijë koha kur do të më hapësh si një libër të vjetër psalmesh  
kur do të mësoj të ecësh nëpër pluhurin tim  
por koha ecën shpeshherë në shpinë të breshkës.  
A thua na u sosën fjalët, këngët,  
na mudi ëndrra, udha,  
a thua edhe kjo ditë po na lë me shpirt ndër dhëmbë.  
Ti je më i madh, vogëlush, më i fortë se ky spital  
për inat këtë ditë ta sosim deri në fund.  
Lum Lumi.*

---

**Kur kujtojmë shkrimtarin Ali Podrimja, kujtojmë 'Lum Lumin', poezinë ndoshta më të thellë dhe më të dhimbshme të shkrimtarit. Shumë njerëz bashkëndejnë në dhimbjen e shkrimtarit, dhe historinë e trishtë të humbjes së të birit.**

---

“Kujtimet më të vështira i kemi nga koha e tragjedisë tonë familjare, kur prindërit tanë, në moshë të re, janë përballur me një sëmundje të rëndë dhe vdekjen e djalit, Lumit. Poashtu, humbja dhe pastaj vdekja e babait në Lodeve të Francës, ka qenë një anktë dhe vuajtje e madhe për ne, pasi ndërroi jetë në vetmi. Shkuarja e vëllaut, Petritit, menjëherë në Francë ishte një ngushëllim për të gjithë ne që nuk kishim viza të udhëtonim, por Petriti i vetmuar në Lodeve mori lajmin e hidhur për babain, dhe sot e kësaj dite e kam në vesh zërin e tij duke qajtur kur na lajmëroi se babai është gjetur i vdekur” rrëfen Donika.

Më 18 korrik 2012, Ali Podrimja ishte zhdukur gjatë një festivali të poezisë në Francë. Pas kërkimeve të pareshtura të autoriteteve franceze, më 21 korrik 2012, u gjet trupi i pajetë i shkrimtarit.

Për Donikën, kjo poezi por edhe një përmbledhje e tërë e poezive nën këtë emër, është dhimbja familjare e thurur në vargje e tragjedisë.



Poeti Ali Podrimja, nga Mario Bellizzi.

Donika sot duhet të jetojë jetën e saj, gjithmonë duke u mbështetur në bagazhin letrar voluminoz e të fuqjshëm të Aliut të të gjithë shqiptarëve, të të gjithë botës së poezisë.

“Poashtu, i pëlqej edhe poezitë që i ka shkruar në moshë shumë të re, kur populli shqiptar ka qenë i shtypur. Më fascinon fakti që pothuajse si fëmi, babai ka gjetur shprehje të tilla artistike për të shprehur patriotizmin e tij, dhe si ka mundur në një moshë aq të re të ketë aq ndjenja të forta patriotike. Tash ndjek krenari për ato poezi, sikurse “Unë Biri Yt, Kosovë' që është shndërruar në amblemë identitare të Kosovës” tregon Donika.

Ndër veprat më të njohura të Podrimjes janë : “Thirrje”, “Dhimbë e bukur”, “Sampo”, “Credo”, “Drejtpehimi”, “Lum Lumi”, “Fundi i Gëzuar”, “Zari”, “Në bisht të sorrës”, “Buzëqeshje në kafaz”, “Ishulli Albania”, “Pikë e zezë në blu”.

## **Donika mund të quhej lehtësisht Lekë**

“Në të vërtetë, unë është dashur ta kem emrin Lekë, meqenëse prindërve të mi u është thënë se do të jem djalë, pasi në atë kohë nuk ka qenë e mundur që të

detektohet gjinia e frutit, por është bazuar në interpretimin e njerëzve nga dukja e gruas shtatëzënë” tregon Donika.

“Kur kam qenë e vogël nuk më ka pëlqyer shumë emri im, pasi më është dukur si emër për njerëz të moshuar, dhe kam kërkuar që të ma ndërrojnë. Por, babai ma ndërroi mendjen kur më tha se Donika ka qenë një mbretëreshë, një grua e fuqishme dhe e ditur, se unë jam kryevepra e tij, dhe se për këtë arsye duhet ta mbaj këtë emër. Përsëri, kjo ishte njëra ndër imagjinatat e tija magjepëse, me të cilat na zbukuronte jetën çdo ditë” vazhdon Donika.

Ajo kujton se Aliu ka udhëtuar shumë, si për krijimtarinë e tij ashtu edhe për lobim për çështjen e Kosovës në rrethet intelektuale të Evropës.

“Barra më e madhe për kujdesje ndaj neve fëmijëve ka qenë e nënës. Ai kur kthehej nga udhëtimet mendohej që të kalonte sa më shumë kohë me neve, dhe të na argëtonte me tregimet e tij. Kthimet nga udhëtimet e kishin edhe një gëzim tjetër për neve fëmijëve, pasi babai gjithmonë na sjellte dhurata që na gëzonin shumë” tregon Donika.

Në Gjakovë ka një park me emrin e shkrimtarit ku të rinjtë e Gjakovës

mblidhen për ngjarje kulturore dhe artistike. Aty edhe përkujtohet në çdo përvjetor të vdekjes, shkrimtari Ali Podrimja. Donika thotë se ajo dhe familja i janë mirënjohës Gjakovës, vendlindjes së shkrimtarit, me këtë park por edhe me vendosjen e bustit të tij.


“Kolegët dhe miqtë e babait në mënyra të ndryshme dhe me aq sa kanë mundësi e kujtojnë dhe e nderojnë atë. Jemi shumë falenderues ndaj Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, që pos organizimit të ceremonisë mortore në mënyrën më dinjitoze, ata shumë shpejtë pas vdekjes së tij e botuan vëllimin prej nëntë librave të krijimtarisë së tij. Vend të veçantë kanë edhe miqtë e tij nga Franca, të cilët në vazhdimësi i botojnë poezitë e tij në gjuhën frënge. Një pjesë të panjohur të madhështisë së tij njerëzore jam duke e kuptuar dita ditës, nga miqtë dhe kolegët e tij, të cilët më tregojnë se si ai iu ka ndihmuar në rrugëtimet e tyre artistike. Poashtu, tani jam duke e kuptuar edhe më mirë se sa shumë dhe me vite të tëra ai dhe intelektualët e vendit tonë kanë punuar për çështjen e Kosovës në forume të ndryshme ndërkombëtare, të cilat kontribute janë të përmbledhura në esetë në vëllimin e veprave të tij të botuara nga ASHAK” përfundon Donika.

Nuk ka mënyrë më të mirë ta kujtojmë shkrimtarin me të cilin jemi rritur të gjithë, sesa me një poezi të shkruar nga dora e tij.

## UNË, BIRI YT KOSOVË

*Unë biri yt, Kosovë, t'i njoh dëshirat e heshtura,  
t'i njoh ëndrrat, erërat e fjetura me shekuj,  
t'i njoh vuajtjet, gëzimet, vdekjet,  
t'i njoh lindjet e bardha, caqet e tua të kallura;  
ta di gjakun që të vlon në gji,  
dallgën kur të rrahë netëve të pagjumta,  
e të shpërthejë do si vullkan,  
më mirë se kushdo tjetër të njoh, Kosovë,  
Unë, biri yt.*









## Istref Begolli

*Istref Begolli, në pjesën e dytë të vitit 1974 njoftohet me Hadije Malokun nga Prizreni me të cilën martohet me 28 dhjetor 1974. Në shtator të vitit 1975 vjen në jetë Alba. Çifti, në kohën kur u njoftuan ishin në ndërtim të karrierës së tyre. Hadije Maloku-Begolli ka qenë Gjykatësja e parë femër në Kosovë, pastaj deputete në Parlamentin e ish-Jugosllavisë, në vitin 1979 Kryetare e Grave të Kosovës e deri në pensionimin e saj në cilësi të Avokates Krahinore të Kosovës në janar të vitit 1990. Këtë dyshe intelektuale e kujtojmë me anë të vajzës së tyre, Albës.*





## ISTREF BEGOLLI

AKTORI TRAGJEDIANT  
I CILI EDHE PËRFUNDOI  
TRAGJIKISHT

Istref  
Begolli

KOSOVA NË 14 TREGIMË KULTURORE

---

**Mbrëmjen kur i lindi fëmija i parë dhe i vetëm, aktori Istref Begolli ishte duke e luajtur rolin e “Makbethit” të Shekspir. Begolli, ky burrë i fortë që nuk linte dërrasë të Teatrit pa lëvizur vendi, o me timbër o me paraqitjen e tij, pasi që e përfundon shfaqjen kolegët e Teatrit Kombëtar sot – asokohe Teatri Krahinor e njoftojnë se gruaja e tij ka lindë “djalë”.**

Istref Begolli, me gëzim i fton kolegët që të mbledhen në Byfenë e Teatrit derisa ai sigurohet se gruaja e tij dhe “djalë” i posalindur gëzojnë shëndet të mirë. Kur thërrret në telefon tek familjarët e tjerë i thonë se gruaja dhe vajza janë mirë. Vajza? Atij i kishin thënë se e kishte fituar një djalë. Begolli niset prej përdhësës të Teatrit ku shfrytëzohej telefoni fiks e deri në

katin e tretë tek Byfeja, tejet i gëzuar për ardhjen në jetë të vajzës: *“Ejani të gjithë, më ka lindur vajzë”* – ishin fjalët brohoritëse të Begollit, i cili u bë babë në moshën 42 vjeçare. Kolegët ia kishin dhënë lajmin jo të saktë aktorit të madh meqë ai kishte qenë i vetmi djalë në familje përkrah dy motrave të tij.

**Kjo vajzë e cila nisi si “djalë” është Alba Begolli që jeton në Prishtinë, në banesën e trashëguar nga prindërit Istref Begolli dhe Hadije Maloku-Begolli të cilët e jetuan jetën krahas saj. Në po këtë banesë unë ulem bashkë me Albën në vendin e quajtur këndi i Istrefit, poshtë fotografisë së tij në rolin e “Makbethit” dhe gati për të hyrë në botën e njeriut vizionar e bashkëkohor, siç e përshkruan Alba.**

---

**“Baba ka qenë prind me të cilin kam pasur një raport shoqëror dhe shumë të përzemërt. Për nga natyra ishte emotiv, i butë, i ndjeshëm, rrezatonte plot dashuri, por njëkohësisht edhe personalitet i fuqishëm dhe parimor. Përpos si babë, e kam pasë edhe si vëlla dhe shok me të cilin kam mundur të bisedoj për çdo gjë apo “çështje”, për ta zgjidhur apo shtjelluar bashkërisht. Unë dhe ai e kemi pasur një raport jashtëzakonisht të çiltër dhe të veçantë” tregon Alba Begolli.**

---

“Ka qenë shumë i dhanun pas familjes, krahas karrierës së tij. I gëzohej gjithçkafit, edhe gjërave më të vogla, qoftë edhe vetëm një dreke të zakonshme. Ai thoshte se “duhet me ditë me i çmu e me iu gëzu gjanave të vogla sepse të mëdhatë rrallë ndodhin apo nuk ndodhin fare”. Ka qenë shumë i afërt si familjar si dhe me gjithë njerëzit. Unë jam me fat të jem vajza e tij dhe nana ime ka qenë gjithashtu me fat të jetë krah një bashkëshorti të tillë”, tregon tutje Alba.

Istref Begolli, një nga aktorët më të spikatur shqiptarët të gjitha kohërave, një figurë me plot prezencë dhe karizmë në çdo hapësirë ku depërtonte dhe realizonte role, lindi më 7 maj 1933 në Pejë. Shumë i ri, ai do të largohej nga Peja si 15 vjeçar për ta marrë rrugën drejt themelimit të Teatrit Krahinor në Prishtinë ku edhe do të lulëzonte karriera e tij si aktor i dërrasave të teatrit dhe roleve tragjike, aktor i cili shkriu e stërkriu role të mëdha edhe në skenat e teatrove prestigjioze të ish-Jugosllavisë.

“Në kohën kur kam lindë unë në vitin 1975, ai ka qenë në kulmin e karrierës së tij. Diku që nga mosha 12 vjeçare kam fillu me i asistu babës në secilin rol që ai e përgatiste. Fillimisht, baba niste me mësimin e tekstit duke u familjarizu me atë tekst. Derisa e përgatiste rolin ai mbante një fletore ku e shkruante tekstin që e përpunonte vet si dhe fjalinë e fundit të partnerit në rol. Ky “partner” isha unë gjatë asistimit. Kësisoj e mësonte ma lehtë tekstin, ushtronim së bashku me orë të tëra si dhe në magnetofonin e tij personal. Mund të them që prej të gjithë aktorëve shqiptarë të asaj kohe ai veçohej për diksionin e tij të shquar” tregon më tej Alba.

Banesa ku jeton Alba në të cilën Istref Begolli ka jetuar deri në vitin 2003, e deri në vitin 2017-të edhe Hadije Maloku-

Begolli, është e mbushur me fotografi të kësaj treshe familjare që jetoi në simbiozë të plotë, në lagjen “Bregu i Diellit” në Prishtinë.

Në një kënd është fotografia e vitit 1946 e Istref Begollit me nanën dhe dy motrat e tij. Jo shumë larg saj janë edhe fotografitë nga rolet e Begollit, si: “Dervishi dhe Vdekja”, “Makbethi”, nga përurimi i hapjes së Kino “ABC-së” në Prishtinë, etj. Dhomës i jep dritë edhe një fotografi familjare nga viti 1978.

**“Kam qenë shumë e lidhun me punën e babës, gjatë asistimit tim më është kriju dashuria me artin e tij. Pastaj, në premierë, unë e dija përmendësh krejt tekstin dhe kur uleshja në karrige “dridhesha” e tëra prej tremës” rrëfen Alba.**



*Istref Begolli me dy motrat dhe nënën e tij*



*Nga albumi familjar  
Familja Begolli*

---

**Istref Begolli, në pjesën e dytë të vitit 1974 njoftohet me Hadije Malokun nga Prizreni me të cilën martohet me 28 dhjetor 1974. Në shtator të vitit 1975 vjen në jetë Alba. Çifti, në kohën kur u njoftuan ishin në ndërtim të karrierës së tyre. Hadije Maloku-Begolli ka qenë Gjykatësja e parë femër në Kosovë, pastaj deputete në Parlamentin e ish-Jugosllavisë, në vitin 1979 Kryetare e Grave të Kosovës e deri në pensionimin e saj në cilësi të Avokates Krahinore të Kosovës në janar të vitit 1990. Hadije Maloku-Begolli vdiq në moshën 81 vjeçare me 12 shkurt 2017 pas një jete të shëndetshme dhe të gjatë.**

---

“Nana ka qenë person më temperament, një grua e vendosur, me mençuri të mprehtë në çdo aspekt, dhe e ka plotësu babën i cili ka pasur një natyrë më ndryshe nga ajo. Nana ka qenë shtyllë në familjen tonë të vogël e cila e ka mbajtur gjallë emocionin dhe ndjeshmërinë”, vazhdon Alba.

“Që të dytë kanë pasur shije të njëjtë, qasje të njëjtë ndaj jetës, kanë qenë shumë human dhe të afërt me njerëz. Dy personalitete me botëkuptime përparimtare dhe vizionare, dy intelektualë të shquar. Unë jam rritur në një familje të shëndoshë, në një familje me mirëkuptim dhe respekt, me virtyte të larta njerëzore që rrallë mund të gjinden në kohërat aktuale. Koha e vizionit të tyre është mu kjo në të cilën ne jetojmë sot. Më kujtohet kur baba thoshte se “çdo lagje do të duhej t'i përmbushë kërkesat e banorëve që mos me pasë nevojë me dalë në qendër të qytetit për me i plotësu obligimet dhe nevojat”. Peng më ka mbetë, sepse sot ka ardhë ajo kohë dhe baba nuk arriti t'i shih disa ndryshime pozitive që janë bërë” shprehet Alba, një vajzë që e ka trashëguar prej prindërve butësinë, kulturën, mirësinë dhe mbi të gjitha dashurinë për artin dhe të bukurën.



---

**Alba e kujton një ngjarje të veçantë me babën e saj, derisa e shpalosë këtë burrë të njohur të artit dhe kulturës para neve, në cilësinë e vajzës së tij. Ndonëse nuk e sheh të arsyeshme t'i kujtojë momentet e hidhura që iu ka sjellur jeta, sepse kur mendon në babën e saj mendon vetëm në kujtimet e mira të cilat fatmirësisht janë të shumta.**

---

“Periudha pas luftës, muaji prill ose fillimi i majit i vitit 2000. Në atë kohë unë kisha telefon mobil, por prindërit ende jo. Ditë e shtundë, me babën e vendosëm një vendtakim për në orën 9 të mëngjesit. Unë kisha punë, prandaj i thashë babës se do ta takoja tek vendi që e caktuam bashkërisht - do të shkoj drejt atje. E lam të takohemi në një vend në qendër të Prishtinës. Ai ka qenë tejet i përpiktë, nuk është vonuar kurrë, në asgjë. Atë fundjavë nana ishte tek familjarët e saj në Prizren. Unë dal prej banesës herët në mëngjes në 7:30 dhe në orën 09:00 shkoj te vendi i caktuar. Baba vonohet 15 minuta dhe unë filloj me mendu se mos i ka ndodhë ndonjë gjë. Shkoj në Teatër dhe interesohem në foaje mos është baba aty, disa ish-studentë e që sot janë

aktorë të njohur më thanë se nuk kishte qenë fare. E thërras nanën në Prizren dhe i them që babës mund t'i ketë ndodhë diçka, përndryshe nuk do të vonohej kaq gjatë. Ajo në ndërkohë planifikon të kthehet nga Prizreni.....Vendi ku e kemi lënë me u taku ishin dy dyqane me emër të njëjtë, mirëpo në dy lokacione të ndryshme-me pronarë të njëjtë. Baba kishte qenë në dyqanin me lokacion tjetër nga ai ku unë e prisja pothuajse 1 orë, numrin tim të telefonit nuk e dinte përmendësh. Te dyqani ku isha unë, dikur pronari provon ta telefonojë të vëllain e vet në dyqanin tjetër dhe ai i tregon që baba po më pret dhe se është shumë i brengosur pse nuk isha unë atje ende. Uhhh më në fund u gjetëm! Dhe, ai nisat prej lagjes “Pejton”, ndërsa unë prej qendrës të qytetit për t’u takuar diku në afërsi të Hotel “Grandit”-dhe në momentin kur bëhemi bashkë ai më drejtohet me njëfarë “idhnimi” – “A e din që lojën e zemrës ma ke bo”, derisa njëjtë i përgjigjem edhe unë. E krejt kjo si pasojë e keqkuptimit nga ana jonë! Ky është një moment që e kujtoj me shumë mall” tregon Alba.

Gjatë luftës në Kosovë, Alba me prindërit e saj nuk largohen nga banesa në Prishtinë. Ka qenë periudhë e rëndë për të gjithë, kujton ajo, e që nuk la pa e prekur edhe jetën kulturore e artistike të asaj kohe.

“Prej viteve 90-të baba nuk ka qenë i angazhuar në Teatrin Krahinor (aso kohe). Kur pushtuesit serb i morën të gjitha institucionet e morën edhe Teatrin, prandaj baba ka pasë shkëputje të gjatë nga krijimtaria e tij. Në ndërkohë i ka realizuar disa drama televizive, natyrisht në rrethana të vështira. Nuk e lëshuam banesën gjatë luftës sepse ai vendosi ashtu. Atëkohë ishte vital, por, po hynte në moshën e tretë të pjekurisë. Pas luftës, në pjesën e dytë të vitit 1999 dhe në fillim të vitit 2000 ka dhënë rolin e Atit në filmin “Vjeshta e Trëndafilave” shkruar nga V. Karahoda-në regji të A. Sopit, e që ishte roli i tij i fundit” kujton Alba Begolli sot, e cila merret me përkthime nga

gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas.

“Më vjen mirë që nuk jam gjykatëse ose aktore. Unë kam shpirt artistik dhe kam vendosë ta studioj Gjuhën dhe Letërsinë Angleze, dhe duke e pasë këtë lëmi dhe kualifikim tani merrem me përkthime. Për mua përkthimi është lloj arti në vete, përkthimin e konsideroj dhe e përjetoj si një vepër arti. Më vjen mirë që kam profil tjetër nga ajo e prindërve, por, dashurinë për artin e kam trashëgu prej babës. Për t’u bërë juriste as nuk kam sens e as nuk kam pasur interesim” thotë Alba.





---

**Istref Begolli e vazhdon jetën e tij të mbushur me role kolosale në teatro dhe filma për 50 vite të plota karriere. Alba, më tej, na tregon se ai në veçanti e ka pasur një dorëshkrim tejet të bukur të cilin ajo e trashëgoi. Krahas diksionit dhe timbrit të tij të veçantë dhe të mirënjohur, ka ditur edhe të këndojë bukur.**

---

Ai ka qenë dhe vazhdon të jetë tragjedianti më i madh i Teatrit Shqiptar. Mbi të gjitha njihet edhe për tremën e tij famoze para secilës premierë që kishte. Ka qenë perfeksionist i madh në punë dhe në jetë, në përgjithësi.

Rolet e tij, si: “Makbethi”, Jagua tek “Othello” të Sheksipirit, Prifti në “Gjeneralin e Ushtrisë së Vdekur” të I. Kadaresë, në “Bregun e Pikëllimit” të T. Dervishit, në “Dervishi dhe Vdekja” të M. Selimoviçit, të Atit në “Vjeshtën e Trëndafilave”, në “Përroin Vërshues”, film në regji të B. Sahatçiu, pastaj në dramën televizive: “Oda e Junikut” në regji të A. Mikullovcit; “Kulla” e A. Pashkut, “Vallja e Çmendur” e Qosjes, etj. i kanë dhënë Istref Begollit vendin e tij të merituar në hartën dhe pasaportën e

kulturës së artit shqiptar si dhe një vullë emblematike.

Në librin e lëndës të 'Historisë' në shkollat fillore, në një pjesë ku mësohet për artin dhe kulturën është përfshirë vepra e aktorit të madh Istref Begolli. Teatri Profesionist i qytetit të tij të lindjes në Pejë mban emrin “Istref Begolli”.

“Përderisa populli i rëndomtë sot e kësaj dite e çmon ende, e nderon, njerëzit e kujtojnë me dashuri, nostalgji, kjo për mua ka rëndësi. Ai i ka folë popullit, publikut.

*Fotografi nga albumi familjar*



Emri i tij kësisoj bartet në gjenerata e gjenerata dhe ata mësojnë e flasin për mjeshterinë e artit të tij” vazhdon Alba.

Albës nuk i ka mbetur peng asgjë karshi prindërve të saj. Si e vogël dhe adoleshente ishte e kënaqur të jetë i vetmi fëmijë. Por, me t'i kaluar të njëzetat ajo thotë se nisi të kuptonte e reflektonte mbi mungesën e një familjari tjetër, vëllait apo motrës.

“Fillimisht ka qenë vendim i babës, me të cilin nana nuk është pajtuar menjëherë

shkaku im. Ajo ka dashur që unë ta kem një vëlla apo motër, por baba nuk është bindur. Ndoshta është friku që nuk do të mundet me ia dalë njëkohësisht me familje dhe me profesionin e tij që aq shumë i donte. Mbase, mund të kishte qenë vendim “avant-garde” nga ana e tij. Ka qenë shumë i lumtur që më kanë mua. Thjesht, ka qenë planifikim i familjes..... Faktin që jam i vetmi fëmijë nuk e shoh si përfitim, por ky është fati im” thotë Alba.

**Në fund, jemi ulur në kolltukun shumë afër këndit që Alba, në banesën e saj e quan “këndi i babës”.**

**Bisedojmë për ditët e fundit të Begollit.**

“Baba ka vdekë në mënyrën më banale që është e mundur, prej alergjisë në penicilin. Kjo ishte arsyeja që truri i tij mbeti pa oksigjen përreth 25 minuta, në një ditë vere korriku në vitin 2002, mu para 17 vitesh. Ambulanca e lagjes ku e mori ineksionin nuk ka pasur kujdes në rast të reaksionit alergjik, si mungesë e profesionalizmit të tyre, bile nuk kanë pasur oksigjen e as terapi intervenuese kundër alergjisë. Ngjashëm, vetura e Ndihmës së Shpejtë e QKUK-së nuk ka pasur oksigjen, as mjete elementare për ndihmë mjekësore. Kjo krejt ishte humbje në kohë. Si pasojë e këtij gabimi fatal të institucioneve tona shëndetësore ai ka qenë 7-8 muaj në komë vigjile, dhe në acarin e 1 shkurtit të vitit 2003 ndërroi jetë në Kroaci. Asnjëherë, askush nuk e ka marrë përgjegjësinë për humbjen tragjike të tij, Ministria e Shëndetësisë e ka neglizhuar që nga ajo kohë. Shpesh mendoj që baba ka vdekë në këtë mënyrë, pasi që të gjitha rolet i ka pasë tragjike, ashtu edhe tragjikisht vdiq” përfundon Alba, derisa edhe unë edhe ajo kalojmë në emocione të përziera duke i kujtuar realitetet e bukura të kësaj familje unike dhe të dramave që pos Teatrit shpesh hynin edhe në jetën e njerëzve si Istref Begolli i ynë.



NË 14 TREGIME  
KULTURORE





Melodia e Vjetër' – Marrë nga Facebook

## Nezafete Shala dhe Grupi 'Melodia e Vjetër'

*Nga Familja Shala në 'Melodia e Vjetër', ky formacion muzikor është i bukur nga brenda e jashtë, me një ndërtim muzikor të thellë dhe me një aurë të cilën e reflekton secili anëtar i grupit, edhe në qoftëse kalon shumë pak kohë me ta.*

...



# 10

'MELODIA E VJETËR',  
KUR FAMILJA SHALA  
SHËNON HISTORI  
DHE NUK NJEH FUND

**Nën kthetrrat e një regjimi të dhunshëm jugosllav, muzika shqiptare megjithatë nuk e humbi veten dhe nuk la të degradohet ose zhduket krejt. Sepse muzika dhe zëri i njeriut e ka këtë fuqi.**

**Disa anëtarë të një familjeje për herë të parë performuan para publikut në një koncert të organizuar me rastin e pritjes së Vitit të Ri në Gjakovë, në Fabrikën 'Metalik'. Viti 1983. Ideja ishte e Faik Shalës, që të grumbullonte rreth vetes një pjesë të familjes për të kënduar së bashku. Faik Shala ishte violinisti fillimisht i shtëpisë, më pas i ahengjeve të vogla dhe më vonë i një initiative që do të përtheqohej në diçka tjetër më madhore.**

Dy vajzat e tij, Nezafetja e posedonte zërin e saj si 'armë' të fortë. Nezahatja luante në piano. Dy djemtë, Asimi dhe Njaziu e kompletuan mozaikun me mandolinë dhe i dyti me vokal e me kitarë. Familjes Shala, e cila fillimisht do të njihej si e tillë në mesin e mbrëmjeve muzikore, iu bashkua edhe Agimi si anëtar i rregullt, vokal dhe kitarë në këtë grup që nga viti 1994. Pos tij, edhe emra të tjerë.

Dhe kësisoj, edhe sot një trashëgimi e tillë e këtij grupi merr frymë.

Edhe sot familja Shala, ndonëse jo e kompletuar, jetësohet me anë të këngëve. I kanë bërë ballë kohërave më të thyera e rënduara ndër shqiptarë, po i bëjnë ballë sot edhe banalizimit muzikor. Familja Shala është shkrirë në Grupin 'Melodia e Vjetër' të cilët përkujdesen që mos ta ndalin hovin dhe dashurinë për muzikën.

## Familja Shala e ka kultivuar muzikën që nga vitet e 70-ta.

Faiku, kryefjala e tërë familjes dhe ai falë të cilit sot ky grup vazhdon të këndojë, e ushqeu në këtë familje ndjenjën e melosit popullor, folklorit, këngës qytetare dhe këngës së mirëfilltë. Restaurant “Bajram Curri” në rrugën e ish-Dubrovnikut, “Te Sylja” – rrugës për në Gërmi në Prishtinë, te Ali Dybeshi në Mëhallën e Muhaxhirëve, lokacioni “Rozafa” në kompleksin e Qafës...këto janë disa prej vendeve ku Familja Shala mbledh bashkë për të kënaqur zemrat e shqiptarëve me muzikën më të mishëruar shqipe.

Faiku kishte qenë një fotograf i famshëm, dhe si për ta mbushur tutje shpirtin e tij artistik zgjodhi krahas kësaj edhe muzikën.

“Grupi u bë bashkë dhe më pas ka kultivuar këngët e vjetra qytetare nga Shqipëria e Mesme dhe ajo e Veriut, të këngëtarëve me zë të asaj kohe si Fitnete Rexha, Hafsa Zymberi, Shyqeri Alushi, Vaçe Zela, Anita Take, Luçie Miloti, Luan Zhegu, Ibrahim Tukiçi e Bajram Spahija por edhe ka sjellë këngët e vjetra gjakovare të kompozitorëve Ymer Riza, Qamili i Vogël e Mazllom Myezini. Këngët janë interpretuar në mënyrë shumë origjinale dhe e kanë ruajtur formën, melodinë dhe tekstin”

tregon Nezafete Shala. Nezafetja sot është 64 vjeçare dhe ende vazhdon të jetë pjesëmarrësja aktive dhe zëri kryesor i grupit.

“I ndjeri Faik Shala në atë kohë e ka kultivuar në mënyrë profesionale artin e fotografisë, megjithatë muzika e zuri vendin kryesor në familjen Shala. Ai muzikën e kishte pasion, duke e parë talentin e fëmijëve me shumë vullnet dhe disiplinë filloi ushtrimet me ta, për mësimin e këngëve e melodive dhe për luajtjen në instrumentet respektive. Faiku gjithashtu ka qenë edhe anëtar i grupit të atëhershëm 'Ymer Riza' dhe më pas edhe në grupin 'Hajdar Dushi', ku ishte shumë aktiv” tregon Agim Malazogu, pjesë e grupit.

Nga Familja Shala në 'Melodia e Vjetër', ky formacion muzikor është i bukur nga brenda e jashtë, me një ndërtim muzikor të thellë dhe me një aurë të cilën e reflekton secili anëtar i grupit, edhe në qoftëse kalon shumë pak kohë me ta.

Unë, në një intervistë që e pata realizuar me grupin në vitin 2013-të, kujtoj se në një shtëpi simpatike dhe në një dhomë aromë natyre, me xhamat e hapur dhe me pastërtinë e mendjes, grupi po këndonte e performonte para meje, para shikuesit të

vetëm të shtangur. Kjo nuk ndodhë pa arsye. Të shpeshta janë herët kur grupi mirëpret mysafirët me muzikë.

---

**“Melodia e Vjetër', emri të cilin grupi e mori pas vitit 2000, ishte një zgjedhje e vetë anëtarëve të grupit.**

Grupi jo pak herë ka bashkëpunuar edhe me instrumentalistët tjerë, përpos formacionit standard. Behar Arllati në fis-harmonikë dhe profesor i muzikës në Gjakovë, Lulzim Kazazi poashtu në fis-harmonikë, Gazmend Makolli në violinë dhe Masar Spahiu në klarinet disa herë i janë bashkuar grupit që emocionin për dëgjuesin të jetë në formën më të përkryer muzikore.

“Sot, merita kryesore për grupin i takon Nezafete Shalës, e cila me zërin e saj mahnitës, ka bërë për vete publikun e gjerë e pothuajse të të gjitha moshave. Ajo veçohet për modestinë, origjinalitetin, stilin dhe zërin e saj të bukur” tregon Agimi.

Por Agimi veç sa e konfirmon madhështinë e Nezafetes.

Një grua e pak fjalëve dhe plot notave, Nezafetja ka diplomuar në Fakultetin e Arteve në Prishtinë – dega e solokëndimit dhe ka përfunduar specializimin në Zagreb.

**Nezafetja të jep ndjenjën e një pikturjeje e cila lëviz, një honepsje e lehtë që Zoti ka ditur t'i japë formën e një gruaje. E ta mendosh që Nezafetja për pak donte të linte gjithçka e të mos vazhdonte me muzikën. Mëkat, por i cili nuk ndodhi, për fatin tonë të mirë.**

“Pasi ka vdekur baba, unë nuk kam dashur të vazhdoj këndimin. Nëna ka qenë ajo e cila ka insistuar që të vazhdoj të këndoj sepse unë isha në një disponim ndryshe. Unë edhe sot nuk e konsideroj veten si pjesën kryesore të grupit, por unë gjithmonë këndoj në kujtim të babës” tregon Nezafetja, jashtëzakonisht e lidhur me Faikun- Agën, babain e saj i cili ndërroi jetë në vitin 2007.





Nezafetja sukseset i ka të kahmotshme, dhe ndonëse nuk i përmendë shpesh ato mbesin të tilla, të pakontestuara dhe pjesë e plotësimit shpirtëror të një artisteje që e kompletton një grup artistësh. Nezafetja, zëri i ëmbël në Radio Prishtinë i dha grupit emocionin e Gjakovës dhe Shqipërisë së Mesme.

Me këngën “Lule për të dashurën” Nezafetja në vitin 1983 triumfoi në asokohe Akordet e Kosovës, festivalin që mbajti gjallë shqipen. Suksesi u përsërit në vitin 1985, kur ajo prapë fitoi me këngën “Një fjalë goje, një martesë”. Këngët kanë vulën e Rahmi Ymerit dhe Nezafetes, dhe i hapën rrugë asaj dhe grupit për një karrierë e cila edhe sot nuk e sheh fundin e saj.

Njaziu, anëtar i tjetër i familjes, ka fituar dy herë në festivalin 'Revyja e Muzikës' në Gjakovë, vendin e parë me këngë emetuese shqiptare dhe vendin e parë me këngë origjinale.

Me ardhjen e viteve të 90-ta, nuk do të ishte e lehtë edhe për grupin të vazhdonte të funksiononte në mënyrën më të mirë. Familja ishte gati në skamje, Faikun e larguan nga puna ndërsa fëmijët i larguan nga Koret Profesionale ku ata bënë pjesë.

“Vështirësitë ekonomike të cilat lindën pas largimit nga puna të mijëra shqiptarëve nga regjimi serb detyruar shumë familje të punojnë profesione të ndryshme private për mbijetesë. Kjo ka qenë edhe arsyeja kryesore që familja Shala ka filluar të bëjë muzikë nëpër restorane të ndryshme, punë kjo e cila përcillej me shumë vështirësi. Njëra nga to ishte rreziku që u kanosej muziktarëve nga forcat serbe, nëse këndoheshin këngë me motive patriotike. Kjo po që ishte një sfidë nga më të vështirat” fillon e tregon Njazi Shala.

**Faiku i ndjerë i thoshte tërë familjes që çdo ardhje e mysafirëve në shtëpi duhej të shoqërohej me muzikë.**

“Baba thoshte merrni instrumentet dhe sa herë kemi mysafirë duhet me këndu. Atëherë edhe në ishim në sinkron me të dhe silleshim të gjithë më mirë se herëve tjera, meqë ishim shumë fëmijë dhe dinim të bënim problem” tregon Njaziu.

Një sfidë paraqesin pikërisht këto vite dhe një kërkesë e një familjeje nga Presheva që familja Shala t'i vizitonte dhe të performonte në një martesë.

“U nisëm për Preshevë me një veturë shumë të vjetër, të pesë anëtarët e grupit, rrugët në atë kohë ishin vështirë të

kalueshme, është dashur të kalohet nëpër rrugët malore për Gjilan e Preshevë. Ishte kohë e ftohtë, rrugët me baltë e borë dhe të pa asfaltuara dhe ishte e rrezikshme, disa herë ishim në rrezik, por arritëm në Preshevë dhe ahengu u mbajt me sukses. Morrëm shumë herë falenderime nga familja e dasmorëve” tregon Agimi.

### **Agim Malazogu, i lindur në vitin 1961, është pjesë e grupit që nga viti 1994.**

“Bashkëpunimi me anëtarët tjerë dhe me familjen Shala ka qenë shumë i lehtë. Thjeshtësia, bujaria, ngrohtësia dhe afërsia e familjes ka sjellë sukses në tërë grupin dhe kjo është dëshmia më e mirë që grupi ende funksionon i bashkuar dhe fuqishëm. Është e vertëtë që interesi i bashkon njerëzit, por në familjen Shala vlera e njeriut është mbi të gjitha” tregon Agimi.

Ndër vite, grupi ka qenë në përbërje të Faik Shalës, Nezafete e Nezahate Shalës, Asim e Njazi Shalës, Agim Malazogut dhe Lulzim Kazazit. Sot, anëtarë të rregullt të grupit janë Nezafetja, Asimi, Njaziu, Agimi dhe Lulzimi.

Muzika e grupit ka vlera të mirëfillta artistike, kultivohet muzika e pastër e cila nuk përmban elemente bastarduese që e humbin origjinalitetin. Përmbajtjet e

teksteve të këngëve janë të natyrave të ndryshme, kryesisht i dedikohen natyrës, dashurisë apo luleve, pra janë tekste me motive pozitive. Kjo muzikë është padyshim dëshmi dhe trashëgimi e kulturës sonë.

Para dy vitesh, në dokumentarin nga Fatime Kosumi dhe Vincent Moon gjejmë brenda edhe këtë grup dhe bagazhin e tyre, në mesin e të tjerë këngëtarëve që kultivuan e kultivojnë muzikën rapsodike në Kosovë.

---

Të kthehemi pak në vitet e 90'ta, përsëri. Në vitin 1992, familja sikur ra në një humnerë të pavullnetshme, të shtypur në të gjitha anët. Ishte një krizë financiare për familjen, e cila do të tejkalohet duke përdorë talentin që familja e bëri punë të përditshme, muzikën.

Familja ftohej në bufenë e Kosova Filmit, aty ku edhe mund të rimëkëmbte veten dhe muzikën e saj.

“Aty kemi nisur të vinim në vete, duke performuar e kënduar para plot intelektualëve të kohës, edhe pse në kushte të rënda shkakut edhe i orës policore serbe por edhe rrethanave në përgjithësi. Policët e Serbisë vinin por megjithatë nuk na pengonin, na thonin

'Këndoni se luftën me muzikë do ta fitoni'. Bënim muzikë edhe në orët e para të mëngjesit" tregon Nezafetja.

**Një pëlqim gati në adhurim grupi e ka pasur sidomos për Fitnete Rexhën, këngëtares e njohur shqiptare të folklorit e cila u bë shpejt inspirimi më i fuqishëm për grupin. Fitnete Rexha, në një mënyrë, po e mbante gjallë këtë grup.**

Grupi nga Gjakova ditëve të sotme ekzekuton në def, kitarë, mandolinë, tupan, tarabuk dhe në të kaluarën edhe në udi.

"Vitet ikin tutje", "S`mendoja", "Në Shkodër të vish", "Lulet e majit", plot e plot këngë tjera janë sot pjesë e repertorit të grupit.

"Sot angazhimet tona janë të shumta, netët muzikore janë të shpeshta, jemi në festivale të ndryshme që organizohen nga Ministrinë, Komuna, Muzeu, jemi edhe në rajonin e Maqedonisë, në Preshevë, në lokalet e ndryshme të qytetit. Ka plot vende e mundësi për publikun të vijë e ta shijojë muzikën tonë" tregon Nezafetja.

"Muzika të cilën sot e performojmë në krahasim me atë të viteve të mëhershme nuk ka dallime të mëdha. Jemi munduar

që ta ruajmë në maksimum origjinalitetin tonë. Tash në repertory kemi inkuadruar edhe këngë të reja të cilat janë aktuale dhe pëlqehen nga publiku i gjerë. Instrumentet janë të njëjta, të gjitha klasike" përfundon Agimi.





*Familja Shala duke performuar, fotografi e vjetër*





## Hamami i Prizrenit

*Shumë prej nesh dëshirojmë të kuptojmë se çfarë është Hamami, cili është sot Hamami dhe si u lanë e u pastruan dikur meshkujt e femrat brenda kësaj 'saune' të kohës, një banjo publike ku njerëzit relaksoheshin, pinin, djersiteshin, shkëmbejnë buzëqeshje, lodheshin pas punës e para saj. Për këtë trashëgimi flasim njerëzit e fushave të ndryshme dhe qytetarë të cilët kanë mall për një Hamam të hapur e të qasshëm për të gjithë.*



## HAMAMI I PRIZRENIT, HISTORIA DHE MONUMENTI QË NUK DUHET MBYLLUR ME ÇELËS

Po shkove në Prizren, duhet ta vizitosh patjetër Hamamin e Prizrenit. Edhe po nuk e pate plan, nisu.

Kjo vetëm nëse ke fat që Hamamin ta gjesh me dyert hapur, ose nëse ke mundësi të marrësh çelësat prej personave të cilët i posedojnë. Në të kundërtën, udhëtimi në Prizren do të bëhet pa një vizitë në Hamamin e Gazi Mehmed Pashës, një monument i bukur nga brenda e jashtë që meriton më shumë vëmendje.

Hamami i Gazi Mehmed Pashës gjendet në qendër të qytetit në Prizren, pranë Xhamisë së Kukli-Mehmed Beut dhe Xhamisë së Emin Pashës. Është ndërtuar në vitin 1563-74, nga Gazi Mehmed Pasha, Sanxhakbej i Shkodrës më 1573-74.

Në portën kryesore është vendosur pllaka me mbishkrimin (1833) – e cila tregon datën e restaurimit të Hamamit nga ana e vëllezërve Tahir dhe Mehmed Pashë Rrotulli.<sup>1</sup>

Ta lëmë retrospektivën, që t'i kthehemi më vonë.

I afrohesha afër këtij Hamami, i sillesh përreth, është i bukur dhe estetikisht të relakson. Ndoshta të bëhet e pamundur hyrja në oborrin e Hamamit, e më pas edhe në brendësi, dhe kjo të bën të ndihesh keq. Është e tmerrshme se si ky Hamam sot nuk gjen një përdorim dhe destinim të ditëpërditshëm. Unë shkoj vet dhe nuk mund të hyj brenda, njëjtë sikur edhe ndonjë turist i rastësishëm në Prizren që dëshiron ta përjetojë emocionin e

<sup>1</sup>[https://dtk.rks-gov.net/tkk\\_objekti.aspx?id=1571](https://dtk.rks-gov.net/tkk_objekti.aspx?id=1571)





Fotografia: ORTK Prizren

brendësisë së Hamamit. Shumë prej nesh dëshirojnë të kuptojnë se çfarë është Hamami, cili është sot Hamami dhe si u lanë e u pastruan dikur meshkujt e femrat brenda kësaj 'saune' të kohës, një banjo publike ku njerëzit relaksoheshin, pinin, djersiteshin, shkëmbenin buzëqeshje, lodheshin pas punës e para saj.


Edi Gashi, një djalë i ri i cili ka jetuar pjesën më të madhe të jetës së tij në Prizren, ka një lidhje të veçantë me objektin që nuk i ikë syrit të atij e asaj që e viziton Prizrenin. “Si fëmijë gjithmonë e kam pasë andërr me hy brenda edhe me eksploru çka fshehë ai objekt i madh e misterioz në mes të qytetit por fatkeqësisht nuk ka qenë i qasshëm ose të paktën nuk ka pasë ngjarje në të cilat unë mund të merrja pjesë si fëmijë. E tash, në këtë moshë duke qenë i vetëdijshëm për vlerat historike e kulturore që i ka Hamami i

Prizrenit dhe faktin që organizimet e vetme që ndodhin në të janë ato kulturore, ai gjithmonë më asocion me artin, me diçka të re e të bukur” tregon Edi.

Hamami i Prizrenit është i llojit “çifte hamam” që është përdorur nga të dy gjinitë në të njëjtën kohë.

Pjesa e hamamit për meshkuj është pak më e madhe se pjesa për femra. Hamami i ka të gjitha hapësirat që kanë hamamet e këtij lloji, pra përbëhet prej pjesës hyrëse; pjesa për pritje si dhe për pije, pjesa për garderobë, pjesa qendrore ku bëhej larja, djersitja, dëfrimi si dhe pjesa e kaldatores që gjendet në pjesën jugore të objektit. Hamami është ndërtuar nga gurë të ndryshëm në kombinim me tulla, sipas të dhënave të Databazës së Trashëgimisë Kulturore të Kosovës e Ministrisë së Kulturës së Republikës së Kosovës.





**Ramadani, një burrë rreth të 70-tave, i sillet përreth Hamamit të Prizrenit derisa nuk e di as vetë me siguri se çfarë mendon kur e sheh këtë objekt, në një të shtune prizrenase.**

“E mbaj mend shumë moti, dikur ka qenë ma i hapun se tash. Viteve të fundit jam plakë dhe nuk sillem fort larg shtëpisë. E kam shtëpinë afër Hamamit, as 5 minuta larg. Vij këtu, qef kom me u ulë dikah me pushu, oborrin e kanë të mirë. Po çka ndodhë mrena, a jashtë, kurrë se di” tregon Ramadani.

Hamamet gjatë Perandorisë Osmane kanë luajtur një rol të rëndësishëm.

Në aspektin arkitektonik, ka qenë si pjesë e pandashme e zonës urbane. Gjithmonë gjatë konstruktimit të një qyteti në Perandorinë Osmane, hamami ka qenë një prej objekteve kryesore të bërthamës së qytetit, duke përfshirë xhaminë, shkollamejtepën, medresenë, bibliotekën, imaretin-kuzhinën popullore, haninbujtinën, shatërvanin, dyqanet, pazarin e spitalin.

Kështu na tregon Valon Shkodra, hulumtues i pavarur shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës.

Valoni tregon se gjatë pastrimit në Hamam dhe Hamamxhik, për mbathje i kanë përdorur nallanet të cilat kanë qenë të punuara nga druri me zbukurime të sedefit që është i ardhur nga vendet e tjera. Nallanet kanë qenë të dekoruara edhe me filigran. Dekorime të këtilla kanë treguar për statusin social të kohës, sidomos te gjinia femërore.

**“Hamami apo banjoja osmane ka zënë një vend të veçantë në jetën shoqërore, ka pasur rolin e higjienës dhe pastërtisë në jetën e përditshme të qytetarëve – kjo është lidhë edhe me fenë islame ku pastërtia është primare. Ka qenë i hapur çdo ditë, ka pasur mbikëqyrje të punonjësve, larja e trupit është bërë me sapun, hyrja ka qenë me pagesë. Edhe sot kujtohen disa fjalë që lidhen me hamamin si p.sh “nuk nxehet hamami me fjalë po me pare”, “e paske ba dhomën nxet si hamam me kon”, “shko në ham” e të tjera” thotë Valon Shkodra.**

Sot, muret e Hamamit të Prizrenit të bukur kanë një trashësi rreth 90 cm, të suvatuara nga ana e brendshme.

Pullazi i objektit ka dy kupola të ndërtuara mbi tambure, në pjesën e ftohtë (pritja) dhe nëntë kupola të vogla që janë mbi

pjesën e ngrohtë të Hamamit. Deri në vitet 1964 Hamami ka qenë i rrethuar me lokale me ç’rast bëhet rrënimi i lokaleve dhe fillojnë punët restauruese-konservuese.

E prej vitit 2000, Hamami hapet vetëm për ngjarje të ndryshme kulturore dhe artistike, me pjesën tjetër të kohës i mbyllur në tërësi. Kjo po i pengon jo vetëm një pale, por goxha disa të tillave.

Florina Jerliu, profesoreshë e arkitekturës në Universitetin e Prishtinës, tregon se Hamami i Prizrenit njëjtë sikur edhe Hamamet tjera në Kosovë – mendohet të jenë gjashtë të tilla, nuk e ka ruajtur destinimin praparak por as nuk ka gjetur një destinim tjetër.

“Gjeneratat e reja sot por edhe gjeneratat e mesme nuk e kanë idenë se si ka funksionuar Hamami dhe çka ka ndodhur aty. Krejt çka dimë është se kush e ka ndërtuar dhe kur është ndërtuar, plus ndërhyrjet dhe renovimet që kanë ndodhur. E mos të harrojmë që këto Hamame janë copëza të rëndësishme të kujtesës, derisa ne po përpiqemi me e kriju një narrativ i cili është përçundu dhe tjetërsu në shumicën e rasteve në kohën e komunizmit” tregon Jerliu, e cila edhe ka marrë çmim për veprën e saj shkencore “Trashëgimia kulturore e Kosovës – konceptet dhe kontekstet e mbrojtjes”.

“Nuk është mbrojtje nëse një objekt futet në çelës, dhe shembulli më i mirë ilustrues për këtë është Hamami i Prizrenit. Është mbrojtje e një objekti kur nuk e ke vdekur, kur është trashëgimi që jeton, dhe Hamami ka qenë i tillë. Duhet ta kuptojmë se sa më rrallë ndodhin ngjarje aty, aq më rrallë edhe njerëzit do të shkojnë te Hamami, sepse asgjë më nuk i dërgon deri atje. Sot njerëzit shkojnë në Turqi ta përcjetojnë Hamamin si tërësi, kur diçka e tillë do të mund të bëhej edhe këtu” tregon Florina Jerliu.



## Ja çka na tregon Nora Arapi

Ekziston një tregim (legjendë) që lidhet me ndërtimin e Hamamit si rrjedhojë e një “bisede” mes Gazi Mehmed Pashës dhe një punëtori, gjatë ndërtimit të xhamisë së vet. Për shkak të “papastërtisë” (xhunub) të këtij punëtori që ka refuzuar të punojë në ndërtimin e xhamisë, Mehmed Pasha i ndërprente punimet e xhamisë dhe urdhëron ndërtimin e Hamamit.

'Duke qenë i vendosur në qendër të qytetit, në një pozicion të volitshëm, Hamami është njëra prej pikave referente për vizitorët e Prizrenit, qoftë për turistët e zakonshëm por edhe për studentët dhe studiuesit që e vizitojnë Prizrenin. Hamami padyshim e begaton mozaikun e monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe e bën më të dëshirueshëm dhe të larmishëm qytetin e Prizrenit për turistët” tregon Nora Arapi – arkitekte konservatore në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren.

“Secila përvojë e imja në hapësirën e Hamamit ka qenë e ndryshme dhe më e bukur se tjetra. Aty janë ekspozuar vepra prej më të ndryshmeve të artistëve vendorë e botërorë, evente të karaktereve të ndryshme, kanë qenë momente në të cilat jam ballafaqu me krijimin dhe të bukurën. Secilën herë kam dalë prej aty i mahnitun e

me ndjesi të çuditshme të bukura”, në anën tjetër thotë Edi Gashi.

Në këtë Hamam ndër vite kanë ndodhur plot ngjarje të cilat megjithatë e kanë sjellë në jetë Hamamin dhe mishërimin brenda tij.

Në dhjetor të vitit 2017-të, Kori “Nexhmije Pagarusha” vallëzoi bashkë me fëmijët me Sindromin Daun në këtë monument.

Festivali DokuFest, një tjetër arsye për të udhëtuar drejt Prizrenit veror, gati çdo vit organizon ngjarje dhe debate të ndryshme brenda hapësirave të këtij Hamami. Në vitin 2018-të, artisti Arbnor Morina brenda Hamamit hapi ekspozitën e tij personale e cila pati edhe vizita nga grupe të ndryshme prej Gjermanisë, Ukrainës, Irlandës, Bosnjës, Serbisë, Malit të Zi e Maqedonisë.

Katër vajzat e kolektivit artistik HAVEIT, në gusht të vitit 2017-të performuan brenda Hamamit në kuadër të edicionit të parë të Autostrada Biennale.

Pra janë 1001 arsye që ky Hamam të mos mbyllet, të mbetet i hapur, meqë renditet si një prej atraksioneve kryesore turistike në Kosovë.

“Ky hamam dikur ka qenë shumë i njohur së bashku me hamamin e Shkupit dhe të Sarajevës” tregon Valon Shkodra.



“Hamami ka pasur shumë dimensione, përpos atij utilitar, ka pasur edhe dimensionin fantastik publik. Hamami ka qenë hapësirë publike – si qendër kulturore dhe e vetmja mënyrë e largimit prej përditshmërisë, madje edhe për gratë të cilat nuk kanë dalë në kafe në çarshi, por janë socializuar në hamam. Aty ka qenë vendi ku ti del dhe relaksohesh, një hapësirë sociale jashtëzakonisht e rastësishme, ekuivalente madje edhe me klubet e lordëve të Londrës. Sot në Kosovë ke dyqane të vogla për estetikë por nuk e ke asnjë hapësirë të tipit të Hamamit, edhe pse e ke infrastrukturën për një shërbim të tillë. Së paku kishte qenë mirë sot me e përjetu ceremoninë e hamamit të vërtetë” na shpjegon Florina Jerliu.

Veron Tara, arkitekt i cili merret me restaurime të trashëgimisë kulturore ndërtimore, anëtar i Këshillit të Trashëgimisë Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit dhe qershia mbi tortë – qytetar i Prizrenit, tregon se është në shpirtin e secilit në Prizren që ky Hamam të jetë më i hapur, më i qasshëm. Me Veronin duam të futemi brenda në Hamam por në një të shtunë kjo nuk na lejohet. Flasim pa e përjetuar në mishin tonë, Hamamin.

“Ende nuk e ka marrë statusin si muze sepse në këtë rast do të duheshin zyre,

administratë, banjo. Nëse e bon Muze, duhesh me ditë çka me ekspozu. Në këtë Hamam duhen me qenë dy persona që e mbajnë hapur çdo ditë, sepse Hamami është kudo nëpër broshura dhe turistët zhgënjehen kur vijnë këtu dhe nuk mund të futen në Hamam. Është njëjtë si me shku në Kullën e Ajfellit dhe me e gjetë të mbyllur” na shpjegon Veroni.

Veroni propozon që kjo hapësirë të kthehet në një librari, në një muze, në bibliotekë, në një institut, në një vend që ka funksion ashtu siç ka ndodhur me ridestininimin e shumë hapësirave simotra të kësaj nëpër botë. Një shërbim kafeje për turistët, në oborrin e Hamamit, në një kënd diku afër do të ishte ide e mirë.



**Duke lënë anash rëndësinë e këtij objekti, në pjesën e punimeve e restaurimeve brenda tij ekziston një dramë.**

Projekti i restaurimit të Hamamit është hartuar nga ekipi i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturorë në Prizren ku kanë qenë të përfshirë edhe ekspertë ndërkombëtarë të fushës së tipologjisë së ndërtimeve publike nga Periudha Osmane. Ky projekt ka filluar të implementohet në disa faza, ku fillimisht me financim të UNESCO - zyra regjionale për Ballkan, janë kryer ndërhyrjet restauruese në pjesën e kupolave dhe kulmit. Gjatë kësaj faze është bërë edhe rindërtimi i disa kupolave të cilat kanë qenë në gjendje shumë të keqe fizike.

Këto kupola janë suvatuar nga jashtë me rekomandim të ekspertit ndërkombëtar të kyçur në projekt, me materiale kompatible me teknikën tradicionale të ndërtimit.

Ndërhyrjet restauruese në muret e jashtme dhe vendosja e xhamave në kupola janë financuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Këto na i tregon Nora Arapi.

Valon Xhabali nga Ec Ma Ndryshe thotë se institucionet përgjegjëse qendrore e lokale duhet ta vendosin në prioritet finalizimin e punimeve.

“Në vitin 2015 është hartuar plani i menaxhimit për Hamamin mirëpo prej asaj kohe nuk ka filluar së zbatuari prandaj duke pasur parasysh që ka kaluar një kohë e gjatë mendojmë që duhet të rishikohet/rishkruhet (nëse ka nevojë) ky plan dhe të fillojë së zbatuari sepse duke zbatuar planin e menaxhimit edhe monumentit, Hamami i Gazi Mehmed Pashës në Prizren funksionalizohet në mënyrën e duhur” thotë Xhabali.

“Në këtë periudhë mund të themi që Hamami është në gjendje të mire ku rreziku nga dëmtimet atmosferike është mënjanuar. Edhe në aspektin statik, muret, kupolat dhe kulmi janë rehabilituar dhe janë të qëndrueshme. Për të përfunduar punimet, nevojitet të implementohen edhe ndërhyrjet në enterier dhe oborr të ndërtesës. Finalizimi i punimeve, me mjetet që do të ndahen nga MKRS do të mundësojë funksionalizimin e plotë të këtij monumenti” thotë Nora Arapi nga QRTK Prizren.

Nuk guxohet as të mendohet se drama e restaurimeve dhe vonesave mund të ketë një episod tjetër të papritur.

“Nëse prishet Hamami, njerëzit kanë me u ndi keq sepse është pikë reference – ku je? Jam te Hamami. Kisha e xhamia ke me



bollëk kudo, por hamamet janë më të rralla sepse janë ndërtu në qytete në tranzicion dhe qytete si pika qendrore, e Prizreni dihet që ka qenë i tillë. Për mua, po të prishet Hamami shkatërrohet një kulturë e tërë” përfundon Veron Tara.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në anën tjetër, para pak javësh ka nënshkruar 10 memorandume me Komunën e Prizrenit në vlerë totale prej 3 milion e 670 mijë euro.<sup>2</sup> Në mesin e projekteve kulturore ku do të investohet nuk

figuron një ndihmë për këtë Hamam.

**Deri në hapin tjetër institucional, mbetet të eksplorojmë historinë e të kujtojmë se si janë pastruar e larë njerëzit në të gjitha këto hamame, prej atij në Prishtinë e deri te ky në Prizren.<sup>3</sup> Ndoshta do të na duhet më shumë pastrim edhe neve sot, njerëzve të këtij shekulli, për qetësinë dhe bardhësinë e trupave e shpirtrave njerëzorë, edhe jashtë hamameve.**



<sup>2</sup><https://www.mkrs-ks.org/?page=1,6,2063#.XPYyH8gzblU>

<sup>3</sup><https://www.kultplus.com/trashegimia/kur-kishte-kenaqesi-e-lahej-ne-hamamin-e-madh-te-prishtines-foto/>





## Shaqir Hoti

*“Unë jam i bindur se këto instrumente me të cilat sot punoj, si fëmijë janë ngulltë thellë në turin tim, dhe çdo gjë që në mendje ngulitet gjatë fëmijërisë është vështirë të shlyhet. Unë gjithmonë instrumentet i kam pasur afër, si fëmijë kam luajtur në to por nuk kam ditur t'i punoj”*

♦ ♦ ♦





## SHAQIR HOTI

BURRI I CILI KRIJON PREJ AVOKADOS,  
ARRAVE E BRIRIT TË LOPËS

Një djalë i vogël i rritur në Has, afër Drinit. Djali i Xheladinit u rrit shumë afër ujit e natyrës, gjithmonë me dashuri për gjuetinë e peshkut.

I vogël, po i njëjti djalë njomak do të niste të mësonte lojën në instrumente, pikërisht prej Xheladinit – ky një instrumentist jo i shkolluar. Emri i djalit të vogël është Shaqir, Shaqir Hoti, sot një burrë 85 vjeçar i cili në studion e tij të punës në Prishtinë nuk mund të ulet.

“Rrijmë në këmbë, është sëmundje profesionale” thotë Shaqiri derisa unë bisedoj me të në një hapësirë të vogël por të rahatshme të punës.

Sot, pak kush nuk e njeh plakun e bardhë Shaqir Hoti.

“Unë jam i bindur se këto instrumente me të cilat sot punoj, si fëmijë janë ngulitë thellë në trurin tim, dhe çdo gjë që ngulitet në fëmijëri është vështirë të shlyhet. Unë gjithmonë instrumentet i kam pasur afër, si fëmijë kam luajtur në to por nuk kam ditur t'i punoj” tregon axha Shaqir, siç më pëlqen ta thërras.



*Ansambli Azem Bejta, vitet 1970-ta. Nga majtas: Shaqir Hoti, Bajram Firmoku, Rizah Spanca dhe Abdurrahman Svirca*

## **Jo vetëm lojë në instrumente, por edhe studim dhe intervenim në tingullin e tyre**

Sot, ata njerëz të cilët e duan folklorin e instrumentet shqiptare, e njohin mirë Shaqir Hotin. Hoti, i cili ka përfunduar shkollën fillore në vendlindje, më pas shkoi në Prizren për të regjistruar shkollën e mesme të muzikës.

“Gjenerata ime komplet i kemi taku një terri të plotë informativ, dhe ishim fort të uritur për dije. Semimaturën apo tetë vjeçaren e përfundova dhe mezi pritsha me shku dikah me u regjistru. As edhe një katërshe nuk e kam pasë, krejt pesëshe. Shumë arsimtarë më thojshin - shko në normale, disa në gjimnaz, por atëkohë u hap shkolla e muzikës. Vullneti për dije ishte i madh. Bashkë me një shokun tim çdo ditë kemi bo 50 kilometra, 25 ardhje e 25 vajtje, derisa nisi bora e madhe, prej Rugovës në Prizren kemi udhëtu, ruga atëherë ishte ma lakore se tash. Edhe atëherë instrumentet gjithmonë i kam pasë nëpër dorë, edhe pse kemi ushtrru tinëz sepse pa partitura nuk lejohej kurgjo” tregon Hoti. Ai sot luan në instrumente, punon me to, i krijon ato, i studion ato, duket sikur edhe flet me këto instrumente. Qetësinë shpirtërore thotë se e gjen duke punuar me instrumente, kënaqet i tëri sidomos kur dëgjon tingujt e parë të një instrumenti.

Kurrfarë pushimi tjetër më të dëlirshëm nuk gjen Shaqiri sesa në instrumente, se në ambientin e vogël poshtë shtëpisë së tij, aty prej nga ai punon me fyell, me kavall, me okarina, me pipëza, me gajde, me zumare, me instrumentet tjera.

Janë mbi 1500 instrumente në këtë hapësirë, prej të cilave Shaqir Hoti thotë se nuk është ndarë asnjëherë, në asnjë peripeci të jetës.

“Këtyre instrumenteve kurrë s'ju kam nda, edhe gjatë obligimeve tjera, edhe kur kam punu në arsim apo në Radio Prishtinë. Në Radio kam qenë në Orkestrën Popullore – si flautist, dhe isha ndër të parët si flautist. Aty kam punu deri në masat e dhunshme. Krahas krejt obligimeve tjera, instrumentin tradicional nuk e kam hekë nga dora, jam mundu me e rujt. Kam dashtë gjithmonë me lujt bukur në instrumente duke e shfrytëzu burimin dhe melosin burimor. Kam intervenu edhe vetë në instrumente, në temperim, në tingull të duhur, hapsha e mbyllsha vrima deri vijsha tek niveli i lartësisë. Gjithmonë kam mendu kësisoj, që nëse kam jetë më të gjatë në pension nuk do të jem një pensionist i zakonshëm. Drejt me thanë, më dhimben nëse këto instrumente i lojmë në harresë sepse kanë qenë shumë shekuj në këto treva” tregon Hoti.

Biseda përcillet me luajtje në instrumente, dhe në ndoshta bëhem i bezdisshëm duke i kërkuar axhës Shaqir që të luajë enkas për mua. Megjithatë, ai e lë shpirtin e tij në secilën lojë që i bën instrumenteve derisa e nxjerrë nga i njëjti shpirt edhe rrëfimin e tetë dekadave jetë.

Rrethohet prej fyellit të shokës/brezit, të cilin e ka shumë për zemër. Më larg qëndrojnë gajdet, të cilat i ka krijuar vetë prej shtofit dhe të cilat tash e 19 vite kanë ruajtur formën e tyre të mrekullueshme. Pipëzat nuk i ka larg, por as edhe instrumentet e vogla që janë krijuar prej arrave, bërthamës së avokados dhe birit të lopës. Shaqiri jonë, çkado që gjen në natyrë provon ta kthejë në instrument.

“Fyelli i shokës dallon pak, dhe quhet kësisoj pasi bariu e ka futë në brez pasi ka luajtë në të. Edhe për nga struktura dhe punimi është i thjeshtë, hapen gjashtë vrima dhe pjesa lart. Si diapazon ka dy oktava, pra është i fuqishëm, ndërsa bashkë me zërin e fyellit dëgjohet edhe fryma e njeriut. Fyelli i madh apo kavalli, në turqisht e përdorin edhe çoban-kavall edhe një lloj tjetër që thirret nej, edhe atë e dua fort. Jam gjithmonë në hulumtime të timbrit, temperimit, të avancimit, aty ku e shoh që një instrument mundet me ecë përpara” tregon Shaqir Hoti.







### **Tregim jete i ndarë në copëza të bukura mbushur plot melos popullor**

Hoti i quan instrumentet si fatin e tij të mirë. Edhe jeta e tij është një tregim me fat.

“Në shkollë të mesme, drejtori ka qenë shqiptar - Lorenc Antoni. Atëherë as Prishtina dhe as Nishi nuk kanë pasur shkollë të muzikës. Lorenci më tha se kam vesh absolut dhe u bëra nxënës i tij në violonçelo. Deri në gjysmëvjetorin e dytë isha fort i mirë, aty përparova shumë.

Rastësisht e dëgjoj një djalë malazez duke luajtur në flautë, i cili po bëhej gati për ushtrime në klasë. I thashë të ma jepte pak instrumentin sepse se kisha pa me sy më parë këtë instrument. Tingujt i ngjasonin kavallit. E morra dhe e luajta një melodi tonën baritore – aty del profesori dhe më zuri me instrument në dorë. Shkojmë bashkë te drejtori dhe aty profesori i tha drejtorit që të bëhesha flautist. Lorenci refuzoi por më vonë pranoi sepse ai po largohej për të punuar në Radio Prishtinë. Kishim pak literaturë, por huazonim sidomos prej violinës. Prej aty u

ktheva në fshat” tregon Shaqiri. Kthehet në fshat që të kontribuonte. Shtatë vite pas shkollës së mesme ai qëndron në fshat derisa vjen në Prishtinë në vitin 1967.

“Bile kom pritë shumë, sepse mu dhimbshin ata fëmijë atje me i braktisë. Vij në Prishtinë, asokohe Rexhai Surroi ka qenë drejtor i Radio Prishtinës dhe ma nënshkroi vendimin e përhershëm si pjesë e formacionit të Orkestrit Popullor” vazhdon Hoti.

“Në orkestër e gjej drejtues Rexho Mulliqin. Ai e donte shumë instrumentin tradicional, herë herë e fuste në orkestrime të këngëve por edhe nëpër turne kur shkonim, gjithsesi diçka nga këto instrumente i kemi marrë me vete; fyellin, okarinën, kavallin...”

## **Berlin 1969**

Punësoria e tij është një punëtori e veçantë në të gjitha trevat shqiptare. Ka plot njerëz që punojnë instrumente, por Shaqir Hoti është ndër të paktët që e njeh instrumentin organikisht, njeh tingull për tingull. Madje ai i ka të shkruar për secilin instrument veç e veç mundësitë teknike të interpretimit, mënyrën e punimit, si të dalë tingulli.

I kanë premtuar se do t'ia botojnë këto shënime diku, njëjtë siç edhe i kanë premtuar se kjo punëtori do të mund të ishte pjesë e Muzeut. Deri sot, ai vetë thotë – “Premtimet kanë mbetë si zhag”. Në njërin qosh të punëtorisë, një fotografi e vjetër bën dritë, Shaqir Hoti shihet sikur duke pirë cigare. “Veç osht grrithë letra, nuk jam me cigare” tregon Shaqiri buzagaz.

Në fotografi janë shtatë persona, mes tyre Shaqir Hoti dhe Nexhmije Pagarusha. Nexhmija është e vetmja grua, dy meshkuj të tjerë janë nga Serbia. Të gjithë janë me tesha kombëtare, në Berlin të Gjermanisë, në një festival ku ata morrën vendin e parë. Shaqir Hoti thotë se kurrë askush nuk ka shkruar për atë fitore.

“Në festival në vitin 1969 e përfaqësuam Jugosllavinë. Shkuam aty dhe ne ishim formacion me shtatë veta, gjashtë krymba, ndërsa shtetet tjera ishin me orkestër të madhe e me revyja simfonike me 100 e kusur veta. Në prova gjenerale dolëm si pula e lagt. Kangën e parë –“Bijnë tupanat në katër anët” e këndon Nexhmija e unë isha me çifteli, reagimi ishte i shkëlqyeshëm. Kanga e dytë –“Sytë për ty i kam të njomë” bukur mirë u nxe publiku, ndërsa te kanga e tretë – “Baresha” ku unë isha shoqëruar në flautë, Nexhmija u

detyrua me u kthy në skenë disa herë. Fituam në festival. Të nesërmen vijnë Ambasada Gjermane dhe ajo Jugosllave e na urojnë për këtë sukses. Kthehemi në Kosovë bukur krenarë që e nxunëm vendin e parë, gazetat gjermane me 2 faqe të plota për atë rast, me Nexhmijen edhe veshjen kombëtare. Kanë kalu 50 vjet e kusur dhe kërkush asnjë gërmë se ka shkru për atë koncert”.

Këngën “Baresha”, Hoti e ka përcjellur me flautë në versionin e saj origjinal.

“Rexha e ka ba melodinë, partiturën, aranzhimin, orkestrimin, ka nejtë derisa osht finalizu kanga, nuk ja ka da, tekstin e ka bo Rifat Kukaj. Bile, janë msheleë dytë në banesë edhe deri e kanë kry kangën s'janë dal prej qatytit” tregon Hoti.



*Bilbili Nexhmije Pagarusha dhe emrat: Zef Tupeci, Shaqir Hoti, Isak Muqolli, Kolë Bala dhe Velko Vojnovic para Sender Freies Berlin*

### **“E vërejta se gajdet po zhdukeshin, nuk dëgjoreshin kurrkund fare”**

Tregim që nuk ka të mbaruar, burrë që nuk njuh lodhje, me misionin e tij të vetëm në jetë nxjerrjen e instrumenteve shqiptare nga terri i lashtësisë, drejt dashurisë për tënden, për autentiken, për zanafillën, për muzikën burimore e folklorin.

Sikur gishtat e dorës, secili me veçantinë e tij, kësisoj janë edhe instrumentet në të cilat axha Shaqir punon e luan. Prej pipëzës, një instrument i vogël që punohet prej kashtës dhe degës së shtogut e kaçës, jetëshkurtër, deri te kavalli e bishtnicat-gajdet, ky njeri i 84 vjeshtave e dimrave ka ende shumë energji dhe dashuri.

“Sidomos me gajdet, e vërejta që ky instrument nuk dëgjohej kurrkund fare. Fillimisht gajdet i futa në orkestrimin e një prej këngëve të Shyhrete Behlulit, dhe nga ajo instrumenti thajse është gjallë” tregon Shaqiri. Njëra gajde, më e moçme, është prej lëkurës së qengjit e kecit, së cilës i duhet qumështi për ta mbajtur të njomë e të botë.

“Unë bëra çmos që t'i avancoj gajdet. E kam këtu njërën me shtof e cila mrena ka kese të madhe të najllanit. Që 19 vite e



testoj dhe asnjëherë nuk ka problem, nuk i vjen era e keqe, as s'don ly as s'don ngjy". Dhe unë e gjej në punëtori këtë njeri me zemër të mirë, duke punar pikërisht një pjesë të gajdeve.

"Gjithmonë kam dashur ta preki instrumentin, mos ta dëmtoj. Tek gajdet gjithmonë ka qenë problem pëlqesa apo burdani, në jug i thonë iso – tingujt e barabartë. Arrihej unisoni i plotë i tingujve por shpesh humbte. Unë me anë të një unaze në gajdet e mia e kam anashkalu këtë problem" tregon Shaqiri.

### **Kjo dashuri e pashterrur për okarinën, pa lënë anash edhe instrumentet tjera**



Okarinën e ka shumë për zemër. Ka disa okarina të shpërndara në këtë hapësirë të vogël ku punon Shaqiri, por secila prej tyre përbën një copëz të zemrës.

"Viteve të fundit jam angazhu shumë me okarinën origjinale e cila osht gjetë në Runik afër Skenderajt. U gjetën asokohe shumë objekte, e unë shkova sepse dëgjova për okarinën. Isha i interesum me e pasë instrumentin frymor. Pas disa kohe doli në Muze dhe u ekspozua, por nuk mundej me u hapë përpos me kërkesë zyrtare. Kështu okarina kurrë nuk ra në dorën teme. Pas luftës erdha me gëzim që do ta gjejmë okarinën e do ta preki, por ajo ishte zhdukur bashkë me qindra artefakte tjera, për fatin e të cilave nuk dihet. Edi Shukriu më dha informata të shkëlqyeshme dhe ma përshkroi këtë okarinë, pasi ajo e pati në dorë, unë isha me dy mendje a ishte ma e shtypur apo cilindrike. Doli të jetë krejt cilindrike. Mi dha krejt masat e saj, me fotografinë origjinale të instrumentit" e fillon tregimin e okarinës Shaqir Hoti.

"Pjesa ma e gjatë ishte 8 centimetra, pjesa e gjerë 6 centimetra. Vrimat poshtë nuk i ka bash drejtë. Unë e kopjova më pas. Isha gjithmonë në dyshime a ka qenë instrument ritual a paramuzikor, dhe pas një kohe bukur të gjatë të hulumtimit e

vëreja se ky instrument ka një tingull të msheftë, prandaj më nuk do ta quaj instrument paramuzikor por instrumental, sepse i ka tingujt e vet”

“Jam i sigurtë se secili instrument në vete ka mesazhin e tij, njëjtë edhe vegëlpunuesi i saj. Shembull, tek okarina janë 12 viza në pjesën horizontale, ndërsa vertikalisht janë 7. Pra 7 me 12. 7 në mitologji ka pasë shumë rëndësi, për 7 ditë është krijuar bota, 7 male, 7 kodra, pra kush e ka krijuar ka dashur të thotë diçka me të” tregon Shaqiri.

Edhe ai vetë, në çdo instrument e gdhendë emrin e tij. Në një fotografi dhuratë prej miqve të tij nga Italia, në të katër anët e fotografisë ai ka krijuar instrument, katër fyella të ndryshëm. Krijon në dru, instrumente në formë shqiponje, në formë të ndonjë shpendi. Një okarinë e bukur e bardhë është krijuar në lajthi, një tjetër në vezën e makushit e strucit.

Një fyell, duke e krijuar i dha zor shumë, e dëmtoi në njëfarë mënyre. Poshtë fyellit e shkroi: Në duart e kqija prishet, dështon, humb!

Për fund, e pyes axhën Shaqir se cili është mesazhi i tij për rininë, për njerëzit të cilët i

duan instrumentet dhe muzikën e bukur. “Kërkush nuk po ngan të punojë me këto instrumente, ti bëjë për vete. Çdo popull e ruan me xheloz instrumentin e traditës. Kemi pas bo kërkesë me e hapë një shkollë për këto instrumente apo kjo të jetë si një lëndë mësimore në shkollë të muzikës. Edhe këtu para premtime por jo realizime” sqaron axha Shaqë.

Vazhdon të kalojë kohën e tij në punëtori, krejt kohën në eksperimente, me okarinë nga argjila e dheu. Verës del rreth liqejve, edhe nëpër mal. Asnjëherë nuk punon në vetëm një instrument, herë shkon tek njëri e herë tek tjetri.

**“Kam përkrahje edhe sot, edhe gjithmonë kam pasur, prej familjes. Djemtë nuk u angazhuan në këtë drejtim sepse të punosh një fyell për treg – më mirë është me ja bo një argat dreqit. Nuk vlerësohet. Shpesh ndoshta një instrument t'i merr 2 ditë kohë për me u shitë për 2-3 euro. Si instrument bjen poshtë rëndësia, jo mundi i personit. Diaspora është e interesuar me i ble këto instrumente, më shumë” tregon Hoti.**



**NË14**  
**TREGIME**  
**KULTURORE**



*“O zot, im zot  
kah po e shoh këtë lule  
në të cilën vdekja dhe jeta  
shëtisin dorë për dorë  
duke i kënduar oda ujit  
më është e qartë  
se duhet jetuar  
dhe duhet parë këtë mrekulli”.*

■ ■ ■ ————— ■ ■ ■  
**Mirko Gashi**



## VAJZA E MIRKO GASHIT: BABAI DILTE ME PALLTO NGA SHTËPIA DHE KTHEHEJ PA TË!

Zora Gashi Kurti dhe Mirko Gashi kanë shumë të përbashkëta. E para është bija e të dytit, ndërsa i dyti ishte një baba i pazakonshëm për të parën.

“Mirko Gashi nuk ishte njeri i zakonshëm, e poashtu edhe si baba nuk ishte i zakonshëm. Ishte i gatshëm t'i jepte gjithkujt gjithçka, madje ka pasur rast që ka dalë nga shtëpia me pallto dhe është kthyer pa të! Përveç nga ai, si bijë e tija kisha mundësi t'i takoj edhe miqtë e tij dhe të mësoj shumë nga miqtë! I veçoj takimet me Ali Podrimën, Rifat Kukajn, Anton Pashkun e posaçërisht takimin me Ismail Kadarenë në Prishtinë”.

Zora, vajza e Mirko Gashit, ka vendosur të na tregojë pak për shkrimtarin e njohur kosovar. Kush i do vargjet e bukura, nuk e

ka lënë në harresën e tabullarasë Mirko Gashin. Mirko lindi në Kralëvë në vitin 1939, i biri i atdhetarit Mark Gashi. Para se ta kuptonte se qenia e tij bën gjumin më të mirë në letërsi, Mirko do të punonte si gazetar e mësues, në Preshevë e më pas në Prishtinë, në Teatrin e Kombësive në Shkup, në Teatrin Popullor të Prishtinës, në gazetën “Koha”.<sup>1</sup>



Zora dhe Mirko Gashi, fotografi nga albumi familjar

<sup>1</sup>[https://sq.wikipedia.org/wiki/Mirko\\_Gashi](https://sq.wikipedia.org/wiki/Mirko_Gashi)

## Ja një tablo e Mirko Gashit në cilësinë e babait.

“Si fëmiun e parë të tij më merrte kudo me vete, edhe nëpër kafene, teatër, nëpër orët e ndryshme letrare. Më pak i këndshëm është një kujtim tjetër: edhe pse ndarja e prindërve u bë me marrëveshje, për secilin fëmijë ndarja len gjurmë të hidhura në jetën e fëmijëve” tregon Zora.

## KËNGA

Unë kam këngë  
ti shtëpi  
dhe që të dy jemi poetë

unë s'kam shtëpi  
as ti këngë  
që te dy jemi te shkretë

mua fjalët më mungojnë  
ty me duar të tregojnë  
veshët myku m'i vërshoi  
në erë një thirrje e preka

andaj  
çdo gjë mire u bë –  
ti ke shtëpi  
unë këngë

dhe kështu  
që të dy jemi poetë  
Un' e Ti

“Në poezi, kërkonte perfeksionizëm. Ndonjëherë një varg ka ditë me e preokupu me ditë të tëra. Nuk e ka kursyer kohën dhe ndihmën për poetët e rinj. Ishte i preferuari i studentëve si në takimet e tyre, si në orët letrare, kështu që nuk i mbeti shumë kohë për neve që ishim fëmijët e tij!” vazhdon tregimin e saj Zora, sot një grua e rritur e cila po provon ta bartë tek fëmijët e saj dashurinë për letërsinë dhe për fjalën e shenjtë që, po doli në ajër, nuk kthehet pas dhe kultivohet si lule e përjetësisë.

“Mirko kishte talent edhe në mësimin e gjuhëve të huaja, të cilin talent e kemi trashëguar edhe ne fëmijët e tij e poashtu edhe nipat e tij! Fliste italisht, frëngjisht, gjuhët sllave e posaçërisht e njihnte mirë edhe gjuhën rome. Ka qenë padyshim përkthyesi më i mirë i yni nga serbokroatishtja në shqip” shprehet Zora Gashi Kurti, vajza e Mirko Gashit, sot 54 vjeçare.

Mirko është burrë që nuk duhet harruar, një prej figurave prominente të skenës letrare të Kosovës. Madje, plot e kanë krahasuar edhe me Ali Podrimën e Anton Pashkun, për mjeshtërinë e shkrimit dhe për largimin e hershëm nga jeta. Mirko pati edhe shumë për të dhënë. E thotë ndonjëherë poezia e munguar e tij, e thotë

edhe vetë Zora. Trashëgimia e Mirkos, për lexuesit e tij, është liricizmi i tij, fjalët e tij thurur maestralisht.

Ka botuar “Në vorbullën e ujit” në vitin 1972, “Netët e bardha” tre vite më pas, “Liberto për gjenetivin e ujit” në serbisht në vitin 1997, “Gjarpëri i shtëpisë” në vitin 1980, “Arbror vitae” në vitin 1988 dhe “Plagë uji” në vitin 1990. Në gjuhë të tjera, falë mishërimit dhe talentit të tij, janë përkthyer Ali Podrimja, Ibrahim Kadriu, Din Mehmeti, Sabri Hamiti e shkrimtarë tjerë.<sup>2</sup>

## KAH PO E SHOH KËTË LULE

O zot, im zot  
kah po e shoh këtë lule  
në të cilën vdekja dhe jeta  
shëtisin dorë për dorë  
duke i kënduar oda ujit  
më është e qartë  
se duhet jetuar  
dhe duhet parë këtë mrekulli.

Ja pse Mirko Gashi nuk jepte shumë intervista gjatë jetës së tij, edhe pse rinia dhe njerëzit e dashuronin personalitetin e tij magnetik.

“Le të flasin vargjet. S'jam unë as Fadil Vokrri e as Sabri Fejzullahu. Ata janë për faqe të para të gazetave. Kjo është hera e dytë që jap intervistë. Më kanë lutur, por s'doja të flisja...<sup>3</sup>

Zora Gashi kujton sot shumë prej babait të saj, i cili ka ndërruar jetë më shumë se dy dekada më parë.

“Ishte periudha kur Kosova kalonte nëpër vorbull edhe në përmbledhjen e poezive në librin e tij 'Në vorbullën e ujit', kjo reflektohet. E përjetonte vështirë këtë kohë, u rreshtua me studentët, nuk ngurroi të dërgonte telegrame proteste deri edhe te Millosheviqi. Personalisht mua më pëlqen poezia 'Time bijë', të cilën ma kushtoi mua” tregon Zora.



<sup>2</sup><http://poezishqiptare.blogspot.com/2012/12/poezi-nga-mirko-gashi.html>  
<sup>3</sup><https://portalionline.com/mirko-gashi-jetoj-ashtu-sic-deshiroj/>



## DËGJOJ ZOGUN

### Time bijë

Zogu piu ujë në vorbullën e lumit  
prej këngës së tij të pikëlluar apo të gëzuar  
fishket dhe lulëzon lulja

kështu  
takohen pranvera dhe vjeshta  
shumë gjëra të thjeshta  
derisa shëtisin nëpër mendimet tona  
kërkojnë limanet e kuptimit  
bredhin e lundërojnë  
lundërojnë  
më kot  
nëpër botë.

zogu piu ujë në vorbullën e lumit  
e kënga e tij m'ingëlloi  
si kënga e shtojzovalles  
që shëtiti nëpër trotuar  
të qytetit tim  
sikur të ishte trimi  
I cili theu prangat e përrallës.

## E, kush duhet të shkruaj poezi?

Vetëm ai që e ndjen pulsën e popullit. E, mund ta ndjejë nëse jeton në mesin e tij. S'mundet të ndjejë pulsën e masës poeti që shëtit me “Mercedez” e që jeton në vilë luksoze. Nuk them se poetët për të shkruar poezi duhet të jetojnë në kushte “miserable” sic kam jetuar unë dekada të tëra, por ai gjithsesi duhet të gjendet në mese të ndryshme të shtresave më të gjera popullore, t'i njohë hallet dhe peripecitë e tyre, gëzimet dhe lumturitë, jetën e tyre... Me ka ndodhur që gruaja 70 vjeçare të ma lëshojë vendin në autobus, cka për mua ka qenë kritikë mbi të gjitha kritikët.<sup>4</sup>

Zora rikthehet në retrospektivë për të kujtuar momentet e fundit të jetës së shkrimtarit të parë bohem nga Prishtina, Mirko Gashi, familjarit të saj më të afërm.

“Mirko Gashi vdiq më 1995. Ishte periudhë e vështirë për Kosovën. Presidenti Rugova tregoi shumë respekt dhe kujdes për të, por ishte koha që kërkonte prioritete tjera. Në periudhën e pasluftës u krijua elita e cila nuk kishte shumë sens për artin në përgjithësi. Më kujtohen momentet e fundit të jetës së tij, kur unë ende nuk isha e gatshme të ndahem nga ai dhe e përjetova rëndë ndarjen. Më kujtohet

<sup>4</sup><https://portallonline.com/mirko-gashi-jetoj-ashu-sic-deshiroj/>

shpesh humori i tij specifik, ishte vizionar, ndoshta ka shpresu që njerëzit të kenë më shumë etje për kultivimin e fjalës së bukur” tregon Zora.

Do të ishte mëkat sikur një grua hijerëndë dhe e sofistikuar si Zora të mos trashëgonte fjalët e bukura dhe talentin për poezinë, si Mirkoja.

“Normalisht që unë i kam shkrimet e mia që nuk mendoj t’i publikoj. Jam e kënaqur që kam arritur që tek djemtë e mi ta mbjelli dashurinë për fjalën e bukur” përfundon Zora.



*Mirko Gashi me familje*



## Fitnete Tuda dhe Festivali i TVSH-së

*Fitnete Tuda, sot 55 vjeçare, në ato pak këngë të cilat i ka dhuruar publikut shqiptar, ka gjetur e prekur tema të cilat thumbojnë thellë vetëdijen e shqiptarëve nëpër vite e realitete krejt antonime nga njëra tjetra. Të veçanta të Fitnetes janë pjesëmarrjet e saj në Festivalin e Këngës në Radio Televizionin Shqiptar.*



# 14

**FITNETE TUDA:  
KUR KËNGËT DHE SHIU  
I TIRANËS TË NDJEKIN NGA PAS**

Fitnete  
Tuda

KOSOVA NË 14 TREGIMË KULTURORE

**Nuk ishte e rastësishme  
hyrja në muzikë e Fitnete Tudës.**

Vajza nga Struga, e cila mernte qetësues kur filloi lufta në Kosovë, kur i shihte ikjet e refugjatëve nga Kosova, muzikën do ta niste në mes të ndjenjës së shqetësimit për atë që po ndodhte dhe të gëzimit, që po e realizonte ëndrrën e saj, por duke mos e kuptuar se po krijonte këngë të cilat do të dëgjoheshin edhe vite më vonë.

Fitnete Tuda, sot 55 vjeçare, në ato pak këngë të cilat i ka dhuruar publikut shqiptar, ka gjetur e prekur tema të cilat preknin thellë vetëdijen e shqiptarëve nëpër vite e realitete krejt antonime nga njëra tjetra.

Të veçanta të Fitnetes janë pjesëmarrjet e saj në Festivalin e Këngës në Radio Televizionin Shqiptar.

**E lindur në Strugë dhe e rritur në Kosovë, në vitin 1993, pas situatës së vështirë politike në Kosovë, Fitnete Tuda bashkë me familjen e saj kthehet në Strugë. Vëllau i saj e hap kafiterinë 'U2' – me emrin e grupit të njohur irlandez, këngët e të cilit dëgjoheshin shumë ato vite në Kosovë, me tekstet sinonim të lirisë. Duke e dëgjuar këtë muzikë, ajo frymëzohej për të krijuar këngët e saj të muzikës pop.**

Ndërkohë, të mbështetur nga babai i tyre, bashkë me vëllain Uranin, hapën edhe radion Art Kanal, e cila ato vite bashkë më Radio Erën ishin ndër radiot e para të pavarura në gjuhën shqipe në Maqedoni.

Me po këtë radiostacion, ata në vitin 1995 organizojnë festivalin e muzikës së lehtë

'Vera e Strugës' ku morën pjesë edhe artistët si Aurela Gaçe e Aleksandër Gjoka.

“Unë muzikën e kisha ëndërr në sirtar. Këndoja për vete dhe kur i takova këta artistë u frymëzova edhe më shumë. Ishte Zhani Ciko asokohe, i cili më shtyu që të konkurroja në Festivalin e RTSH-së, dhe duke qenë se isha rritë me festivalet thash ta provoj fatin” më tregon Fitnetja.

Këtu do të niste rrugëtimi i bukur për Fitneten. Shumë prej nesh e kujtojmë këngën “Rrugë” – debutimin e Fitnetes në Festivalin e RTSH-së në vitin 1995. Për çudinë e Fitnetes, kënga pranohet dhe kualifikohet për natën finale. Tekstin e Fitnetes do ta dëgjonte të shkrirë në këngë tërë Shqipëria e shqiptarët kudo.

“Këndova atë natë, dhe të nesërmen kur dola në rrugë, njerëzit më përshëndesnin, te Pallati i Kongreseve në Tiranë më kërkonin autograme, ndërsa unë s'po besoja! E pashë që njerëzit ishin prekur shumë nga ajo këngë dhe e kishin pëlqyer. Ishte ajo koha kur shumë shqiptarë po iknin jashtë vendit të tyre, për të kërkuar një jetë më të mirë. Ato vite, ishin vite të ikjeve të mëdha të shqiptarëve nga Kosova e Shqipëria, ndërsa unë e shihja veten në mes të një udhëkryqi, ku para dhe pas kishte rrugë, si te refreni i këngës.

Kënga hyri në finale, u bë hit dhe transmetohej çdo ditë në Radio e në Televizionin Shqiptar” tregon Fitnetja.

Nga Struga, Tiranën e kishte më afër se Prishtinën dhe do të udhëtonte shumë më shpesh. Shumëkush ka menduar që Fitnetja studioje në Tiranë, ndërsa plot e kanë pyetur nëse ajo ishte me origjinë nga atje.

Festivali në Televizionin Shqiptar në vitin 1995 do ta inspironte Fitneten të rikthehej në edicionin e vitit tjetër. Po flasim për një festival të fuqishëm, me traditë, festival që edhe atëherë edhe sot përcillet me vëmendje dhe ka respektin e adhuruesve.

Shiu i rrëmbyeshëm në Tiranë gjatë dhjetorit të vitit 1995 i kishte mbetur si një mirazh në mendjen e saj. Vetëm në shtatorin e vitit 1996 ajo do ta krijonte e realizonte këngën “Shi bie në Tiranë”. Këtë refren e kishte kënduar një ditë shtatori derisa po ecte bregut të liqenit në Strugë. Ai liqen përrallor të cilit i ka kënduar Lasgushi, i krijon Fitnetes një gjendje shpirtërore ujore, ndoshta ngaqë në horoskop është gaforre. Si me shaka këto i thotë e qeshur e plot jetë, Fitnetja.

“Ky shiu më ngacmoi pak. Ne kaluam aq bukur në festivalin e parë debutues dhe

isha shumë e frymëzuar. Isha mes andrrës dhe realitetit. Megjithatë më mbeti në mendje motivi i shiut. E kisha këngën në mendjen time, ndërsa për inçizim erdha në Prishtinë, e realizova me orkestruesin Ilir Bajri. Kur shkuam në festival, tekstshkruesi i njohur tani i ndjerë – Alqi Boshnjaku e dëgjoji këngën dhe më komplimentoi, se si mundet një gocë nga Struga, të vinte në Tiranë të 'vidhte' motivin e bukur e të këndonte për shiun e Tiranës. Kjo këngë lirike e dashurisë, madje nuk ka marrë as çmim në festival, ndonëse për shumë pak pikë, të cilat nuk m'i dha juria e Maqedonisë – shkaku i një xhelozie provinciale e primitive, e humba vendin e tretë ose të dytë, s'më kujtohet saktë. Kënga 'Shi bie në Tiranë', sa më shumë kohë që kalon dëgjohet dhe mbahet në mendje më shumë, duke u kënduar nga shumë këngëtarë të tjerë" më tregon Fitnetja në intervistën tonë në oborin e Radio Kosovës.

**Të vetmin çmim që Fitnetja e ka marrë në muzikë duke qenë edhe autodidakte, është çmimi për kantautoren më të mirë në Festivalin e Radio Televizionit Shqiptar në vitin 1997, me këngën “Një ditë”.**

Në vitin 1998 Fitnetja e vazhdon maratonën e pjesëmarrjeve të saj në Festivalin me nam.

Kësaj here i erdhi radha tekstit “Shpresa”, një këngë të cilën Fitnetja ia kushton nënës së saj – Shpresa Vinca Tuda, shkrimtare për fëmijë, e cila ndërroi jetë shumë e re – në moshën 42 vjeçare. Këtë këngë ajo ia kushton nënës së saj dhe shpresës si ndjenjë njerëzore, hyjnore, siç shprehet në këngë.

Në vitin 1999, me kompozimin e Fitnete Tudës e realizoi një këngë Rovena Dilo, dhe morri pjesë pikërisht në Festivalin e Dhjetorit – siç e quajnë shpesh, me titullin “Më ndihmo të jetoj”.

Fitnetja vazhdoi me pjesëmarrjet e ndryshme muzikore. Në vitin 1999 dhe më pas në vitin 2003 ajo morri pjesë në festivalin 'Kënga Magjike'.



## Fitnetja e mendon përditë rikthimin në muzikë

Fitnetja e mendon shpesh rikthimin në muzikë, ndonëse thotë se rikthimi ndoshta është më i vështirë se fillimi!

“Ekziston një lloj psikologjie e tillë, që këngëtarët e vjetër të cilët i kanë dhënë shpirt festivalit janë tërhequr nga festivali. Alma Bektashi, Mira Konçi, Aleksandër Gjoka, Elsa Lila, këngëtarët duket sikur herët dalin në pension, e ndjej mungesën e këtyre këngëtarëve”

“Unë edhe pse nuk jam paraqitur para publikut, kam krijuar, kam shumë demoiçizime! Një ditë komunikova me një mike timen në internet, dhe duke e parë sa shumë është zhgënjyer nga njerëzit dhe duke parë dashurinë e saj për lulet, është aq e lidhur sa flet me to, i kultivon ato, i thashë se ajo iu beson vetëm luleve! Por meqë në horoskop jam gaforre, edhe këngët i bëj ngadalë, si gaforre. Ky është motivi i njërës prej këngëve të reja” tregon Fitnetja.

Që nga koha e studimeve të letërsisë, në Prishtinë, Fitnetja ka shkruar poezi, dhe ka një përmbledhje me poezi, të cilën nuk e ka publikuar.



“E kam peng, që nuk e kam publikuar një album muzikor, ashtu siç është libri për një shkrimtar, ashtu është albumi për një këngëtar. Këngët e festivaleve, me një orkestrim të ri, bashkë me këngët e reja, do të dëshiroja t'i përmbledh në një album. E dua shumë edhe letërsinë, leximi dhe shkrimi më përmbush dhe më bën të ndjehem më e plotë, të shkruaj prozë, kjo është sfida më e bukur, nuk i dihet, ndoshta do të kenë sukses si këngët” rrëfen Fitnetja.

Sot fëmijët dhe familja, Fitnetja thotë se janë muzika më e bukur e jetës së saj. Fitneten e lëmë në punën dhe angazhimet e saj, duke pritur të kthehet në skenë me këngët e reja dhe me fjalët e meloditë që në mendjen e saj nuk kanë të sosur.



**Festivali i Fundvitit në RTSH – siç njihet ndryshe edhe si Festivali i dhjetorit apo Festivali i Këngës në RTSH, edicionin e parë e mbajti në dhjetor të vitit 1962. Festivali organizohet vit për vit, ndërsa është ndër festivalet më të vjetra në Evropë të këtij formati. Këtë vit do të mbahet edicioni i 58-të i Festivalit.**

Në tërë këto vite, në këtë festival kanë parakaluar emrat më të mëdhenj të muzikës shqipe. Vaçe Zela, ndoshta zëri më i mirë shqiptar që ka ekzistuar ndonjëherë – këngëtarja e njohur dhe artistja e popullit, e ka fituar festivalin plot 11 herë, që prej edicionit të parë, ndërsa fitoren e fundit e pati në vitin 1980. Këngët që kanë marrë pjesë në këtë festival, pa rëndësi nëse kanë fituar ose jo, dëgjohen edhe sot. Këngët “Flakë e borë” – e kënduar në festival në vitin 1963, “Vajzat e fshatit tim” e sjellë në festival në vitin 1974, “Këputa një gjethe dafine” – këngë e festivalit në vitin 1978, “Ante i tokës sime” në vitin 2000, janë vetëm disa prej këngëve të cilat nuk harrohen dhe janë pjesë e repertorit brenda festivalit. Ndër vite, meqë në Kosovë nuk kishte një festival të përmasave të tilla dhe meqë këngëtarët donin edhe ta shprehnin në forma të ndryshme dashurinë për Shqipërinë, plot këngëtarë shqiptarë edhe nga jashtë Shqipërisë realizuan performancat e tyre në festival.

## **Gili**

Gili, këngëtare e njohur nga Kosova, ka marrë pjesë disa herë në Festivalin e TVSH-së. Dy prej paraqitjeve të cilat ende kujtohen dhe sjellin nostalgji janë ajo e vitit 1996, kur Gili këndoi “Ding dong”, dhe një vit më vonë edhe paraqitja me këngën “Sikur të isha djalë”.

## **Mihrije Braha**

Këngëtarja Mihrije Braha, emocionin e pjesëmarrjes në skenën e madhe të Festivalit të RTSH-së e provoi disa herë. Në vitin 1992, në edicionin e 31-të të Festivalit, ajo këndoi 'Ta fala zemrën time'. Në vitin 1995 ajo u rikthye në festival me këngën 'S'mund të jetoj pa ty' – një tekst nga Mentor Gjurgjeali dhe orkestrim i Nexhat Mujovit – Virusit.

## **Edona Lalloshi**

Edhe Edona Lalloshi, këngëtare e njohur ndër shqiptarë, nga Kosova udhëtoi për në Tiranë për tu bërë pjesë e Festivalit të Dhjetorit. Në vitin 1994 ajo morri tekstin e Hil Mosit dhe e shkriu atë në këngën “Vajtëm Dashurie”, ndërsa vitin që pasoi këndoi këngën 'Kthemi ëndrrat', në Festivalin e 34-të të Këngës në Radio Televizionin Shqiptar.

### **Alma Bektashi**

Edhe Alma Bektashi e konfirmon se këngëtarët nga Kosova për vite me radhë i kanë sjellë risi dhe freski këtij festivali. Përmendet sidomos kënga “Zhgënjimi” me të cilën Alma Bektashi la gjurmë në repertorin e festivalit. Me Aleksandër Gjokën ajo morri pjesë në festival në vitin 1994, me këngën 'Ti nuk më tradhëton', ndërsa në vitin 1995 morri pjesë e vetme me këngën 'Kështu e ka jeta'.

### **Alberije Hadërgjonaj**

Jo shumë këngëtarë nga Kosova kanë triumfuar në këtë festival. Alberije Hadërgjonaj ia arriti të bëhej e para kosovare që në vitin 1998 fitoi në festival me baladën 'Mirësia dhe e vërteta', një këngë e fuqishme për njerëzimin dhe e cila u lidh edhe me luftën që do të shpërthente në Kosovë gjatë kësaj periudhe. Alberija është paraqitur në festival edhe me këngët “Pse vonon dashuri” dhe më këngën “Jeta nuk është lodër”.

### **Rona Nishliu**

Rona Nishliu e ka provuar më vonë emocionin e skenës së festivalit. Para shumë vitesh ajo bashkë me Vesa Lumën dhe Teuta Kurtin, pas sukseseve në 'Ethet e së premtës mbrëma' u ngjitën në skenë me këngën “Flakareshë”. Megjithatë, suksesti për Ronën erdhi kur triumfoi në festivalin e vitit 2011-të, me këngën “Suus”.





*Publikuar me leje nga Fitnete Tuda*





## FALENDERIMET:

Falenderoj secilin dhe secilën që në një formë a tjetrën më ka ndihmuar gjatë përpilimit të këtij libri. Nënën dhe motrën time, për dashurinë e tyre. Babain tim, për kujdesin dhe bekimin nga një tjetër botë. Familjarët tjerë, për kurajon.

Falenderoj secilin personazh brenda këtij libri, secilin njeri që ka marrë frymë afër meje dhe prej gojës ka nxjerrë një tregim që do të mbetet përjetë gjallë.

Falenderoj kolegët, shokët e shoqet e mia që kanë plot nerva në ditët me mua. Falenderoj ekipin e BIRN, BE-së dhe AGK-së, për ndihmën në çdo hap.

### Arbër Selmani - autor i librit

**Arbër Selmani** është gazetar i kulturës, redaktor në gazetën online KultPlus dhe pjesë e Europe House në Prishtinë, i angazhuar me median digjitale dhe me përpilimin e publikimeve në bashkëpunim me Zyrën e BE-së në Kosovë.

Selmani ka studiuar marketingun në Universitetin e Prishtinës ndërsa ka rreth 12 vite përvojë pune në gazetari. Ai ka punuar në Radion Vala Rinore, ndërsa ka vazhduar në Televizionin Klan Kosova, Gazetën Zëri, njëkohësisht duke shkruar edhe për media të ndryshme brenda e jashtë vendit.

Në vitin 2013-të puna e tij u vlerësua nga UNWomen dhe UNDP në Kosovë, derisa teksti i tij rreth komunitetit LGBT në Kosovë u shpall 'Best Online Media Story'. Në vitin 2018-të ai ishte një prej bursistëve të Bursës Sakharov e cila ndahet çdo vit nga Parlamenti Evropian në Bruksel për katërmbëdhjetë aktivistë të të drejtave të njeriut nga mbarë bota. Kohë pas kohe u ligjëron studentëve mbi raportimin rreth çështjeve kulturore.

Është alumna i Fondacionit Robert Bosch në Berlin. Bashkëpunon me BIRN – Balkan Investigative Reporting Network dhe me CRD – Civil Rights Defenders. Është në përgatitje të librit të tij të dytë me poezi.







# KOSOVA

## NË 14 TREGIME KULTURORE

---

Udhëtim nëpër kohë, rrëfime plot nostalgji. Njerëz, objekte, mishërim. Katërbëdhjetë tekste që me anë të fotografive i vijnë të freskëta lexuesit. Trashëgimi, art, kulturë, letërsi, muzikë, mbi të gjitha... jetë.

**ARBËR SELMANI**

PRISHTINË 2019



European  
Union  
Kosovo

